FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 101

Tiranë – E mërkurë, 3 qershor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 49/2020 datë 30.4.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 14, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19', të ndryshuar"....	5761
Ligj nr. 50/2020 datë 30.4.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 15, datë 15.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 'Për buxhetin e vitit 2020', të ndryshuar"	5761
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.5.2020	Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035.....	5761
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 216, datë 29.5.2020	Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi GFCM/43/2019/5]	5817
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 19.5.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë "Favina 1" sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Voskopojë", me kapacitet të instaluar 1970 kw.....	5826
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 88, datë 19.5.2020	Mbi fillimin e procedurës për kualifikimin e impiantit dhe pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës, për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC "Banjë", të shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a.....	5827

LIGJ
Nr. 49/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 14, DATË 11.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 14, datë 11.4.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.4.2020

LIGJ
Nr. 50/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 15, DATË 15.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 88/2019 'PËR BUXHETIN E VITIT 2020', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 15, datë 15.4.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, 'Për buxhetin e vitit 2020', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.4.2020

VENDIM
Nr. 418, datë 27.5.2020

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE TË PLANIT KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE, 2020–2035

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin

e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 175, datë 17.1.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe institucionet e tjera përgjegjëse të përcaktuara në dokumentin e politikave strategjike dhe Planin Kombëtar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

DOKUMENTI I POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE PLANI KOMBËTAR I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE, 2020–2035

Tabela përmbledhëse
Shkurtime
1. Lista e figurave
2. Lista e tabelave
Fjala e ministrit
HYRJE
1.1 Qëllimi dhe objektivat e dokumentit të politikave strategjike
1.1.1 Analiza e situatës aktuale
1.2 Rruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian
1.3 Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve
1.3.1 Hierarkia e mbetjeve
1.3.2 Parimi "ndotësi paguan"
1.3.3 Parimi i "Përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit"
1.3.4 Parime të tjera
2. Zhvillimi i qëndrueshëm
3. Menaxhimi i përgjegjshëm ndaj mjedisit
4. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme
5. Hierarkia e planifikimit
5.1 Dokumenti i politikave strategjike dhe plani kombëtar i veprimit
5.2 Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta
5.3 Planet rajonale/zonale
5.4 Planet vendore
6. Kuadri ligjor institucional dhe financiar
6.1 Kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve
6.1.1 Mbulimi i kostove dhe i tarifave
6.2 Kuadri institucional
6.2.1 Ministria përgjegjëse për mjedisin
6.2.2 Ministria përgjegjëse për infrastrukturën
6.2.3 Ministri të tjera
6.2.4 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe strukturat inspektuese lidhur me sektorin e mjedisit dhe të ujërave
6.2.5 Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
6.2.6 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)
6.2.7 Njësitë e vetëqeverisjes vendore
6.2.8 Përgjegjësia e prodhuesve dhe e bizneseve të tjera
6.2.9 Roli dhe përgjegjësitë e qytetarëve
6.3 Kuadri financiar
6.3.1 Financimi nga burimet e qeverisë qendrore, pushteti vendor dhe donatorët e huaj
7. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake
7.1 Industria e riciklimit në menaxhimin e mbetjeve
7.2 Monitorimi i mbetjeve dhe raportimi
8. Rrymat e mbetjeve
8.1 Rryma e mbetjeve të ngurta shtëpiake
8.2 Analiza e të dhënave bazë për rrymën e mbetjeve të ngurta shtëpiake
8.3 Rrymat e mbetjeve jobashkiake
8.3.1 Mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi – mbetjet inerte
8.3.2 Mbetjet nga industria dhe minierat
8.3.3 Mbetjet nga bujqësia dhe nga industria e përpunimit të drurit
8.3.4 Mbetjet e rrezikshme
8.3.5 Ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet
8.3.6 Automjetet në fund të jetës
8.3.7 Gomat e përdorura
8.3.8 Mbetjet nga llumi i impianteve të trajtimit
8.3.9 Mbetjet nga nënproduktet e kafshëve
8.4 Ndotësit organikë të qëndrueshëm
8.5 Mbetjet spitalore
9. Konkluzione dhe rekomandime
9.1 Gjetje të përgjithshme
9.2 Gjetje të veçanta
9.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional
9.2.2 Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve

9.2.3 Koncepti i menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkiake
9.3 Identifikimi i problemeve
9.4 Standardi minimal i përballueshëm për menaxhimin e mbetjeve të ngurta shtëpiake
10. Rrjeti i integruar i objekteve të menaxhimit të mbetjeve

STRATEGJIA KOMBËTARE E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE DHE PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT, 2020–2035

QS1. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit
Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve, duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën.
Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve
11. Qëllimet strategjike, objektivat specifikë dhe masat e zbatimit të dokumentit të politikave strategjike
11.1 Qëllimi strategjik 1 (QS1): Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit
11.1.1 Objektivi specifik 1 (OS1): Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve, duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën
11.1.2 Objektivi specifik 2 (OS2): Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ka mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së
11.1.3 Objektivi specifik 3 (OS3): Krijimi i një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve bashkiake, i cili bazohet në hierarkinë e mbetjeve
11.2 Qëllimi strategjik 2 (QS2): Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve
11.2.1 Objektivi specifik 4 (OS4)
11.3 Qëllimi strategjik 3 (QS3): Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve
11.3.1 Objektivi specifik 5 (OS5): Burimet financiare për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikohen në planifikimin buxhetor afatmesëm të miratuar me ligj
11.3.2 Objektivi specifik 6 (OS6): Menaxhimi i mbetjeve është prioritet kombëtar dhe pjesë e rëndësishme e planifikimi të fondeve të ndihmës së huaj, IFI dhe BE nëpërmjet fondeve IPA
11.4 Objektivi strategjik 4 (QS 4): Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve
11.4.1 Objektivi specifik 7 (OS 7): Burimet njerëzore dhe pjesëmarrja
11.4.2 Objektivi specifik 8 (OS 8): Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të bashkive dhe institucioneve qendrore të mandatuara me MIM-në
Dokumenti i politikave strategjike
12. Treguesit për rrymat e veçanta të mbetjeve
13. Treguesit e matjes për zbatimin e planit të veprimit

SHKURTIME

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
AT	Asistencë teknike
BE	Bashkimi Evropian
IK	Investime kapitale
INSTAT	Instituti i statistikave
IPA	Instrumenti i paraaderimit
ISHMP	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve
KE	Këshilli i Evropës
MF	Ministria e Financave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIM	Menaxhimi i integruar i mbetjeve
MNSH	Mbetje të ngurta shtëpiake
MNP	Mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet
MPEE	Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike
MTM	Ministria turizmit dhe mjedisit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
NJQV	Njësitë e qeverisjes vendore
O&M	Operimi dhe mirëmbajtje

PCB *Difileni poliklorur*
PE Parlamenti Evropian
PEE Pajisjet elektrike dhe elektronike
PK Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
PKIE Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RIOT Rrjeti i integruar i objekteve të trajtimit
QQ Qeveria qendrore
QSH Qeveria shqiptare
QV Qeverisja vendore
VKM Vendim i Këshillit të Ministrave

1. LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Hierarkia e mbetjeve (neni 3, direktiva kuadër 2008/98 e KE-së)
Figura 2. Skema e një databaze unike për shërbimet vendore
Figura 3. Gjenerimi i mbetjeve në Shqipëri, INSTAT 2018
Figura 4. Mesatarja vjetore e gjenerimit të mbetjeve kg/banor/vit, 2010–2018
Figura 5. Opsionet e trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake
Figura 6. Skema përmbledhëse e mbledhjes, transportit dhe trajtimit të mbetjeve bashkiake
Grafiku 1. Tendenca e rritjes vjetore të gjenerimit MNB si mesatare
Grafiku 2. Përbërja e mbetjeve spitalore

2. Lista e tabelave

Tabela 1. Financimi për MIM 2011–2019 nga buxheti i shtetit dhe ndihma e huaj
Tabela 2. Venddepozitimet e kontrolluara të mbetjeve në Shqipëri, 2019
Tabela 3. Industria e riciklimit në Shqipëri
Tabela 4. Të dhëna krahasuese mbi sasinë e mbetjeve që riciklohen
Tabela 5. Gjenerimi i MNB-ve dhe mbetjeve të tjera (inerte) kg/banor/vit
Tabela 6. Vlera bazë e gjenerimit për banor në vit, si dhe përqindja e rritjes vjetore.
Tabela 7. Të dhënat bazë për menaxhimin e mbetjeve bashkiake, viti 2018
Tabela 8. Sasitë e sterileve të nxjerra nga shfrytëzimi i minierave, sipas llojit të mineralit
Tabela 9. Magazinat e tjera të këtyre mbetjeve në vend, si dhe lloji i kimikateve që ato kanë të depozituar dhe sasia e përafërt e tyre
Tabela 10. Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri
Tabela 11. Sasia e biomasës nga mbetjet bimore
Tabela 12. Sasia e biomasës nga mbetjet shtazore
Tabela 13. Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve të raportuara nga NJQV-të për vitin 2018
Tabela 14. Sasia e vajrave të dorëzuara në subjekte të licencuara për menaxhimin dhe riciklimin e tyre gjatë tri viteve: 2014, 2015, 2018
Tabela 15. Sasia e baterive dhe e akumulatorëve në Shqipëri, për të tria vitet: 2012, 2013, 2018
Tabela 16. Sasia e mbetjeve nga bateritë të raportuara nga NJQV-të për vitin 2018
Tabela 17 Standardi minimal dhe prioritetet e aktiviteteve për rrymën e mbetjeve bashkiake

Fjala e ministrit

Dokumenti i politikave strategjike të menaxhimit të mbetjeve është një nga dokumentet më të rëndësishme dhe thelbësore në fushën e mbetjeve, që synon kalimin nga ekonomia lineare në atë qarkulluese. Ky dokument do të shërbejë si mekanizëm që do të ndërlidhë gjithë aktorët dhe operatorët që përfshihen në këtë cikël, me qëllim përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në shëndetin e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Qeveria shqiptare ka konsideruar çështjen e mbetjeve si një ndër gjashtë prioritetet e saj, duke i dhënë rëndësi të madhe trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve dhe duke vlerësuar që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore të ketë një vend të licencuar dhe me parametrat mjedisorë për të depozituar mbetjet e tyre.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si institucioni kryesor në hartimin e politikave në fushën e mbetjeve, do të mbështesë vazhdimisht pushtetin vendor si një nga partnerët kryesorë, roli i të cilave është një domosdoshmëri që rrjedh nga kuadri ligjor.

Ka ardhur koha që të bëhet një pakt kombëtar për Shqipërinë e pastër. Ky pakt miqësor me mjedisin do të na bëjë të gjithëve më të përgjegjshëm të krijojmë atë mjedis të nevojshëm për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve miqësore dhe të integruara për mjedisin. Ajo çka është më thelbësore, është të bëhemi të gjithë bashkë që të kemi një vend më të pastër me standardet më të larta mjedisore.

E gjithë kjo do të shërbejë dhe do të zbatohet në funksion të turizmit, si një nga prioritet madhore, ku theksi dhe vizioni është: "Shqipëria si një destinacion mikpritës, tërheqës, autentik për zhvillimin e potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit".

Këtë synojmë të arrijmë përmes kësaj strategjie. Kemi paraqitur tanimë një vizion të qartë për një zhvillim të qëndrueshëm në menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke përdorur burimet natyrore me eficiencë, nxitur në zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimin e materialeve të ricklueshme, me qëllim zbutjen e ndikimeve negative në mjedis, duke shkuar drejt konceptit të sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me eficiencë dhe të ruajtjes së burimeve të lëndëve të para, në mënyrë që të gjithë së bashku të kemi një Shqipëri më të pastër për një të ardhme më të bukur për ne dhe fëmijët tanë.

MINISTËR
Blendi Klosi

1. Hyrje

1.1 Qëllimi dhe objektivat e dokumentit të politikave strategjike

Dokumenti i politikave strategjike është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jobashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri dhe mbulon periudhën kohore 2020–2035.

Ky dokument strategjik merr parasysh zhvillimet planifikuese dhe infrastrukturore në sektorin e mbetjeve prej vitit 2011, në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen e madhe të biznesit privat dhe investimet e shumta të kryera në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe, veçanërisht, të trajtimit të mbetjeve.

Dokumenti i politikave strategjike i rishikuar i menaxhimit të integruar të mbetjeve zhvillohet mbi vizionin ose perceptimin e konceptit "zero mbetje", që mbetjet të grumbullohen dhe të trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe të ruajtjes së burimeve të lëndëve të para. Dokumenti i politikave strategjike ka si qëllim kryesor të japë drejtimet strategjike dhe të përcaktojë një sërë masash që ndihmojnë vendin për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, duke përmbushur detyrimet që rrjedhin prej kapitullit 27 për mjedisin.

Objektivat specifikë të dokumentit të politikave Strategjike synojnë të japin zgjidhje praktike, për:

1. Adresimin e problematikave në sistemin e deritanishëm të menaxhimit;
2. Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi; dhe
3. Përgatitjet e nevojshme për të përmbushur detyrimet nga ndryshimet në direktivat e BE-së, përfshirë edhe objektivat ambiciozë të Paketës së Ekonomisë Qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke i dhënë impuls shtesë zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, si dhe hapjen e rrugës drejt integrimit evropian.

1.1.1 Analiza e situatës aktuale

Në Shqipëri, gjatë viteve të fundit, sasia e gjenerimit të mbetjeve është rritur, ndërsa mënyra e menaxhimit të tyre ka vend për përmirësim.

Zbatimi i dokumentit të politikave strategjike do të kërkojë një riorganizim thelbësor institucional, për të qartësuar strukturat përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe detyrat institucionale, për të arritur objektivat e zvogëlimit, ripërdorimit dhe të riciklimit.

Menaxhimi i mbetjeve kryhet në të gjitha zonat urbane dhe më pak në zonat rurale. Mbetjet hidhen kryesisht në venddepozitime të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, por ka sasi që hidhen dhe në vende të paautorizuara, përgjatë rrugëve dhe afër vendbanimeve. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet përmes kontraktimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të ndërmarrjeve private apo dhe përmes kompanive të tyre dhe këto kontrata janë zakonisht me një kohëzgjatje 3–5 vjet. Infrastruktura e mbledhjes është e dobët, pasi shpesh numri i kontejnerëve është i pamjaftueshëm. Pajisjet e grumbullimit (kontejnerë dhe kamionë) nuk janë sipas standardeve evropiane dhe kanë nevojë për rinovim në mënyrë të vazhdueshme.

Industria e riciklimit është një nga aktorët më të rëndësishëm në menaxhimin e mbetjeve. Riciklimi në vetvete është ndoshta elementi më thelbësor dhe forma më e njohur për zvogëlimin e mbetjeve që zhvillohet nëpërmjet një zinxhiri procesesh, duke përfshirë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin, që çon

në zvogëlimin e një sasie të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në lendfill.

Riciklimi ka progres krahasuar me disa vite më parë, pasi janë ngritur kompani që grumbullojnë metalet, plastikën, letrën dhe qelqin dhe i riciklojnë ato. Edhe për rryma të tjera mbetjesh ka filluar grumbullimi dhe menaxhimi i tyre. Për t'u përmendur janë mbetjet spitalore, të baterive, të vajrave, të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Përpjekjet për ndarjen në burim të mbetjeve, kanë qenë të shpeshta por pa rezultat pozitiv. Kjo për shkak të mungesës së plotë të infrastrukturës por edhe të ndërgjegjësimit publik. Sa i takon përgatitjes së kuadrit ligjor në fushën e mbetjeve vihet re një përputhshmëri me direktivat dhe rregulloret e BE-së, por sfidë mbetet ende zbatueshmëria e plotë e tij. Gjithashtu, menaxhimi i integruar i mbetjeve kërkon dhe instrumente financiare që do të bëjnë të mundur arritjen e objektivave të dokumentit strategjik. Instrumentet financiare përfshijnë:

- planifikimin e buxhetit afatmesëm në nivel qendror;
- dhënia e një fondi dedikuar për mjedisin, bazuar në numrin e popullsisë që i jepet çdo vit njësive të vetëqeverisjes vendore.

Zbatimi i Strategjisë do të kërkojë një impenjim të madh financiar të qeverisjes në nivel kombëtar dhe vendor për ta trajtuar menaxhimin e mbetjeve si një sektor strategjik. Rol të rëndësishëm luan edhe sektori privat që do të jetë mbështetës kryesor lidhur me financimet për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

1.2 Rruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Shqipëria dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) në qershor 2006. MSA-ja ka hyrë në fuqi në 1 prill 2009. Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, nenit nr. 108, "Mjedisi", Palët do të zhvillojnë dhe do të forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e komunitetit për fushën e mjedisit.

Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së kryhet në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), në të cilin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) kontribuon për kapitullin 27 të tij, "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike".

Më 25 mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së miratoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Vendimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së u miratua nga Këshilli Evropian më 26 mars 2020.

Këshilli mandatoi Komisionin Evropian për të vazhduar dhe për të përfunduar procesin e shqyrtimit analitik të *acquis* së BE-së, duke u nisur nga grupimi i thelbësoreve.

Gjatë viteve 2018 dhe 2019, Komisioni Evropian zhvilloi të gjitha takimet shpjeguese të *acquis komunitare* për të 33 kapitujt. Takimi shpjegues për kapitullin 27 u zhvillua në datën 13–17 maj 2019, në Bruksel.

Në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave për anëtarësim, qeveria shqiptare po vijon krijimin e strukturës negociuese për negociatat, përfshirë grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit me nr. 94, datë 20.5.2019, "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian", për kapitullin 27 "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike", Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion kryesues, për këtë kapitull negociues.

Kapitulli 27 është ndër kapitujt më të rëndësishëm të *acquis* së BE-së, duke përfshirë 73 direktiva dhe rregullore, të cilat përbëjnë kuadrin ligjor të BE-së për fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike.

Kapitulli 27 është një kapitull ndërsektorial, ku përfshihen një sërë ministrish linje dhe agjencish të pavarura, të cilat ushtrojnë kompetenca në fushën e mjedisit dhe në nënfushat përkatëse të tij. Të gjitha detyrimet raportuese, planifikimin e politikave, strategjitë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre e koordinon MTM-ja,. në cilësinë e institucionit lider për këtë kapitull.

Në bazë të metodologjisë së dakordësuar për punën përgatitore deri në takimet bilaterale, në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të *acquis*, MTM-ja është në proces vlerësimi të kuadrit ligjor të përafruar me legjislacionin e BE-së për kapitullin 27 dhe kapaciteteve institucionale që rrjedhin si detyrim nga implementimi i këtij kuadri.

1.3 Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në direktivën kuadër të menaxhimit të mbetjeve 2008/98/EC, që është transpozuar në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", janë:

1.3.1 Hierarkia e mbetjeve

Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve, sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, siç paraqitet në figurën 1. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve, duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.

Dokumenti i politikave strategjike parashtron nevojën për kalimin gradual nga ekonomia lineare në atë qarkulluese, duke synuar ndër të tjera zgjatjen e jetës, grumbullimin përmes ndarjes në burim dhe riciklimin në shkallë të gjerë. Kalimi në ekonominë qarkulluese, në të cilën mbetja trajtohet si burim lëndësh përmes rikthimit në ekonomi si lëndë të para, do të sjellë përfitime për mjedisin dhe ekonominë e vendit.



Figura 1. Hierarkia e mbetjeve (neni 3, direktiva kuadër 2008/98 e KE-së)

1.3.2 Parimi "ndotësi paguan"

Parimi "ndotësi paguan" lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen te ndotësit dhe te konsumatorët përgjegjës për të. Kostot e ndotjes kanë të bëjnë me parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

1.3.3 Parimi i "përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit"

"Përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit" janë përgjegjësitë që duhet të ketë një prodhues apo importues gjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve të tyre, që prej krijimit deri në shkallën e postkonsumit. Prodhuesi/importuesi duhet të ketë si qëllim marrjen pas të produkteve që janë në fund të jetës së tyre, riciklimin dhe depozitimin e tyre.

Përparësi i duhet dhënë ndarjes së diferencuar të produkteve dhe të materialeve që paraqesin një rrezik më të lartë ndaj mjedisit dhe/ose për ato produkte që ka treg përpunimi për qëllime riciklimi ose rikuperimi.

Mbetjet që riciklohen konsiderohen si lëndë parësore dhe objektet vendore për ndarjen dhe përpunimin e mbetjeve furnizojnë industrinë.

1.3.4 Parime të tjera

- Parimi i parandalimit nënkupton që kur ka të dhëna mbi praninë e rrezikut mjedisor, duhen marrë masa të përshtatshme parandaluese edhe në rastet kur mungojnë prova të qarta të shkaqeve për atë rrezik.

- Parimi integrues nënkupton që mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit të politikave.

- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe i bashkëpunimit nënkupton që të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të

bashkëpunojnë për të arritur objektivat e kësaj Strategjie.

- Parimi i vetëqëndrueshmërisë nënkupton që vendi të zhvillojë një rrjet pajisjesh dhe impiantesh të integruara dhe të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve.

- Parimi i afërsisë nënkupton që mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve.

- Parimi i përballueshmërisë nënkupton që niveli i tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë i përballueshëm dhe i pranuar nga komuniteti.

- Parimi i së drejtës për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut nënkupton që çdo qytetar ka të drejtë të marrë informacion rreth menaxhimit të mbetjeve lehtësisht nga të gjitha institucionet përgjegjëse. E drejta për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje nënkupton që publikut duhet të jetë i informuar për të gjitha projektet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe duhet t'i jepet mundësia të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

- Parimi i eliminimit të mangësive që ndeshen në politikat mjedisore shqiptare nënkupton zbatimin e praktikave aktuale evropiane që lidhen me fushën e menaxhimit të mbetjeve. Vënia në zbatim e këtyre praktikave, do të mundësojë që të kontrollohen dhe të përmirësohen ligjet, rregulloret dhe të gjitha procedurat në respekt të standardeve evropiane.

2. Zhvillimi i qëndrueshëm

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm nënkupton që brezi i sotëm, në përpjekjen për të plotësuar nevojat e tij, të mos cenojë aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Zhvillimi i qëndrueshëm në menaxhimin e integruar të mbetjeve nënkupton se burimet natyrore do të përdoren me eficiencë, duke nxitur zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimin e materialeve të ricikluesshme, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, duke shkaktuar ndikimin më të vogël të mundshëm mbi mjedisin.

Kalimi drejt ekonomisë qarkulluese, duke përfshirë edhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, lidhet edhe me përmbushjen e drejtpërdrejtë të tre objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm (OZHQ) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe me disa tregues respektivë.

Objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm (OZHQ) të OKB-së dhe ekonomia qarkulluese
Objektivi 11. Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirës, të sigurt, rezistentë dhe të qëndrueshëm 11.6 Të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke u kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera. **Objektivi 12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit** 12.1 Të gjitha vendet të marrin masa për zbatimin e kornizës kuadër 10-vjeçare të programeve për konsumin dhe për prodhimin e qëndrueshëm, ku vendet e zhvilluara të ndërmarrin rolin udhëheqës, duke pasur parasysh zhvillimin dhe aftësitë e vendeve në zhvillim. 12.2 Të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi eficient i burimeve natyrore. 12.4 Të arrihet menaxhimi i shëndetshëm mjedisor i kimikateve dhe i të gjitha mbetjeve gjatë ciklit të tyre të jetës, në përputhje me kornizat kuadër ndërkombëtare të miratuara dhe të zvogëlohet ndjeshëm shkarkimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, me qëllim zvogëlimin e ndikimeve negative mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin. 12.5 Të zvogëlohet ndjeshëm krijimi i mbetjeve përmes zbatimit të parimeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe të ripërdorimit. **Objektivi 14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm** 14.1 Të parandalohet dhe të zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme ndotja detare e të gjitha llojeve, në mënyrë të veçantë nga aktivitetet tokësore, përfshirë mbetjet detare dhe ndotjen nga lëndët ushqyese.

Dokumenti i politikave strategjike është një mjet i rëndësishëm, në kuadrin e politikave të Republikës së Shqipërisë për arritjen e këtyre objektivave.

3. Menaxhimi i përgjegjshëm ndaj mjedisit

Dokumenti i politikave strategjike duhet të kontribuojë në hartimin dhe në vendosjen e një plani për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, ku burimet përdoren në mënyrë më eficiente dhe me ndikim sa më të vogël mbi mjedisin. Për të arritur këtë objektiv ndër të tjera, kërkohet që menaxhimi i mbetjeve të kryhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit.

- Menaxhimi i mbetjeve i përgjegjshëm ndaj mjedisit nënkupton ndërmarrjen e të gjithë hapave praktikë për të siguruar që mbetjet menaxhohen në mënyrë të tillë që të mbrohet shëndeti i njerëzve dhe mjedisi prej ndikimeve negative që shkaktojnë mbetjet. Këtu përfshihen zhvillimi dhe zbatimi i masave, për:

- menaxhimin e mbledhjes së rrymave të ndryshme të mbetjeve, duke zbatuar hierarkinë e mbetjeve;

- sigurimin e rrjetit të pajisjeve për; mbledhjen, ndarjen, riciklimin, rikuperimin dhe depozitimin;

- sigurimin e pajisjeve me leje të posaçme dhe përmbushjen e kërkesave bazë sikurse kërkohet në lejen e dhënë, monitorimi dhe zbatimi me rigorozitet i kushteve të lejes;

- dërgimin e mbetjet vetëm te pikat e autorizuara;

- mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave të domosdoshme për hartimin e politikave të bazuara në këto të dhëna dhe kryerjen e investimeve përkatëse;

- rritjen e ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në menaxhimin e mbetjeve për të qenë më miqësorë ndaj mjedisit, si dhe marrjen e masave për t'u pajisur me infrastrukturën e nevojshme që mbështet këtë mënyrë menaxhimi.

4. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme

Teknologjitë më të mira të disponueshme (TMD), janë teknikat e zhvilluara në atë nivel që mundëson përdorimin e tyre, në sektorin përkatës industrial, me rezultate të mira ekonomike e teknike. Vlerësimi i teknikave merr parasysh kostot dhe përparësitë, pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë ato janë të arritshme nga përdoruesi. Pajisjet dhe impiantet e menaxhimit të mbetjeve duhet të menaxhohen sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, me qëllim që të shmanget ndikimi i tyre mbi mjedisin, dhe në rastet kur ky ndikim nuk mund të shmanget, ai të minimizohet. Për udhëzime teknike të veçanta duhen konsultuar Dokumentet e Referencës së TMD (të njohura në anglisht si BREFs).

5. Hierarkia e planifikimit

Zbatimi i sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve duhet drejtuar përmes katër niveleve të instrumenteve planifikues.

5.1 Dokumenti i politikave strategjike dhe Plani Kombëtar i Veprimit

Dokumenti i politikave strategjike për mbetjet, i cili është niveli më i lartë i planifikimit, është një dokument veprimi për të ardhmen, është guri i themelit, ku ngrihen strategjitë dhe planet, rregullohen marrëdhëniet dhe orientohen burimet.

Ky dokument u shërben: politikëbërësve për të orientuar vendimmarrjen kundrejt mirëmenaxhimit të mbetjeve; administratës për hartimin e strategjive, planeve dhe programeve të zhvillimit; qeverisë për krijimin dhe përmirësimin e institucioneve përgjegjëse; Financës për orientimin e buxheteve; zbatuesve për të kuptuar drejtimin dhe qëllimin e punës së tyre; pjesëmarrjes publike për ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis nga mbetjet, për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit për brezat e ardhshëm.

Politika duhet të sigurojë udhëheqjen dhe kursin e drejtimit për një periudhë të caktuar kohore.

5.2 Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta

Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta përfaqëson dokumentin e nivelit të dytë të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve i cili përcakton kuadrin planifikues, lidhur me investimet në infrastrukturën, në nivel kombëtar dhe atë të zonave të menaxhimit të mbetjeve.

Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta duhet të orientohet drejt:

- identifikimit dhe përcaktimit të metodologjisë dhe teknologjisë për investimet e ardhshme për trajtimin e mbetjeve për sistemin e integruar të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë pajisjet për grumbullimin e mbetjeve, kompostimin, riciklimin, djegien për rikuperim energjie dhe depozitimin mbi bazën e zonave të menaxhimit të mbetjeve;

- përcaktimit të kostove dhe të tarifave lidhur me depozitimin e mbetjeve në impiantet e trajtimit dhe stacionet e transferimit të mbetjeve;

- një sistemi objektiv të verifikueshëm dhe transparent të prioriteteve të investimeve të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve që ndërtohet në bazë të vlerësimit të nevojave dhe të ndikimeve.

5.3 Planet rajonale/zonale

Zbatimi i dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta kërkon hartimin e planeve rajonale/zonale për çdo zonë të menaxhimit të mbetjeve. Këto plane duhet të mbështeten në studime fizibiliteti, të cilat hartohen nga ministria përgjegjëse, në bazë të parimeve dhe të standardeve evropiane për mbrojtjen e mjedisit, si dhe njohurive më të mira ekzistuese.

5.4 Planet vendore

Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

6. Kuadri ligjor institucional dhe financiar

6.1 Kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duke qenë institucion politikëbërës, ka progres në hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor në fushën e mbetjeve, në përputhje me direktivat dhe rregulloret e BE-së. Një prej sfidave që buron nga legjislacioni, është zbatimi i plotë i tij. Mungesa e zbatueshmërisë vjen dhe si fakt i mbivendosjes së kompetencave të institucioneve qendrore dhe vendore. Nuk mungojnë dhe rastet kur disa detyra janë të pambuluara nga asnjë prej institucioneve. Lista e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për mbetjet është e gjatë.

Për t'u përmendur janë:

- ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar;

- ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;

- ligji nr. 8094/1996, "Për largimin publik të mbeturinave", siguron bazën ligjore, nëpërmjet së cilës bashkitë mund të kontraktojnë shërbimin në palë të treta me kontrata menaxhimi që mund të zgjasin deri në 5 vjet;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 6.3.2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 6.3.2012, "Për incinerimin e mbetjeve";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 11.7.2012, "Për lendfillet e mbetjeve";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 10.10.2012, "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 7.11.2012, "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 4.12.2012, "Për bateritë akumulatorët dhe mbetjet e tyre";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012, "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 13.2.2013, "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 967, datë 25.10.2013, "Për ngritjen e grupit të punës për Komitetin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 29.9.2010, "Për miratimin e rregullores, 'Për administrimin e mbetjeve spitalore'";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.4.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.6.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 17.9.2014, "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014, "Për miratimin e rregullave për

eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.2.2015, "Kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 6.5.2015, "Për rregullat për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve/PCT-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve/PCT-ve të përdorura";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1104, datë 28.12.2015, "Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 232, datë 26.4.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 31.5.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për lendfillet e mbetjeve";

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 31.10.2018, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve".

Këto akte trajtojnë aspekte të veçanta të zbatimit të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ngarkojnë me përgjegjësi aktorët e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe publiku, vendosin objektiva dhe përcaktojnë afatet për përmbushjen e tyre. Por, ato karakterizohen nga një veçori e përbashkët: pamundësinë për t'u zbatuar për shkak të mungesës së mbështetjes me financime për çdo akt, përgjegjësi apo objektiv që ato përcaktojnë.

Nga ana tjetër, për sa u përket objektivave, afatet e vendosura në këto akte në shumë raste janë tejkaluar. Për këtë arsye ato duhet të rishikohen, të përditësohen, lidhur me afatet kohore dhe rishikimin e nivelit të synuar të treguesve sipas objektivave.

Bazuar në legjislacionin në fuqi në fushën e mbetjeve, është e nevojshme të adresohen tri synimet kryesore, për të cilat është i nevojshëm rishikimi i tij, konkretisht:

- përafrimi i plotë i kuadrit ligjor me direktivat e BE-së për mbetjet, në respekt të kushteve konkrete dhe fazat e procesit të anëtarësimit të vendit në BE;

- ndarja e qartë e përgjegjësive institucionale dhe harmonizimi i ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve me ligjin për vetëqeverisjen vendore;

- përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik me kërkesat e VKM-së nr. 290, datë 11.3.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS";

- saktësimi i përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit të mbetjeve dhe kushtet për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Analiza e gjendjes dhe niveli aktual të deritanishëm të zbatimit të legjislacionit ka treguar se zbatimi i dokumentit të politikave strategjike kërkon ndryshime të rëndësishme në strukturën institucionale për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

6.1.1 Mbulimi i kostove dhe i tarifave

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me mbështetjen e programit zviceran për zhvillim lokal dhe decentralizim (DLDP), hartoi dhe miratoi VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", e cila rregullon dhe standardizon llogaritjen e kostove dhe të tarifave, me qëllim që të arrihet përmbushja e parimit "ndotësi paguan".

Zbatimi i dokumentit është detyrim për bashkitë dhe zbatimi ka nisur që nga viti 2018. Ky akt normativ dhe udhëzuesi përkatës siguron një mjet të thjeshtë në përdorim, por të avancuar për llogaritjen e plotë të kostos dhe të tarifës për të gjitha bashkitë e vendit. Cikli i plotë i kostos siguron buxhetim të plotë të shërbimit nga gjenerimi deri në trajtimin e mbetjeve, duke përmirësuar kështu dhe cilësinë e shërbimit dhe tarifa siguron një mbulim të plotë të kostos si parim

kryesor në shërbimet publike. Parime të tjera mjedisore dhe financiare sigurohen dhe përmirësohen me vënien në zbatim të këtij modeli, të cilat janë të detajuara në aktin përkatës dhe udhëzuesin bashkëlidhur tij.

Trajnime intensive janë siguruar për bashkitë dhe planifikohen të vijojnë deri në përvetësimin dhe optimizmin e përdorimit të tij nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Sigurimi i një sistemi funksional kërkon përmirësimin e mëtejshëm të databazave vendore në drejtim të gjendjes civile, pronës, biznesit, institucioneve, adresave etj. Në këtë mënyrë, integrimi i të dhënave do të sigurojë që modeli i kostos dhe i tarifës të funksionojë plotësisht dhe qytetarët të kenë faturim transparent në përmbushje të parimit "ndotësi paguan".

Grafiku më poshtë tregon në mënyrë skematike nevojën e një databaze vendore, e cila mund të sigurojë në formën e *one-stop-shop* të dhëna për kategori të ndryshme përfituesish shërbimi, të cilat mund të depozitohen në këtë databazë unike nga ku më pas të gjitha shërbimet publike, përfshi atë të mbetjeve, mund të gjenerojnë informacion për planifikim dhe faturim të saktë.

Figura 2. Skema e një databaze unike për shërbimet vendore



(Burimi: Udhëzuesi për koston dhe tarifën e mbetjeve: www.km.dldp.al)

6.2 Kuadri institucional

Ministria përgjegjëse për mjedisin

Ministria përgjegjëse për mjedisin ushtron veprimtarinë e saj për zhvillimin e politikave në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Në bashkëpunim me institucione të tjera, ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave, legjislacionit, hartimit dhe monitorimit të zbatimit të dokumentit të politikave strategjike Kombëtare dhe Planit Kombëtar, të studimeve të fizibilitetit e planeve rajonale. Së bashku me institucionet e tjera vartëse, Ministria ka përgjegjësinë e plotë për krijimin dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal dhe vendor. Përgjegjësitë e tjera specifike të ministrisë përgjegjëse për mjedisin përfshijnë, gjithashtu:

- hartimi dhe monitorimi i zbatimit të dokumentit të politikave strategjike dhe Planit Kombëtar, si dhe planeve rajonale;
- hartimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe akteve të tjera nënligjore për të siguruar zbatimin e dokumentit të politikave strategjike dhe Planit Kombëtar, me fokus të veçantë në zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, siç përcaktohet në ligjin kuadër të mbetjeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- lëshon lejet për subjektet që operojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme;
- organizon dhe menaxhon regjistrat e të dhënave të duhura për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve, përcakton

dhe lejon ndërtimin e lendfilleve për mbetjet e rrezikshme.

Buxheti i kësaj ministrie përfshin mbështetje financiare për përmirësimin e kushteve për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

6.2.2 Ministria përgjegjëse për infrastrukturën

Ministria përgjegjëse për infrastrukturën ushtron veprimtarinë e saj në:

- fushën e mbetjeve urbane, në lidhje me planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve;
- bashkërendimi i politikave të infrastrukturës së mbetjeve urbane në komponentin zbatues të tyre dhe në ndjekjen e zbatimin e këtyre politikave;
- drejtimin, menaxhimin, supervizimin dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës së venddepozitimeve të mbetjeve.

6.2.3 Ministri të tjera

Ligji nr. 10463/2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, ngarkon ministritë e tjera, si ministrinë përgjegjëse për financat, ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për hartimin e akteve nënligjore specifike, sipas përgjegjësive që kanë në fushën e mbetjeve.

6.2.4 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe strukturat inspektuese lidhur me sektorin e mjedisit dhe të ujërave

Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila funksionon në bazë të VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019, "Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë vendin dhe organizohet në dy nivele:

a) nivel qendror, përmes drejtorisë së përgjithshme;

b) nivel rajonal, nëpërmjet katër agjencive rajonale të mjedisit.

AKM-ja ka këto funksione kryesore:

1. Sigurimin e performancës mjedisore;
2. Kërkimin dhe dijen mjedisore;
3. Vlerësimin e impaktit mjedisor;
4. Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Strukturat inspektuese ushtrojnë veprimtarinë e tyre lidhur me sektorin e mjedisit dhe të ujërave në pikat e mëposhtme:

- përgatitjen e raporteve periodike mbi vlerësimin e mjedisit;
- përgatitjen dhe ndjekjen e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
- sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit;
- kryerjen e kontrolleve sipas një programi tematik mbi bazë risku;
- sigurimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore;
- shqyrtimin e ankesave për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve;
- bashkëpunimi me inspektoratet e tjera;
- ushtrimin e çdo funksioni tjetër të caktuar në ligje të posaçme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, lejet e mjedisit dhe inspektimin.

6.2.5 Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Për arritjen e objektivave në fushën e mbetjeve, u krijua dhe funksionon Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (KMIM), i miratuar me VKM-në nr. 967, datë 25.20.2013, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të KMIM-së". Komiteti duhet të mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj për të shqyrtuar e për të miratuar dokumentet dhe aktet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve. Komiteti mblidhet dhe në rastet e shqyrtimit të planeve të përmirësimit për venddepozitimet ekzistuese, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre.

6.2.6 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)

AKUM-i është organ shtetëror, i cili ushtron funksionet e tij bazuar në vendimin nr. 431, datë 11.7.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe të Infrastrukturës së Mbetjeve".

6.2.7 Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Roli i bashkive, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, është përcaktuar nga ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Forcimi i rolit të bashkive është një domosdoshmëri, e cila rrjedh nga harmonizimi i ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me dispozitat e ligjit, "Për vetëqeverisjen vendore".

Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve bashkiake, të cilat mblidhen nga/ose për llogari të bashkive dhe përfshijnë:

- mbetjet shtëpiake dhe të ngjashme; përfshirë
- mbetjet e vëllimshme, p.sh., mobilie të vjetra;
- mbetjet e kopshteve, gjethet, prerjet e pemëve nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugëve dhe i tregjeve publike;
- mbetjet nga aktivitetet tregtare dhe bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet;
- mbetjet nga shërbime të tjera bashkiake, si parqet, lulishtet etj.

Bashkitë janë kryesisht përgjegjëse për operimin e shërbimit të pastrimit, mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në pikat e grumbullimit (stacionet e transferimit). Bashkitë mund të ngrenë dhe të operojnë qendra me interes vendor për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, përfshirë mbetjet e vëllimshme, mbetjet e ricikluesshme dhe mbetjet e biodegradueshme.

Ndarja në burim është përgjegjësi e NJQV-së. Sistemet e riciklimit për ambalazhet dhe për mbetje të tjera specifike duhet të ngrihen nga prodhuesit e produkteve dhe/ose industrinë e riciklimit nën skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore dhe të organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre.

Në mënyrë të veçantë, "grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake" është përcaktuar si një funksion "i veti" i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi, për:

- organizimin për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve bashkiake;
- ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit;
- vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhjen e të ardhurave;
- organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vetë bashkinë dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjitha instrumentet ligjore dhe administrative.

6.2.8 Përgjegjësia e prodhuesve dhe e bizneseve të tjera

Prodhuesit dhe sektori tjetër i biznesit, operatorët e shërbimit publik ose privat dhe operatorë të tjerë të licencuar për menaxhimin e kategorive të ndryshme të mbetjeve, duhet të zbatojnë kushtet e lejeve/licencave dhe do të marrin masa teknike, teknologjike dhe organizative për të nxitur parandalimin rikuperimin, riciklimin e mbetjeve dhe depozitimin përfundimtar të sigurt të mbetjeve. Ata duhet të sigurojnë monitorimin dhe raportimin e mbetjeve që prodhojnë, grumbullojnë, rikuperojnë apo depozitojnë.

6.2.9 Roli dhe përgjegjësitë e qytetarëve

Roli kryesor i qytetarëve në sistemin e menaxhimit të mbetjeve është zvogëlimi i sasisë së mbetjeve që prodhojnë, ndërmarrja e nismave të kompostimit në shtëpi (të paktën në zonat rurale) dhe marrja pjesë në sistemet e mbledhjes, riciklimit, rikuperimit dhe depozitimit të mbetjeve shtëpiake, sipas rregullave dhe programeve të bashkive. Qëllimi kryesor është të minimizohet sasia e mbetjeve që depozitohen në sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve, si dhe të sigurojnë pagesën e tarifës së shërbimit, në masën dhe kushtet siç vendosen nga bashkitë ku ata bëjnë pjesë.

Qytetarët duhet të bashkëpunojnë me bashkinë në programe të përbashkëta për zbatimin e hapave të hierarkisë së mbetjeve.

6.3 Kuadri financiar

6.3.1 Financimi nga burimet e qeverisë qendrore, pushteti vendor dhe donatorët e huaj

Gjatë periudhës 8-vjeçare (2011–2019), qeveria shqiptare, në fushën e menaxhimit të mbetjeve ka siguruar një financim në rritje të programimit në buxhet për përgatitjen dhe për përditësimin e kuadrit ligjor dhe investime në infrastrukturë. Financimi nga pushteti vendor pati një rritje të ndjeshme gjatë periudhës 2015–2016, që përkon me shkrirjen e 308 komunave dhe 65 bashkive në vetëm 61 bashki, në kuadër të Reformës Administrative dhe Territoriale. Njëherazi, rritja e shpenzimeve i dedikohet edhe përmirësimit, veçanërisht shtrirjes së mbulimit me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve bashkiake.

Gjithashtu, një komponent kyç është dhe sigurimi i donacioneve të paraqitura me detaje në tabelën e mëposhtme (tabela 1):

Tabela 1. Financimi për MIM 2011–2019 nga buxheti i shtetit dhe ndihma e huaj

Burimi i financimit	Menaxhimi i mbetjeve urbane	Fakt 2011–2019 (000 lek/euro)									
	Shpenzime kapitale	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**TOTAL**
MIE	Financim i brendshëm	70,000	85,442	19,254	119,983	53,406	100,000	189,200	1,492,590	1,908,695	4,038,570
	Financim i huaj	0	80,000	500,000	340,000	300,000	300,000	500,000	104,351	286,690	2,411,041
	TOTALI (ALL)	**70,000**	**165,442**	**519,254**	**459,983**	**353,406**	**400,000**	**689,200**	**1,596,941**	**2,195,385**	**6,449,611**
MTM	Financim i brendshëm	0	0	8,372	458	310,793	1,858,397	1,538,015	0	4,000,000	7,716,035
	Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	65,000	68,000,000	70,000,000	138065,000
	TOTALI (ALL)	**0**	**0**	**8,372**	**458**	**310,793**	**1,858,397**	**1,603,015**	**68,000,000**	**74,000,000**	**145,781,035**
MZHU	Financim i brendshëm	0	0	0	0	0	960	7,700	Nuk funksionon më si institucion		8,660
	Financim i huaj	0	0	0	0	0	0	0	Nuk funksionon më si institucion		0
Burimi financimit	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	0	0	0	960	7,700			8,660
	Shpenzime kapitale	70,000	165,442	527,626	460,441	664,199	2,259,357	2,299,915			6,446,980
MIE	Financim i brendshëm	526	1,244	3,967	3,462	4,994	16,988	17,293			48,474

Burimi: Përmbledhje nga buxhetet e tri ministrive, përkatësisht: MZHU, MTM dhe MIE

7. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake

Procedurat ligjore ngarkojnë bashkitë me përgjegjësi për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe për menaxhimin e impianteve të trajtimit të tyre. Trajtimi përfundimtar dhe depozitimi i MNB-ve është përcaktuar si çështje njëlloj e rëndësishme sa dhe grumbullimi i tyre.

Gjatë vitit 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me programin zviceran për zhvillim lokal dhe decentralizim (DLDP), kanë identifikuar në të gjithë vendin 199 venddepozitime ilegale dhe legale. Në Shqipëri janë në punë vetëm katër lendfille: Bajkaj (Sarandë), Bushat (Shkodër), Maliq (Korçë) dhe Sharrë (Tiranë). Qarku i Elbasanit, si një ndër qarqet më të ndotura në vend e ka zgjidhur menaxhimin e mbetjeve nëpërmjet incinerimit, duke pasur në funksion që prej 2017, një incinerator, si dhe dy lendfille, përkatësisht, një për depozitimin e hireve që dalin nga incineratori, si dhe një lendfill ku janë të depozituara mbetjet që janë shpërngulur nga venddepozitimi ekzistues. Në proces ndërtimi janë dhe dy incineratorë të tjerë, një që ka si qëllim mbulimin e zonës së Fierit dhe një për zonën e Tiranës. Gjithashtu, gjenden edhe objekte të tjera, të cilat mund të konsiderohen si venddepozitime të kontrolluara (tabela 2), ndërsa pjesa tjetër e venddepozitimeve aktuale nuk plotësojnë standardet minimale sanitare. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka menduar për ato bashki, të cilat ende nuk kanë një lendfill sanitar apo incinerator brenda qarkut të tyre, të kryejnë rehabilitimin e një venddepozitimi për çdo bashki për një periudhë tranzitore deri në ndërtim e pikës fundore, në përputhje me standardet mjedisore, ndërsa të gjitha venddepozitimet e tjera duhen mbyllur menjëherë. Aktualisht, bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, me mbështetjen e qeverisë zvicerane – SECO, ka filluar procedurat për rehabilitimin e një venddepozitimi ekzistues për çdo bashki.

Të gjitha lendfillet, i Vlorës (në projekt), administrohen nga njësitë vendore, duke përdorur forma të ndryshme menaxhimi:

- lendfilli i Bushatit menaxhohet nga një operator privat i kontraktuar nga Bashkia Vau i Dejës;
- lendfilli i Sharrës administrohet nga Bashkia Tiranë, si pjesë e nënkontratës me një prej operatorëve privatë të kontraktuar për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve;

- lendfillet e Bajkajt dhe të Vlorës (Sherishtë) administrohen si shoqëri anonime të krijuara nga Këshilli i Qarkut Vlorë;
- lendfilli i Maliqit, nga shoqëria rajonale e menaxhimit të mbetjeve e krijuar nga bashkitë në zonën e mbulimit nga ky lendfill.

Tabela 2. Venddepozitimet e kontrolluara të mbetjeve në Shqipëri, 2019

Nr.	Lendfill ekzistues/në projekt	Sipërfaqja	Kapaciteti (ton ose m^3)	Shënim
1.	Bushat (Shkodër)	12 ha	1 000 000 m^3	Në veprim
2.	Bajkaj (Delvinë)	12.5 ha	600,000 tonë	Në veprim
3.	Sharrë (Tiranë)	15 ha	2 900 000 tonë	Në veprim
4.	Rubik (lendfill industrial)	5 000 m^2	3 500 tonë/vit	Në veprim
5.	Rrëshen	NA	NA	Ne veprim
6.	Dibër	8 000 m^2	-	Në veprim
7.	Papër (Elbasan)	-	9,970 tonë	Në veprim
8.	Maliq	10 ha	1 000 000 tonë	Në veprim
	Faza e ndërtimit			
9.	Fier			Në proces
10.	Tiranë			Në proces
	Faza e fizibilitetit			
11.	Sherishta 1 (Vlorë)	12 ha	1 044 690 m^3	SF përfunduar

(Burimi i informacionit: MIE)

Raportohet se, gjatë vitit 2018, në këto VD, janë depozituar rreth 923,316 tonë/vit (ose 60,61% e mbetjeve) që llogariten si sasia e gjeneruar në vend, prej të cilave vetëm 401,755 tonë/vit (ose 26,37% e tyre) depozitohen në lendfille sanitare, ndërsa pjesa tjetër ose 13,01% e mbetjeve të ngurta shtëpiake hidhen në mënyrë krejt të pakontrolluar.

7.1 Industria e riciklimit në menaxhimin e mbetjeve

Industria e riciklimit është një nga aktorët më të rëndësishëm në menaxhimin e mbetjeve. Riciklimi në vetvete është ndoshta elementi më thelbësor dhe forma më e njohur për zvogëlimin e mbetjeve që zhvillohet nëpërmjet një zinxhiri procesesh, duke përfshirë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin, që çon në zvogëlimin e një sasie të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në lendfill.

Në Shqipëri ka një industri riciklimi të zhvilluar dhe aktive. Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë (SHRSH) raporton së ka rreth 32 anëtarë. Ata janë kompani private riciklimi, të cilat operojnë në Shqipëri. SHRSH-ja raporton se vlera e tregut të investimeve të kësaj industrie arrin në rreth 234.2 milionë euro.

Tabela 3. Industria e riciklimit në Shqipëri

Viti	Nr. i kompanive të regjistruara në SHRSH	Fuqia punëtore	Kapaciteti i instaluar i prodhimit (ton/muaj)	Vlera e tregut, milion/€
2019	32	1,249	41,540	243.2

Burimi: Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë

Kapaciteti përpunues i këtyre kompanive është rreth 498,480 tonë/vit, i cili është më se i mjaftueshëm për të përpunuar të gjitha mbetjet e riciklueshme që gjenerohen në vend, nëse teorikisht supozohet se grumbullimi i diferencuar dhe rikuperimi i tyre nga mbetjet e tjera mund realizohet në një përqindje shumë të lartë.

Siç raportohet nga SHRSH-ja, për shkak të mungesës së lëndës së parë, kjo industri ka angazhuar vetëm 26.8% të kapacitetit prodhues ose 133,592 tonë/vit, i cili përbën rreth 10% të totalit të mbetjeve të ngurta urbane (përfshirë dhe ato jourbane që shoqërojnë mbetjet e ngurta shtëpiake (familjare dhe të tjera të ngjashme) që raportohet nga INSTAT-i. Kjo ka bërë që disa nga kompanitë të zvogëlojnë aktivitetin e tyre, disa të mbyllen, ndërsa disa të tjera po planifikojnë që t'i zhvendosin instalimet e tyre në vende të tjera.

Në vitin 2018, INSTAT-i raporton se në Shqipëri janë ricikluar rreth 245,040 tonë/vit ose sa 18.5% e totalit të mbetjeve të ngurta urbane (përfshirë dhe ato jourbane që shoqërojnë mbetjet e ngurta shtëpiake (familjare dhe të tjera të ngjashme). SHRSH –ja raporton se niveli i riciklimit në Shqipëri është në masën 10%.

Tabela 4. Të dhëna krahasuese mbi sasinë e mbetjeve që riciklohen

Viti	Burimi i informacionit	Sasia e mbetjeve të ricikluara (ton/vit)	% kundrejt totalit të mbetjeve të ngurta urbane
2018	INSTAT	245,040	18.5%
2016	SHRSH	133,592	10%

7.2 Monitorimi i mbetjeve dhe raportimi

Monitorimi për mbetjet është bazuar mbi treguesitm sipas VKM-së nr. 1189, datë 18.11.2009, "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", të cilat janë pjesë e kategorisë Ç, "Treguesit mjedisorë të trysnisë në mjedis", pika 3, të cilët përfshijnë dhe kufizohen, vetëm në:

a) sasitë vjetore të prodhimit;

b) shpërndarjen e mbetjeve sipas bashkive dhe qarqeve;

c) përmbajtjen në përqindje të përbërësve ndotës;

d) përbërjen merceologjike të mbetjeve.

Sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për infrastrukturën/transportin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për industrinë janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve dhe t'ia dorëzojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, brenda datës 10 shkurt të çdo viti.

Gjithashtu, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.5.2015, "Për miratimin e rregullave mbi mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave mbi mbetjet", i cili ka hyrë në veprim në janar 2019, bashkitë janë përgjegjëse për të raportuar të dhënat mbi mbetjet, sipas formularëve bashkëlidhur atij vendimi.

Është vlerësuar që treguesit, për të shprehur gjendjen apo ndikimin e mbetjeve në mjedis apo gjendjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, nuk janë të saktë dhe të mjaftueshëm.

Duke qenë se në Shqipëri nuk ka ende grumbullim të diferencuar, këto të dhëna nuk mund të gjenerohen.

Në këto kushte, do të ishte e nevojshme që të rishikohet tërësisht sistemi i raportimit mbi mbetjet, përfshirë treguesit dhe kushtet në të cilët gjenerohen këto të dhëna, si dhe të përgatitet një udhëzues, i cili të përmbajë detyrimin për peshimin dhe metodikën për të gjeneruar treguesit e tjerë: si përbërësit ashtu edhe elementet ndotëse që vijnë së bashku me mbetjet urbane.

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.3.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS";

8. Rrymat e mbetjeve

8.1 Rryma e mbetjeve të ngurta shtëpiake

Sasitë e mbetjeve të ngurta shtëpiake

Të dhënat e mbetjeve grumbullohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes operatorëve që kryejnë grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve dhe përcillen tek autoritetet përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave të mbetjeve. Sfidë mbetet ende nevoja e një sistemi për të kontrolluar saktësinë e të dhënave që vijnë nga pushteti vendor. Në mënyrë të përmbledhur, në pjesën më të madhe të rasteve kjo gjendje vjen, kryesisht prej:

- mungesës së infrastrukturës për matjen dhe peshimin e mbetjeve;
- mungesës së një metodologjie për matjen dhe analizën e përbërjes së mbetjeve;
- mungesës së një sistemi monitorimi dhe vlerësimi krahasues, në veçanti për mbetjet;
- mbivendosjes së përgjegjësive për mbledhjen dhe përpunimin e këtij informacioni në shumë institucione.

Për të hartuar këtë analizë, janë marrë në konsideratë të dhënat e tri institucioneve: MIE, INSTAT dhe AKM. Ndonëse, për disa vite, seria e të dhënave që janë zgjedhur të analizohen kanë vlera të përafërta, të dhënat e marra prej MIE-s dhe AKM-së, që bazohen në raportimin vjetor të bashkive, mund të vlerësohen si skenari minimal, ndërsa të dhënat që raportohen nga INSTAT-i mund të konsiderohen si skenari maksimal.



Figura 3. Gjenerimi i mbetjeve në Shqipëri, periudha 2010–2018

Duke iu referuar të dhënave për gjenerimin e mbetjeve të ngurta shtëpiake (të ndara në mbetje të ngurta shtëpiake dhe të tjera, të cilat konsiderohen si mbetjet inerte që mblidhen së bashku me mbetjet nga familjet dhe të ngjashme me to) dhe numrit të popullsisë sipas INSTAT-it, për vitin 2018 është llogaritur vlera 0.383 ton/banor/vit, si vlerë bazë për MNB-në nga familjet dhe vlera prej 0.079 ton/banor/vit për mbetjeve inerte që mblidhen së bashku me MNB-në nga familjet. Këto të vlera bazë janë përdorur për projeksionin e mbetjeve në periudhën 2020–2035, që mbulon dokumenti i politikave strategjike.

Tabela 5. Gjenerimi i MNB-së dhe mbetjeve të tjera (inerte) kg/banor/vit

Burimi i informacionit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Sasia e MNB-së, sipas INSTAT-it	1,064,094	1,077,997	1,136,802	827,828	970,818	1,142,964	1,072,236	1,253,913	1,325,071
Sasia e mbetjeve të tjera (inerte)	112,332	112,332	112,332	112,332	258,056	270,269	228,137	92,790	72,879
Popullsia, sipas INSTAT-it	2,918,674	2,907,368	2,903,008	2,897,770	2,892,394	2,885,796	2,875,592	2,873,457	2,866,375
Sasia vjetore e MNB-së, ton/banor/vit	0.365	0.371	0.392	0.286	0.336	0.396	0.373	0.386	0.383
Sasia vjetore, mbetje të tjera (inerte), ton/banor/vit	0.038	0.039	0.039	0.039	0.089	0.094	0.079	0.05	0.079

Sasia totale, kg/banor/vit, MNB dhe të tjera (inerte)	0.403	0.409	0.430	0.324	0.425	0.490	0.452	0.436	0.462



Figura 4. Mesatarja vjetore e gjenerimit të mbetjeve kg/banor/vit, 2010–2018

Në figurën 4 janë shprehur vlerat e sasisë vjetore të gjenerimit të mbetjeve për periudhën 2010–2018, ku vihet re se mesatarja vjetore e gjenerimit të mbetjeve inerte nuk ka ndryshueshmëri të madhe krahasuar me sasinë vjetore të mbetjeve të ngurta shtëpiake.

8.2 Analiza e të dhënave bazë për rrymën e mbetjeve të ngurta shtëpiake

Bazuar në të dhënat e INSTAT-it, për periudhën 2010–2018, shihet që në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm vihet re tendenca e rritjes së gjenerimit për banor në vit.

Tabela 6. Vlera bazë e gjenerimit për banor në vit, si dhe përqindja e rritjes vjetore

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Mediana e sasive vjetore e MNB-së, sipas INSTAT-it	1,064,094	1,077,997	1,136,802	827,828	970,818	1,142,964	1,072,236	1,253,913	1,325,071
Popullsia, sipas INSTAT-it	2,918,674	2,907,368	2,903,008	2,897,770	2,892,394	2,885,796	2,875,592	2,873,457	2,866,375
Sasia vjetore, ton/banor/vit	0.365	0.371	0.392	0.286	0.336	0.396	0.373	0.386	0.383



Grafiku 1. Tendenca e rritjes vjetore të gjenerimit MNB si mesatare

Pritet që kjo tendencë rritjeje të vijojë për të paktën edhe për 5 vjetët e ardhshëm, duke shoqëruar pritshmërinë e rritjes ekonomike dhe të konsumit në Shqipëri. Rritja e sasisë së MNB-së do të kërkojë marrjen e masave të menjëhershme për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri.

Tabela në vijim paraqet vlerat në vitin bazë për treguesit kryesorë, përfshirë:

- popullsinë;
- gjenerimin e mbetjeve të grupuara në nivel qarku dhe kombëtar;
- mbulimin me shërbim/nivelin e grumbullimit të mbetjeve;
- sasinë e mbetjeve që shkojnë në lendfill/trajtim;
- sasinë e mbetjeve që riciklohen; dhe
- sasinë e mbetjeve që nuk grumbullohen .

Vendi	Popullsia	Gjenerimi i MNB-së (ton/vit)	Gjenerimi mbetjet të tjera	Mbulimime, grumbullimin e MNB (%)	MNB të grumbulluara (ton/vit)	MNBqë shkojnë në lendfill (ton/vit)	MNB që shkojnë në lendfill (%)	MNB që nuk grumbullohen (ton/vit)	MNB që nuk grumbullohen (%)
TOTALI	**2,866,5375**	**1,523,256**	**198,185**	**65,7**	**1,325,071**	**1,012,517**	**66.5%**	**4,979**	**0,3%**

Tabela 7. Të dhënat bazë për menaxhimin e mbetjeve bashkiake, viti 2018 (Burimi: INSTAT)

8.3 Rrymat e mbetjeve jobashkiake

Në tabelën e mëposhtme (tabela 8) janë shprehur në përqindje rrymat e mbetjeve në nivel kombëtar, për periudhën 2013–2018.

Tabela 8. Rrymat e mbetjeve në % (Burimi: INSTAT)

Vitet	Mbetje. organike	Letër druri	Letër, karton	Qelq	Plastikë	Tekstile	Metale	Mbetje të Rrezik.	Mbetje të jorrezik.	PC etj	Të tjera inerte	Mbetje të tjera spitalore
2013	41,0	4,0	12,0	7,0	14,0	3,0	3,0	1,1	9,0	3,0	2,1	0,8
2014	50,2	6,1	8,7	4,0	9,1	2,6	5,8	0,9	8,1	3,7	0,5	0,3
2015	51,4	4,6	9,9	4,5	9,6	2,9	4,8	0,5	1,1	8,2	2,5	0,01
2016	49,52	5,84	7,87	4,24	10,01	2,81	3,38	0,23	0,84	11,9	3,34	0,03
2017	45,9	3,9	9,5	4,8	16,8	3,2	2,7	0,2	1,2	7,4	3,4	0,01
2018	61,2	5,1	7,7	3,8	9,7	2,2	1,5	0,2	1,0	5,5	0,1	2,45

Të dhënat e tabelës 9 shprehin sasinë në përqindje të mbetjeve të trajtuara në mënyra të ndryshme, për periudhën 2013–2018.

Tabela 9. Trajtimi i mbetjeve urbane (Burimi: INSTAT)

Vite t	Djegie për energji		Djegie për eliminim		Riciklime		Depozitime në lendfille		Hedhje jashtë lendfillit	
	ton	%	ton	%	ton	%	Ton	%	Ton	%
2013	940	0,1	82.734	8,8	225.638	24,0	475.721	50,6	155.127	16,6
2014	6.144	0,5	38.095	3,1	265.439	21,6	779.112	63,4	140.093	11,4
2015	21.706	1,5	35.875	2,5	357.548	25,3	970.157	68,6	970.157	2,0
2016	9.001	0,69	40.783	3,14	224.155	17,2	1.010.335	77,7	16.103	1,24
2017	22.864	1,8	19.816	1,6	218.181	17,4	791.572	77,5	21480	1,7
2018	36.558	2,8	25.978	2,0	245.040	18,5	1.012.517	76,4	4.979	0,4

8.3.1 Mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi – mbetjet inerte

Mbetjet nga ndërtimet dhe shkatërrimi (MNSH) vijnë nga veprimtari të tillam si ndërtimi i infrastrukturës dhe i ndërtesave, shkatërrimi i pjesshëm ose i plotë i ndërtesave dhe i infrastrukturës, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve etj.

Në kuadër të detyrimeve të ligjit kuadër, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", qeveria shqiptare miratoi VKM-në nr. 575, datë 24.6.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

8.3.2 Mbetjet nga industria dhe minierat

Ky nënkapitull përqendrohet në të gjitha llojet e mbetjeve industriale dhe të minierave, përveç mbetjeve nga industria ushqimore dhe industria e drurit (shih nënkapitullin përkatës).

Ligji bazë, i cili rregullon aktivitetin minerar në Shqipëri dhe, veçanërisht, mbetjet nga minierat është ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".

Aktualisht janë të regjistruar 650 subjekte, të cilat zhvillojnë aktivitetin e nxjerrjes së mineraleve nga miniera, ku spikasin minierat e qymyrgurit, kromit dhe bakrit.

Sipas të dhënave të raportuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sasitë e sterileve nga shfrytëzimi i mineralit në minierat kryesore, deri në fund të vitit 2007, paraqiten në tabelën më poshtë:

Materialet sterile nga shfrytëzimi i minierave	Volumi m^3
Sterile nga minierat e kromit	28,023,660
Sterile nga minierat e bakrit	18,000,000
Sterile nga minierat e qymyrgurit	23,081,530
Sterile nga minierat e ferronikelit	1,112,183

Tabela 10. Sasitë e sterileve të nxjerra nga shfrytëzimi i minierave, sipas llojit të mineralit (Burimi: MIE)

MIE raporton se sasia e mbetjeve, të cilat gjenerohen nga pasurimi dhe shkrirja e mineraleve (mbetje sterile, baltë xeherori, pluhur nga furrat), vlerësohen në rreth 28 milionë tonë.

Të gjitha këto mbetje janë jashtë kontrollit, të lëna pranë ish-minierave, ku përjashtim bëjnë vetëm minierat që janë në aktivitet, dambën nr. 2, Fushë-Arrëz dhe dambën e Bulqizës. Planet e rehabilitimit mungojnë, ku përjashtim bëjnë minierat e Rrëshenin, Reps 3 dhe Fushë-Arrëz 2. Ndërkohë, kanë filluar të përdoren për mbushje mbetjet minerare nga miniera e bakrit në Munellë.

Magazinat e kimikateve të vjetra	Përbërja e kimikateve dhe e mbetjeve	Sasia (e përafërt) në kg
Ndërmarrja për furnizimin e minierave	Cianide dhe kimikate të tjera	15,000
Ish-Kombinati Energjetik	Kimikate për përdorim në laborator	300
Kompleksi Laç	Kimikate për përdorim në laborator	60
Laboratori i impiantit të bakrit, Rubik	Kimikate për përdorim në laborator	70
Azotiku Fier	Acid formik, V2O5, TS 605, *potasium carbonate*	93,300
Dega Rajonale Tropojë	Kimikate për përdorim në laborator	18,300
Laboratori gjeologjik qendror	Kimikate për përdorim në laborator	5,000
Dega Rajonale Rubik	Kimikate për përdorim në laborator	280
Dega Rajonale Pukë	Kimikate për përdorim në laborator	230
TOTALI		**241,270**

Tabela 11. Magazinat e tjera të këtyre mbetjeve në vend, si dhe lloji i kimikateve që ato kanë të depozituar dhe sasia e përafërt e tyre (Burimi: MIE)

Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara	Përshkrimi i gjendjes
Kompleksi i shkrirjes së metaleve Elbasan	1.5–2.0 milionë tonë	Me potencialin më të lartë të ndotjes nga mbetjet e metaleve të rënda, si ***ferronikel dhe ferrokrom***, të trashëguara gjatë 35 viteve të fundit, duke ndotur ujërat e lumit Shkumbin.
Zona e minierës së bakrit Rrëshen	N/A	Një ndër zonat më të mëdha për nxjerrjen e bakrit e vendosur në shtratin e lumenjve Mat–Fan, ku vlerësohet të këtë përqendrime të larta të ***arsenikut dhe të metaleve të renda*** në rrjedhën e lumenjve dhe në sistemin e ujitjes së tokave bujqësore.
Zona e minierës së bakrit Kurbnesh	N/A	Vlerësohet si një ndër zonat më të mëdha të shkatërruara nga depozitat e mbetjeve me përqendrime të larta të ***bakrit,*** shumë pranë rrjedhave të lumenjve Mat–Fan.
Zonat e bakrit Rubik dhe Reps	N/A	Vlerësohet si një nga zonat minerare me prodhimtari më të lartë (rreth 350 k t në vit) dhe njihet për depozitat e ***bakrit,*** të cilat janë shumë pranë rrjedhës të lumit Fan.
Zona e minierës së bakrit Fushë-Arrëz	N/A	Një nga zonat më të mëdha të minierave të ***bakrit*** në vend, e cila prodhonte rreth 320,000 Mt/vit xeheror bakri (kur operonte me kapacitet të plotë).
Zona e depozitave të ferronikelit Pogradec	N/A	Në këtë zonë ka depozita të mbetjeve nga ***ferronikel*** të depozituara pranë liqenit të Ohrit nga minierat e dikurshme në Përrenjas, në Gurin të Kuq dhe në Bitinskë.
Zonave e minierave të bakrit Rehovë	N/A	Zonë e minierës së ***bakrit*** në rrjedhën e lumit Osum, në kufi me Greqinë. Raportohet të jetë një zonë e ndotur dhe bar i djegur rreth saj.
Zona e minierave të bakrit Kalimash/Kukës, Gjegjan	N/A	Zonë e minierës së ***bakrit***, ku përqendrime të ***arsenikut*** shkarkohen në ujërat e Drinit të mesëm. Zona e Gjegjanit raportohet të jetë më e ndotura.
Nxjerrja e naftës në Ballsh, Kuçovë, Patos Marinzë	Në zonën e Ballshit shkarkohen rreth 20,000 tonë naftë në mjedisin përreth	Në zonën e Patos-Marinzës ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore ndoten seriozisht nga puset e naftës, gjatë nxjerrjes me pompa, nga tubacionet dhe impiantet e paratrajtimit dhe në ajër shkarkohen gazi sulfurik dhe hidrokarbure të ndryshme. Ujërat e përdorura nga këto impiante shkarkohen në ujërat e lumit Gjanicë, ku përveç ***përbërësve të naftës*** kanë edhe ***lëndë toksike***
Mbetjet plastike nga PVC Lushnjë	N/A	**N/A**
PVC Vlorë	N/A	5 km larg qytetit të Vlorës, 5–6 ha të fabrikës së vjetër të PVC-ve, janë të ndotur më ***Hg*** deri në një thellësi 1.0– 1.5 m nën nivelin e tokës
Uzina e azotikut Fier	850 m^3 solucione të mbetura nga prodhimtaria e uzinës	Potencialisht toka dhe ujrat nëntokësore janë të ndotura, me përmbajtje ***arseniku***, të cilat derdhen në tubacionet e ujit të pijshëm apo shkarkohen në rrjedhën e lumenjve

Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara	Përshkrimi i gjendjes
Mbetjet e pakontrolluara në lendfillin e Sharrës	N/A	N/A
Fabrika e superfosfatit Laç	30,000 tonë mbetje hekuri	Mbetjet janë të depozituara në zonën e fabrikës, e cila nuk kishte parashikuar shtresa mbrojtëse apo sistem drenazhimi
Impianti i prodhimit të letrës Lezhë	N/A	N/A
Depozitat në Balëz Elbasan	216 tonë mbetje kimikatesh, si diklorometan, kripëra të arsenikut, nitrate amoni, hidrokside të amonit	Në vitin 2008 u evidentua depozitimi i mbetjeve të kimikateve, si: diklorometan, kripëra të arsenikut, nitrate amoni, hidrokside të amonit etj. (PNUD). Në vitin 2010, rreth 90 tonë kimikate nga magazina në **Balëz të Elbasanit** u ripaketuan dhe u transportuan për në Gjermani, Belgjikë dhe Greqi nga një kompani greke
Zona e Porto-Romanos Durrës	N/A	Një nga zonat më të ndotura që në fillim të viteve '90 prej Ndërmarrjes së Kimikateve. Është vlerësuar prania e një sasie të madhe të kimikateve të rrezikshme të depozituara, si ***keksaklorocikloheksane dhe krom (VI)***. Këto kimikate vlerësohen si shumë të rrezikshme, që shkaktojnë dëme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e njerëzve. Dhurime të huaja kanë bërë të mundur që ndër vite të ndërmerren fushata pastrimi të kësaj zone. Më 2004-ën, një fond i Bankës Botërore mundësoi pastrimin e një sipërfaqeje prej 78,000 m² . Gjatë vitit 2010–2011, një fond i Qeverisë Holandeze mundësoi pastrimin e 3 pikave të nxehta, duke mbledhur në mbrojtëse të veçanta rreth 60,000 m³ tokë të ndotur.
Stacioni hekurudhor në Bajzë të Shkodrës	80 tonë mbetje të sodium florsilikatit dhe mbetje të trajtimit të lëkurave	Në vitet 1991–1992, **kimikate të rrezikshme** të transportuara nga Gjermania u lanë në kushte aspak të favorshme. Një vit më pas, 1993, një pjesë e tyre u rikthyen përsëri në Gjermani, por pjesa më e madhe e tyre mbeti atje. Një investigim i vitit 2008, identifikoi rreth 80 tonë të sodium florsilikatit dhe mbetje të trajtimit të lëkurave. Një pjesë e këtyre mbetjeve u eksportua në Britaninë e Madhe për asgjësim dhe një pjesë e tyre u depozitua në një lendfill në Shqipëri.

Tabela 12. Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri

8.3.3. Mbetjet nga bujqësia dhe nga industria e përpunimit të drurit

Mbetjet bujqësore prodhohen në ferma nga rritja e blegtorisë dhe në proceset e përpunimit të industrisë së ushqimit. Disa nga këto mbetje përdoren në bujqësi si pleh organik dhe një pjesë e papërfillshme përdoret në prodhimin e energjisë.

Tabela 13. Sasia e biomasës nga mbetjet bimore

Bimë	Sipërfaqja totale (000/ha)	Biomasa totale (000/ton)
Ullinj	35	52,5
Agrume	0,54	0,5
Vreshta	7,18	15
Pemë frutore (mollë, kumbulla, pjeshkë etj.)	11,3	22,6
Biomasa totale e pemëve	**54**	**91**

Burimi: Sulce, S. dhe Guri, 2008. Analiza dhe studimi i fizibilitetit të zinxhirit të biomasës në Shqipëri

Potenciali i biomasës së përdorshme nga pemët frutore, në të gjithë vendin, llogaritet të jetë rreth 50,000 tonë/vit.

Nga zhvillimi i blegtorisë, mbetje të konsiderueshme prodhohen në formën e jashtëqitjeve, të cilat së bashku me kashtën dhe mbetjet e tjera formojnë plehun organik.

Tabela 14. Sasia e biomasës nga mbetjet shtazore

Blegtoria	Sasia (në milion)	Sasia e jashtëqitjeve (në milion ton/vit)
Gjedhë	0.493	0.14
Lopë	0.355	0.71
Të imëta	2.581	0.25
Derra	0.164	0.02
Njëthundrakë	0.098	0.09
Shpendë	8.437	0.35
TOTALI	**12.128**	**1.56**

Burimi: Karaj, at al 2009. Analiza e mbetjeve të biomasës për prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri. Renewable and Sustainable Energy Reviews, 14, 493–499

Në vitin 2005, në Shqipëri, janë prodhuar rreth 1,56 milionë tonë mbetjesh blegtorale. Vlerësohet se gjysma e kësaj sasie përdoret si pleh organik në bujqësi, një sasi e papërfillshme përdoret në prodhimin e energjisë (në formë të biogazit) dhe mbetjet nga ky sektor llogariten në rreth 0.7 milionë tonë në vit.

Kapaciteti i përdorimit të pyjeve në vendin tonë është rreth 2.2 milionë m^3 ose rreth 1.5 milionë tonë/vit. Duke supozuar që 35% e kësaj sasie përdoret si burim për ngrohje, 50% për përdorim industrial dhe 15% lëndë që mbetet në pyje, mund të supozojmë se sasia e mbetjeve nga pyjet është 0.2 milion ton/vit.

Kështu që, sasia totale e mbetjeve bujqësore, blegtorale dhe pyjore, të konsideruara si pjesë e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve, vlerësohet në rreth 0.95 milionë tonë në vit.

8.3.4 Mbetjet e rrezikshme

Gjeneruesit e të gjitha kategorive të mbetjeve të rrezikshme janë përgjegjës për menaxhimin e tyre nga faza e prodhimit, grumbullimit, transportit dhe magazinimit, si dhe aktorë të tjerë, pjesë e zinxhirit menaxhues të tyre, transportuesit apo trajtuesit e mbetjeve.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët bëjnë grumbullimin, transportin dhe magazinimin e mbetjeve të rrezikshme, duhet të pajisen me leje mjedisi, siç parashikohet në kategorinë III, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", në të cilat përcaktohen rregullat e shëndetit dhe të sigurisë për transportin e mbetjeve të rrezikshme.

Në përmbushje të standardeve për mbajtjen e të dhënave për sasinë, natyrën dhe origjinën e mbetjeve të rrezikshme dhe destinacionin përfundimtar të tyre, aktualisht janë në fuqi dy vendime: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.4.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre".

Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, në Shqipëri nuk ekziston infrastruktura bazë apo ajo plotësuese për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme. Për më tepër nuk ekzistojnë të dhëna mbi sasinë dhe rrymat e mbetjeve. Vendet për ndërtimin e objekteve për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme apo të qendrave pritëse nuk janë përcaktuar ende në asnjë rajon apo qytet të vendit. Dy zona të nxehta mjedisore, specifikisht, një në Fier (në territorin e ish-UPA Fier), për Arsenikun dhe një në Vlorë (territori i ish-Uzinës së Sodës Kaustike) për Zhivën janë pastruar nga mbetjet e trashëguara nga e kaluara dhe, aktualisht, janë të kapsuluara. Këto funksionojnë si zona të kapsuluara që monitorohen pas mbylljes në bazë të kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore që kanë.

Gjithashtu, MIE ka ngritur Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme në Elbasan, e cila ka si detyrë grumbullimin e kimikateve të mbetura nga ish- ndërmarrjet shtetërore, në varësi të MIE-s, si ambalazhimin transportin dhe magazinimin e sigurt të tyre. Aktualisht, kjo qendër funksionon normalisht dhe vazhdon të grumbullojë kimikate nga ish-ndërmarrjet që janë në proces likuidimi ose janë mbyllur.

Një çështje kritike është edhe barra e trashëguar nga aktiviteti i mëparshëm industrial, duke përfshirë edhe hedhjen e pakontrolluar të mbetjeve të rrezikshme, ndotjen e pikave të nxehta mjedisore dhe ruajtjen e kimikateve të papërdorura, të vjetruara ose të ndaluara.

8.3.5 Ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet

Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 6.3.2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", në linjë me direktivën e mbetjeve të BE-së, Shqipëria miratoi të njëjtat objektiva specifikë, si ata të BE-së, duke synuar sa më shumë riciklimin e mbetjeve nga ambalazhet. Miratimi i këtij vendimi të Këshillit të Ministrave pasohet nga miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 232/2018, që ka si qëllim prodhimin e qeseve plastike me trashësi më të mëdha se 35 mikronë.

8.3.6 Automjetet në fund të jetës

Menaxhimi i mbetjeve nga automjetet në fund të jetës, përveç ligjit kuadër, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", është i rregulluar nga VKM-ja nr. 705, datë 10.10.2012, "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës", e cila transpozon plotësisht direktivën (2000/53/EC).

Lloji	Drejtoria rajonale që ka kryer çregjistrimin 2018 sipas qarqeve												Totali (automjete të dala jashtë përdorimi sipas llojit)
	BR	DR	EL	FR	Gj	KO	KU	LE	DI	SH	TR	VL	
APV	1	2		2		2		1	1	1	22	1	**33**
ATP	25	86	48	84	9	28	10	27	15	49	177		**593**
ATV	5	12	1	17	4	2		2		1	44	3	**91**
AUTOBUS	6	17	20	11	3	9	1	3	2	7	26	8	**113**
AUTOKARRO												1	**1**
AUTOVETURË	336	1176	689	997	175	378	197	524	308	698	2383	612	**8473**
CIKLOMOTOR								1		8	13	1	**23**
GJYSMËRIMORKIO	1	5	2	3	2		2			1	6	2	**26**
KAMION	12	13	11	13	3	13	1	8	3	8	39	6	**130**
MB						1							**1**
MOTOKARRO	3	3	1			3		1	1	1	12	2	**27**
MOTORË	7	12	25	29	2	1		9	7	32	47	7	**178**
MT						2							**2**
MTP				4								1	**5**
RK										1			**1**
RPV			**1**										**1**
RTM			1			1	4				2		**8**
RTV		1		1							1		**3**
TËRHEQËS	1	33	5	13	5	5		1	1	1	23	1	**89**
Totali (automjete te dala jashtë përdorimi, sipas qarqeve)	**397**	**1360**	**804**	**1174**	**203**	**447**	**215**	**577**	**338**	**808**	**2795**	**680**	**9798**

Tabela 15. Automjetet e dala jashtë përdorimit për çdo qark (Burimi: INSTAT)

8.3.7 Gomat e përdorura

Sipas kërkesave të ligjit kuadër, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", qeveria shqiptare miratoi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura", ku përcaktoi rregullat dhe kriteret për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga gomat, duke përfshirë mbledhjen/grumbullimin, transportimin, ruajtjen/magazinimin dhe trajtimin e tyre.

Në vitin 2012, qeveria shqiptare, miratoi VKM-në nr. 957, datë 19.12.2012, "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", i cili transpozon direktivën 2002/96/EC.

8.3.8 Mbetjet nga llumi i impianteve të trajtimit

Në vitin 2015 është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.2.2015, "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura", i cili synon rregullimin e përdorimit korrekt në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura për të parandaluar efektet e dëmshme në tokë, bimësi, kafshë dhe te njerëzit. Të gjitha llumrat që dalin nga trajtimi i ujërave të ndotura nuk mund të përdoren në bujqësi, nëse ato nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar në vendimin për sasinë e metaleve të rënda që ato përmbajnë. Si rregull, të gjitha llumrat që gjenerohen nga trajtimi i tyre duhet të ruhen për një periudhë 6-mujore, para se të përdoret në bujqësi.

Sipas të dhënave të raportuara nga raporti i performancës, për shoqëritë e ujësjellës- kanalizimeve për vitin 2016, Enti Rregullator i Ujit në Shqipëri, 79.4% e popullatës mbulohen më shërbimin e ujit të pijshëm dhe 50.7% e tyre kanë sistem të kanalizimeve.

Në vendin tonë janë planifikuar gjithsej 23 impiante të trajtimit të ujërave urbane, ndër të cilat 10 janë në funksionim, 2 janë në ndërtim dhe 11 të tjera janë në fazën e studimit të fizibilitetit. Kur këto impiante do të punojnë me kapacitet të plotë, sasia e mbetjes së thatë që do të dalë nga trajtimi i ujërave urbane do të jetë rreth 35,000 tonë mbetje në vit. Nëse nuk do të merren masa për trajtimin e kësaj mbetje të thatë (llumi), duke zbatuar metodat e riciklimit, ai do të kthehet shumë shpejt në një problem serioz.

8.3.9 Mbetjet nga nënproduktet e kafshëve

Kuadri ligjor shqiptar, në lidhje me mbetjet nga produktet shtazore, të cilat nuk janë për konsum nga njerëzit, rregullohet nga ligji kuadër, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ku ato klasifikohen si mbetje jourbane dhe janë përgjegjësi e prodhuesit të tyre, për të ndjekur ciklin nga prodhimi deri në trajtimin përfundimtar tyre. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për përcaktimin e një vendgrumbullimi në territorin e tyre, ku prodhuesit e këtyre mbetjeve të mund të sjellin mbetjet për trajtim përfundimtar.

Nga ana tjetër, ligji 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i cili ndër shumë direktiva, transpozon edhe direktivën 96/23/KE, "Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore", përcakton se përgjegjësinë për ndjekjen e të gjithë procesit të trajtimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve e kanë shërbimet veterinare në qarqe në të gjithë territorin e vendit.

Nga të dhënat e raportuara nga AKM-ja, në raportin e fundit të gjendjes së mjedisit, në lidhje me sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve, 12 qarqe (41 bashki) kanë raportuar për vitin 2018, në lidhje me sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve, të dhënat e paraqitura në tabelën më poshtë:

Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve e raportuar nga NJQV-të në AKM për vitin 2018	2018 (kg)
Qarku Shkodër	503,000
Qarku Elbasan	1,424,170
Qarku Korçë	30,000
Qarku Fier	427,400
Qarku Gjirokastër	112,140
Qarku Lezhë	30,000
Qarku Berat	2,531,000
Qarku Kukës	6,000
Qarku Durrës	1,462
Qarku Dibër	16,000
Qarku Tiranë	11,440
Qarku Vlorë	650,000
TOTALI	**5,742,612**

Tabela 16. *Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve të raportuara nga NJQV-të për vitin 2018 (Burimi: AKM - Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2018)*

8.3.10 Mbetjet nga vajrat e përdorura

Bazuar në ligjin kuadër, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", qeveria shqiptare miratoi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 7.11.2012, "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura", ku në fokusin e tij janë vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale apo sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilat ato janë prodhuar.

Sipas të dhënave të raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, gjatë vitit 2019, sasia e vajrave lubrifikante që janë importuar në vendin tonë është ***889.420.611 litra***. Të dhënat e marra nga inspektorati përgjegjës për mjedisin raportojnë së në vend operojnë 364 kompani, të cilat prodhojnë vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndryshe vajrat bruto, në sasi mesatare vjetore prej **8,915 tonësh**. Kjo sasi është destinuar për t'u kthyer në mbetje të vajrave të përdorura.

Ndërkohë, në Raportin e Gjendjes së Mjedisit 2018, raportohet që vetëm ***396,310 litra*** vajra të përdorura janë tërhequr për t'u trajtuar, ndërsa pjesa tjetër është depozituar në mjediset e prodhimit ose është hedhur në mënyrë të paligjshme. Në tabelën më poshtë paraqitet ecuria e sasisë së vajrave të përdorura të trajtuara gjatë tre vjetëve të fundit në 12 qarqe nga kompani të licencuara prej AKM-së:

Sasia e VP-së së dorëzuar në subjekte të licencuara për menaxhim dhe për riciklim (litra)	2014	2015	2018
Tiranë	2,520	2,540	0
Durrës	12,229	14,664	0
Lezhë	Nuk ka të dhëna	3,350	12,000
Gjirokastër	Subjekte të palicencuara	3,030	10,850
Vlorë	Subjekte të palicencuara	4,000	30,000
Berat	Subjekte të palicencuara	7,650	101,000
Fier	58,210	32,540	16,200
Kukës	1,600	8,290	5,000
Shkodër	1,360	1,960	1,000
Dibër	Subjekte të palicencuara	10,560	13,000
Elbasan	386,770	200,000	33,260
Korçë	4,180	3,080	174,000
TOTAL	**466,869**	**291,664**	**396,310**

Tabela 17. Sasia e vajrave të dorëzuara në subjekte të licencuara për menaxhimin dhe riciklimin e tyre gjatë tre vjetëve: 2014, 2015, 2018 (Burimi: AKM - Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2018)

Në vend ekzistojnë rreth **15 kompani** të pajisura me licencë që veprojnë për grumbullimin, transportin, ruajtjen, trajtimin, riciklimin dhe përpunimin e vajrave të përdorura, vajrave të përdorura lubrifikuese dhe mbetjeve nga hidrokarburet.

Duke u mbështetur në të dhënat e INSTAT-it mbi tipologjinë e mjeteve dhe mbi supozimet lidhur me konsumin e vajit nga çdo kategori e mjeteve të transportit, rezulton se në vend, potencialisht mund të prodhohen 1.5–3.9 milionë litra vaj i përdorur. Sasia e grumbulluar e vajit të përdorur përbën vetëm 7–18% të sasisë totale të vajit të përdorur.

8.3.11 Mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët

Në procesin e përafrimit të legjislacionit mjedisor me atë të BE-së, në vitin 2012, qeveria shqiptare miratoi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 4.12.2012, "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre". Në tabelat e mëposhtme janë të dhënat mbi sasitë e hedhura në treg të baterive dhe të akumulatorëve, si dhe mbetjeve të gjeneruara në vitin 2018.

Bateritë dhe akumulatorët	2018	
	kg	copë
Pila dhe bateri primare	2,841,854	326,392
Akumulatorë elektrikë	808,494	4,490,239
TOTALI	**2,928,625**	**4,817,631**

Tabela 18. Sasia e baterive dhe e akumulatorëve në Shqipëri për vitin 2018 (Burimi: MTM)

Sasia e mbetjeve nga bateritë e raportuar nga NJQV-të në AKM për vitin 2018	Pesha (kg)
Qarku Tiranë	0
Qarku Shkodër	134,000
Qarku Korçë	2,000
Qarku Fier	43,460
Qarku Gjirokastër	5,150
Qarku Lezhë	16,750
Qarku Berat	406,330
Qarku Kukës	4730
Qarku Vlorë	12,500
Qarku Durrës	274
Qarku Elbasan	166,300
Qarku Dibër	17,000
TOTALI	**808,494**

Tabela 19. Sasia e mbetjeve nga bateritë të raportuara nga NJQV-të për vitin 2018 (Burimi: AKM - Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2018)

8.4 Ndotësit organikë të qëndrueshëm

Bazuar në ligjin kuadër, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", në vitin 2015, qeveria shqiptare miratoi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 6.5.2015, "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura", i cili transpozon plotësisht direktivën 96/59/KE për asgjësimin e bifenileve të poliklorinuara dhe trifenileve të poliklorinuara (PCB/PCT).

8.5 Mbetjet spitalore

Në vitin 2010, qeveria shqiptare miratoi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 29.9.2010, "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", e cila bazohet në një kuadër ligjor tashmë të shfuqizuar për menaxhimin e mbetjeve. Një akt i ri ligjor është në proces miratimi.

Koncepti teknik i menaxhimit të mbetjeve spitalore do të bazohet në ndarjen e mbetjeve spitalore në rryma, sipas niveleve të ndryshme të rrezikut në shëndet dhe në mjedis dhe metodave më efektive të trajtimit të tyre. Destinacioni përfundimtar i tyre do të jetë depozitimi në lendfillin e mbetjeve pas largimit të rrezikshmërisë së tyre nëpërmjet incenerimit të dedikuar vetëm për këto lloj mbetjesh ose grirjesh/dezinfektimit në impiantet me presion dhe temperaturë të lartë.

Mbetjet jo të rrezikshme spitalore janë të ngjashme me mbetjet urbane, ndaj grumbullohen dhe menaxhohen njësoj si mbetjet urbane. Më pak se 20% e totalit të mbetjeve spitalore i përkasin kategorisë së mbetjeve të rrezikshme spitalore, të cilat vetë ndahen në:

- mbetje infektive 80%;
- mbetje të mprehta 8 %;
- mbetje patologjike 5%;
- mbetje farmaceutike 3 %;
- mbetje kimike 2 %;
- mbetje citotoksike 2 %.



Grafiku 2. ***Përbërja e mbetjeve spitalore***

Inspektoratet përgjegjëse, përkatësisht për mjedisin dhe për shëndetësinë, si organe kompetente për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit, inspektojnë institucionet e kujdesit shëndetësor që gjenerojnë mbetjet spitalore dhe kompanitë që trajtojnë këto mbetje, për sa në kompetencë të tyre, në lidhje me respektimin e legjislacionit për administrimin e mbetjeve spitalore (që përfshin grumbullimin, magazinimin, transportin dhe trajtimin e tyre).

9. KONKLUZIONE DHE REKOMAN-DIME

9.1 Gjetje të përgjithshme

Ka disa aspekte të ligjit për MIM-në dhe të disa akteve nënligjore, zbatimi i të cilave ka vend për përmirësim, ndërmjet të tjerash përmendim:

- objektivat dhe treguesit e performancës për grumbullimin e mbetjeve, në mënyrë të diferencuar, sipas dokumentit të politikave strategjike;
- zbatimi i hierarkisë së mbetjeve;
- planifikimi dhe zbatimi i planeve në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar;
- ndarja në burim dhe riciklimi i mbetjeve, së bashku me treguesit për objektivat e dhënë nga dokumenti i politikave strategjike dhe të materializuar në ligjin kuadër për MIM-në dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- mungesa e rrjetit të integruar të objekteve të trajtimit të mbetjeve;
- ndërtimi dhe funksionimi i një baze të dhënash të plota dhe të besueshme;
- mbivendosja e përgjegjësive të aktorëve pjesëmarrës dhe të grupeve të ndryshme të interesit.

9.2 Gjetje të veçanta

9.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional

- Kuadri institucional në nivelin qendror për menaxhimin e mbetjeve përfshin dy ministri kryesore, respektivisht MTM-në dhe MIE-n, si dhe agjencitë e tyre vartëse me detyra të shpërndara dhe të mbivendosura mes tyre.
- Numri i punonjësve në secilin institucion qendror apo të varësisë duhet të jetë më i madh në numër, me qëllim realizimin e të gjithë objektivave të përcaktuar në kuadrin ligjor, brenda afateve kohore.
- Të gjithë aktorët pjesëmarrës dhe grupet e interesit që veprojnë në sektor, përfshirë qeverinë qendrore dhe aktorët e tjerë, duhet të ndërtojnë një kuptim të përbashkët dhe të njësuar mbi rolin, përgjegjësitë dhe kapacitetet e bashkive, në mënyrë që të performojnë, në përputhje me kërkesat e ligjit

për MIM-në dhe direktivës kuadër të BE-së për mbetjet.

- Sistemi për grumbullimin e mbetjeve është i shtrirë vetëm në një pjesë të vendit, prandaj grumbullimi i mbetjeve duhet të përbëjë prioritetin kryesor të vendit në periudhën afatshkurtër, duke filluar gradualisht me zbatimin e hierarkisë.

- Sistemi ose hierarkia e planifikimit duhet të ndryshojë, duke i dhënë përparësi dokumentit të politikave strategjike, në nivelin e parë, Planit Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivelin e dytë, studimeve të fizibilitetit/planeve rajonale për zonat e mbetjeve në nivelin e tretë dhe të planeve vendore në nivelin e katërt.

- Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve është përgjegjësi e pushtetit lokal dhe mbetet ende një sfidë për vendin.

- Realizimi i afateve dhe objektivat e vendosur me ligj nuk janë realizuar në kohën e caktuar.

- Objektivat për ripërdorimin dhe reduktimin e mbetjeve nëpërmjet riciklimit do të arrihen vetëm nëse vihen në zbatim skemat për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

- Disa njësi të vetëqeverisjes vendore, si persona juridikë, e kryejnë aktivitetin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit si detyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një drejtorie ose një kompanie publike bashkiake, të cilat duhet të jenë të licencuara.

- Për grumbullimin dhe raportimin e të dhënave, detyrat e caktuara me ligj për bashkitë dhe qarqet lidhen vetëm me raportimin vjetor të zbatimit të planit. Përgjegjësitë për raportimin janë shtrirë edhe në institucione të tjera, duke u forcuar me anë të vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687/2015, "Për vendosjen e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave për mbetjet", zbatimi i të cilit ka filluar prej 1 janarit 2019. Zbatimi i këtij vendimi duhet të shtrihet edhe mbi gjeneruesit e mbetjeve meqë bën përgjegjës bashkitë e vendit.

- Për shkak se disa rajone të vendit kanë shtrirje të madhe është menduar zëvendësimi i konceptit të rajonit me një koncept të ri për zonat e mbetjeve. Futja e këtij koncepti përmirëson menaxhimin e mbetjeve në çdo bashki të Shqipërisë.

9.2.2 Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve

Menaxhimi i integruar i mbetjeve do të kryhet mbi bazën e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve, të përcaktuara mbi bazën e parimeve të afërsisë dhe të përballueshmërisë.

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM) është një territor i mbuluar nga juridiksioni i një ose më shumë bashkish, të cilat karakterizohen nga tipologji gjeografike e ngjashme dhe që siguron një rrjet rrugor komunikimi të pandërprerë, i cili lehtëson mbledhjen dhe transportin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit dhe të transportimit në destinacionet e trajtimit paraprak, rikuperimit dhe depozitimit përfundimtar të mbetjeve.

Zona e mbetjeve përfaqëson njësinë bazë për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Çdo bashki duhet të jetë pjesë e një ZMM-je. ZMM-ja të miratohen nga këshillat bashkiakë të njësive që bëjnë pjesë në atë territor dhe autorizohen nga pushteti qendror.

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve karakterizohet nga:

1. Kufijtë e zonës janë bazuar mbi një marrëveshje ndërbashkiake bashkëpunimi dhe/ose nga miratimi i Këshillit të Qarkut (kur kufijtë e zonës përputhen me kufijtë administrativë të qarkut);

2. Përfaqëson një zonë, e cila është pranuar nga pushteti qendror;

3. Zona përmban objekte të rëndësisë zonale për trajtimin e mbetjeve të përbërë nga një qendër për trajtimin e integruar të mbetjeve, përfshirë një qendër për rikuperimin e materialeve të ricikluesshme dhe të kompostueshme, një impiant për trajtimin përfundimtar të mbetjeve i ndërtuar dhe që operohet në përputhje me standardet e përcaktuara në direktivën përkatëse të BE-së.

4. Mbulimi me shërbim: objektet e grumbullimit (stacionet e transferimit dhe/ose të trajtimit paraprak janë vendosur në një distancë që merr në konsideratë shkallën e eficiencës minimale, duke përfituar nga ekonomia e shkallës dhe siguron një mbulim eficient me shërbim, duke përfshirë:

a) sasinë dhe përbërjen e mbetjeve për një periudhë kohore të caktuar;

b) sasinë minimale dhe ekonominë e shkallës për objektet e trajtimit dhe të depozitimit të mbetjeve (mbi parimin e mbulimit të kostos dhe vetëqëndrueshmërisë);

c) kriteret logjistike, përfshirë kushtet fizike të rrjetit rrugor për transportin e mbetjeve, kostot e transportit kundrejt përfitimeve nga ekonomitë e

shkallës për njësi më të mëdha rikuperimi dhe depozitimi;

d) alternativat/mundësitë për t'u lidhur me objekte të tjera ekzistuese ose të projektuara për trajtimin në një zonë apo zona të menaxhimit të mbetjeve fqinje.

9.2.3 Koncepti i menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkiake

Ky koncept nënkupton garantimin e grumbullimit të mbetjeve në të gjithë vendin dhe menaxhimi i integruar i tyre, në përputhje me standardet minimale bazë. Paralelisht me të, duhet funksionimi për grumbullimin e diferencuar të tyre në burim dhe riciklimi i rrymave të ndryshme të mbetjeve.

Skema në vijim do të jetë bazë e zgjedhjes së opsioneve teknologjike për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Kjo skemë nuk është detyruese dhe duhet rishikuar dhe përshtatur bazuar në nevojat vendore/rajonale.



Figura 5. Opsionet e trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake

Koncepti i menaxhimit të mbetjeve do të bazohet mbi një sistem me katër nivele trajtimi:

- grumbullimin dhe transportin e mbetjeve (përfshirë grumbullimin e ndarë në burim)
- trajtimin paraprak (nëpërmjet stacioneve të transferimit, objekteve të rikuperimit të materialeve, trajtimin mekanik dhe biologjik);
- rikuperimin (përmes qendrave të riciklimit për rrymat e ndryshme të mbetjeve, kompostimin dhe kapjes së gazit të gjeneruar nga kompostimi).
- trajtimim përfundimtar (lendfill ose incineratorë, me dhe pa rikuperim efektiv të energjisë).

Kjo qasje do të lejojë që menaxhimi i mbetjeve dhe zgjedhja e mënyrës së grumbullimit dhe e opsioneve të teknologjisë së trajtimit të ndjekë rendin e qasjes së hierarkisë së mbetjeve të dhënë në këtë dokument dhe të arrihen targetet e legjislacionit evropian për mbetjet, ndërmjet të tjerash ato të përshkruara në Direktivën Kuadër të Mbetjeve (DKM)

Zgjidhjet teknike dhe teknologjike për rrymat e ndryshme të mbetjeve duhet të përmbushin standardet minimale.

Mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve duhet gradualisht të mbulojë të gjithë popullatën. Me kohë duhet të sigurohet kalimi gradual drejt ndarjes në burim të materialeve të riciklueshme dhe futjes së teknologjive të trajtimit paraprak.

Opsioni i depozitimit përfundimtar të sigurt do të përmbushet përmes teknologjisë së lendfillit sanitar të kontrolluar, i cili është vendosur në një vend të sigurt dhe operohet në standardet e një

lendfilli të mirëfilltë, ku realizohet kontrolli i menaxhimit dhe i funksionimit, i shkarkimit të gazeve dhe lëngjeve të ndotura. Disa të tillë janë ndërtuar në Shqipëri, si në Bajkaj, Bushat, Korçë dhe dy janë fazën e projektimit, në Vlorë dhe Berat. Funksionimi i depozitimit në lendfill sipas standardeve të BE-së do të sigurohet me kohë. Vendet e mëparshme të depozitimit do të mbyllen dhe do të rehabilitohen, duke u zëvendësuar me lendfille sanitare rajonale të reja (ose të përmirësuara).

Rikuperimi i energjisë nga mbetjet do të bëhet i mundur përmes incinerimit dhe teknologjive të tjera. Një incinerator është ndërtuar në Elbasan dhe janë në proces ndërtimi i dy të tjerëve, në Fier dhe Tiranë.

Me ritme të shpejta do të sigurohet kalimi gradual drejt ndarjes në burim të materialeve të ricikluesshme dhe futjes së teknologjive të trajtimit paraprak dhe të depozitimit, në përputhje të plotë me standardet e BE-së.



Figura 6. Skema përmbledhëse e mbledhjes, transportit dhe trajtimit të mbetjeve bashkiake

Shënim. Kjo skemë paraqet një shembull skematik dhe nuk përmban një kërkesë të parashkruar.

9.3 Identifikimi i problemeve

Problemet kryesore, të paraqitura në mënyrë të përgjithshme në të gjithë Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, lidhen kryesisht me:

- shtrirjen e pjesshme të mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve;
- grumbullimin dhe largimin e pamjaftueshëm të mbetjeve;
- sasinë e kufizuar që depozitohet dhe trajtohet në lendfille;
- praninë e një numri të madh venddepozitimesh (të lejuara dhe të palejuara), të cilat janë jashtë standardeve sanitare dhe inxhinierike;
- numrin e kufizuar dhe cilësinë jo të mirë të pajisjeve për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;
- mungesën e ndarjes së mbetjeve në burim dhe normën e vogël të riciklimit;
- mungesën e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

- zbatimin jo të plotë të ligjit dhe në përgjithësi të akteve nënligjore;
- ndërveprimin dhe koordinimin e dobët të strukturave të qeverisë qendrore me pushtetin vendor dhe sektorët e tjerë të interesuar.
- Për momentin, nuk ka një sistem të standardizuar raportimi dhe bashkitë i raportojnë drejtpërsëdrejti ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën. VKM-ja nr. 687, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019.
- Çdo NJQV duhet të ketë planin lokal të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim që të kryejë aktivitetet dhe të arrijë objektivat e përcaktuar në të.
- Duhet të fillojë ndarja e mbetjeve në burim në të gjithë vendin.

9.4 Standardi minimal i përballueshëm për menaxhimin e mbetjeve të ngurta shtëpiake

Vendosja e standardit minimal mundëson shtrirjen e shërbimit dhe mbledhjen e mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të vendit, me qëllim sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe të mjaftueshme të grumbullimit, transportit dhe depozitimin në një vend të kontrolluar.

Përcaktimi i standardeve për shpeshtinë dhe cilësinë e grumbullimit të mbetjeve, duhet të jetë i ndryshëm për zonat urbane dhe ato rurale me prioritetet si vijon:

Standardi minimal për menaxhimin e rrymave bashkiake	Prioriteti
100% grumbullimi i mbetjeve në zonat urbane	1
Mbetjet depozitohen në një venddepozitim të kontrolluar dhe të lejuar	1
90% grumbullimi i mbetjeve në zonat rurale	2
Ndarja e mbetjeve për riciklim të mëtejshëm	3

Tabela 20. Standardi minimal dhe prioritetet e aktiviteteve për rrymën e mbetjeve bashkiake

Në përgjithësi, sasia e Mbetjeve të Ngurta Shtëpiake (MNSH) rritet paralelisht me rritjen e ekonomike të vendit. Vetëm ndarja në burim dhe mbledhja e diferencuar e rrymave të veçanta të mbetjeve bashkiake mund të rezultojë në zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, të cilat janë orientuar të depozitohen në lendfill.

Ndarja e mbetjeve në burim dhe mbledhja e diferencuar e MNB-së realizohet gradualisht nëpërmjet sistemeve të mbledhjes së ndarë (përfshirë sistemet derë më derë dhe kontejnerëve publikë rrugorë, qese ose pajisje të tjera).

Më tej, masat do të përfshijnë nxitjen e grumbullimit të ndarë të materialeve të riciklueshme në zonat urbane dhe menaxhimin e ndarë të mbetjeve organike në zonat rurale. Do të nxitet kompostimi i decentralizuar dhe kompostimi në kushtet e shtëpisë në zonat rurale. Grumbullimi i ndarë i mbetjeve organike në zonat urbane do të përfshihet si pjesë e sistemit sapo të vendosen pajisjet e nevojshme për menaxhimin e këtyre rrymave të mbetjeve.

Objektet për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të vëllimshme dhe inerte (që shoqërojnë mbetjet bashkiake) do të ngrihen në vende të caktuara të nivelit vendor/ rajonal, ose në nivelin e Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve. Do të ngrihen edhe sistemet e grumbullimit për rryma të veçanta të mbetjeve (përfshirë edhe mbetjet e rrezikshme).

Të gjitha masat që do ta bëjnë këtë dokument të zbatueshëm do të synojnë që të arrihet 50% e rikuperimit të rrymave bazë të mbetjeve shtëpiake; letër/karton, plastikë, metale dhe qelq nëpërmjet riciklimit deri në fund të periudhës kohore që mbulohet nga dokumenti i politikave strategjike.

10. RRJETI I INTEGRUAR I OBJEKTEVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Rrjeti i Integruar i Objekteve për Trajtimin (RIOT) e Mbetjeve përbëhet, por nuk kufizohet nga objektet si më poshtë. Në të gjitha rastet numri dhe lloji i RIOT dhe i teknologjisë së trajtimit dhe të depozitimit të mbetjeve duhet të parashikohen në Planin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, dhe të përcaktohen më tej në studimin e fizibilitetit, si pjesë e përcaktimit të Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve dhe planifikimit hapësinor.

1. Objekte të rëndësisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve: të menaxhuara nga qeveria qendrore/vendore (ose nga kontraktorët që punojnë për të):

- qendra komplekse për menaxhimin e mbetjeve, të cilat shërbejnë për menaxhimin e mbetjeve në shkallë të gjerë, duke përfshirë inceneratorët me ose pa rikuperim energjie;
- objekte për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, duke përfshirë trajtimin fiziko-kimik, djegien dhe depozitimin.

2. Objekte të rëndësisë së Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve: të menaxhuara nga pushteti vendor me marrëveshje financimi prej qeverisë qendrore ose Organizatat e Përgjegjësisë së Prodhuesit (ose kontraktorët e tyre) sipas marrëveshjeve të lidhura me bashkitë:
- lendfille rajonale për mbetjet jo të rrezikshme;
- stacionet e transferimit;
- zona magazinimi të përkohshëm për mbetjet e rrezikshme;
- objekte për trajtimin mekanik dhe biologjik të mbetjeve;
- objekte për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme (në shkallë të mesme dhe të madhe);
- objekte për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimi (në shkallë të mesme dhe të madhe);
- objekte për menaxhimin e mbetjeve të tjera, të menaxhuara sipas marrëveshjeve të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (si, p.sh., për MPEE-në, gomat e makinave, bateritë etj.).

3. Objekte të rëndësisë vendore: të menaxhuara nga pushteti vendor ose sektori privat:
- stacionet e transferimit për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve;
- objekte për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme (në shkallë të vogël);
- objekte për kompostimin e mbetjeve të ndara organike;
- objekte për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe prishjet (në shkallë të vogël);
- objekte të tjera vendore në shkallë të vogël.

PJESA 2
STRATEGJIA KOMBËTARE E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE DHE PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT, 2020–2035

Vizioni

"Krijimi i një kuadri strategjik dhe rregullator në Shqipëri, për të ulur sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe për të menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet e gjeneruara në linjë me objektivat e direktivës kuadër të mbetjeve të BE-së dhe marrëveshjet ndërkombëtare".

Objektivi

Përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe të shëndetit të qytetarëve, që do t'i japë impuls shtesë zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, hapësirave të aktivitetit të biznesit dhe mundësive të punësimit, si dhe do të shtrojë rrugën drejt integrimit evropian të vendit.

Qëllimet strategjike

QS1. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit	QS2. Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve	QS3. Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve	QS4. Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetieve.

QS1 Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit.	**OS1** Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën.	Ngritja e sistemit të matjes, menaxhimit dhe raportimit të mbetjeve bashkiake.
		Përgatitja e studimeve të fizibilitetit për të gjitha zonat e menaxhimit të mbetjeve, duke siguruar një program të optimizuar për financimin dhe zbatimin e Rrjetit të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve.
		Hartimi i planit për menaxhimin e mbetjeve nga ambalazhet dhe i programit për parandalimin e mbetjeve në mbështetje të zbatimit të dokumentit të politikave strategjike për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe planit të veprimit.
		Hartimi i planeve vendore nga bashkitë dhe miratimi në këshillat bashkiakë për menaxhimin e integruar të mbetjeve (PVMIM), në përputhje me dokumentin e politikave strategjike menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe dokumentet mbështetëse.
	OS2 Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ka mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë të integruar në përputhje me standardet e BE.	Mbulimi i gjithë territorit administrativ të bashkive me shërbim që përmbushin standardet minimale të përcaktuara.
		Ndërtimi i skemës së grumbullimit të diferencuar të mbetjeve nga të gjitha bashkitë e vendit, bazuar në metodat më të mirë financiare dhe standardet sektoriale, sipas normave të direktivave përkatëse të transpozuara në ligjin shqiptar
		Mbyllja dhe trajtimi i të gjitha venddepozitimeve bashkiake të trashëguara të mbetjeve, sipas udhëzimeve në fuqi.
		Transporti i mbetjeve në impiantet që shndërrojnë mbetjet në energji
		Zbatimi i skemave kombëtare të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet.
	OS3 Krijimi i një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve bashkiake, i cili bazohet në hierarkinë e mbetjeve.	Hartimi nga ministria përgjegjëse për mjedisin në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për mbetjet, i politikave kombëtare që janë të aplikueshme në nivelin e zonës së mbetjeve dhe nivel bashkie për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të rrymave specifike, në zbatim të hierarkisë së mbetjeve, për mbetjet bashkiake, jobashkiake dhe mbetjet inerte nga ndërtimi dhe shkatërrimi.
		Importimi/prodhimi nga të gjitha bizneset për produkte të rrymave specifike, në zbatim të parimit "**të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit**", ngrenë skemat e veçanta dhe/ose të përbashkëta në bashkëpunim me bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike, si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës etj., për rikuperimin dhe trajtimin e tyre.
QS2 Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve.	**OS1** Kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është përmirësuar dhe harmonizuar me direktivat evropiane dhe është ngritur një sistem institucional efikas në nivel kombëtar.	Rishikimi dhe përafrimi i legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.
		Qartësimi i roleve dhe i përgjegjësive institucionale për njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe institucionet e tjera, përfshirë edhe ato rajonale të cilat janë ngarkuar me funksione mbështetëse.
		Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, si dhe në bashkëpunim me bashkitë përgatit udhëzime që lidhen me zbatimin, përfshirë kodet teknike, standardet minimale të detyruara, specifikimet teknike dhe paketën e dokumenteve të kontratës. 4. Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
		Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

QS3 Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve.	**OS1** Burimet financiare për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikohen në planifikimin buxhetor afatmesëm të miratuar me ligj.	Bashkëpunimi i bashkive me pushtetin qendror përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimet e "vetëmjaftueshmërisë".
		Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve lehtëson marrëveshjet financiare në nivelin e zonave të mbetjeve për bashkitë dhe autoritetet menaxhuese të njësive për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve.
		Agjencia Kombëtar e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve mbikëqyr dhe monitoron financat që lidhen me ndërtimin ose modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve.
		Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurave nga taksat për kategori të ndryshme produktesh të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.
	OS2 Menaxhimi i mbetjeve është prioritet kombëtar dhe pjesë e rëndësishme e planifikimi të fondeve të ndihmës së huaj, IFI dhe BE nëpërmjet fondeve IPA.	Qeveria e Shqipërisë alokon jo më pak se 15% të fondeve të saj vjetore, të dhuruara për menaxhimin e mbetjeve nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë.
		Është kryer planifikimi i detyruar dhe janë zhvilluar procedurat për hartimin dhe për miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve që kërkojnë financime publike dhe mbështetje nga donatorët.
QS4 Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve.	**OS1** Burimet njerëzore dhe pjesëmarrja	Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve të përfshira në strukturën e tyre njësitë e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve me personel të kualifikuar.
		Për kualifikimin e personelit duhet të përgatitet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej QKEV-së dhe ASPA-s, së bashku me personelin teknik përkatës do të vlerësohen me kredite vjetore për aftësitë e fituara.
		Në universitete zhvillohet ekspertizë për *green procurement*.
	OS2 Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të bashkive dhe institucioneve qendrore të mandatuara me MIM-në.	Përfshirja dhe konsultimi me qytetarët për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve.
		Bashkitë organizojnë fushata të përvitshme të ndërgjegjësimit *Let's do It,* që nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve.
		Kurse dhe materiale edukuese duhet të shpërndahen nëpër shkolla në të gjithë vendin duke organizuar orë mësimore dhe aktivitete edukuese për nxënësit.

		Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme).
		Hartimi i masterplanit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme.
		Janë hartuar dhe zbatohen udhëzimet, protokollet, standardet dhe programet e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.
		Prodhuesit e mbetjeve të rrezikshme sigurojnë se menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet në fuqi dhe zbatojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme nga ato të parrezikshme.

11. Qëllimet strategjike, objektivat specifikë dhe masat e zbatimit të dokumentit të politikave strategjike

11.1 Qëllimi strategjik 1 (QS1): Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit;

11.1.1 Objektivi specifik 1 (OS1): Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve, duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën.

Masat e zbatimit

M1. Ngritja i sistemit të matjes, menaxhimit dhe raportimit të mbetjeve bashkiake.

Cilësia, qasja në kohë e të dhënave dhe raportimi i tyre janë thelbësore për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve. Kapërcimi i problemit madhor të statistikave të mbetjeve do të bëhet si një bashkërendim i plotë ligjor dhe institucional ndërmjet institucioneve të ngarkuara me ligj për statistikat ku bëjnë pjesë Agjencia Kombëtare e Mjedisit, INSTAT dhe bashkitë. Futja në funksionim të plotë të sistemit elektronik të PRTR-së dhe fuqizimi i punës së AKM-së për përmbushjen e detyrimeve që kanë bizneset për të raportuar sipas protokollit të E-PRTR-së do të plotësojë ciklin informacionit import–transferim–gjenerim–trajtim eksport. Në fazën e parë të zbatimit të kësaj strategjie, bashkitë duhet të nisin punën për identifikimin e plotë të gjeneruesve të mbetjeve, matjen e sasisë së gjeneruar të mbetjeve, grumbullimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve, duke përdorur njohuritë e zhvilluara në vend dhe udhëzuesve përkatës. Detyrimi që rrjedh nga VKM-ja nr. 687, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve" do të forcojë më shumë këto statistika.

M2. Përgatitja e studimeve të fizibilitetit për të gjitha Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve, duke siguruar një program të optimizuar për financimin dhe zbatimin e Rrjetit të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve.

Pas përgatitjes së Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, duhet të studiohet në detaje zbatimi i sistemeve në nivelin e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve. Për çdo zonë do të përgatiten studime të fizibilitetit, duke marrë në konsideratë zgjedhjet teknologjike në dispozicion dhe konsideratat e planifikimit hapësinor.

Çdo studim fizibiliteti do të përmbajë masat emergjente për përmirësimin e shpejtë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve dhe planifikimin e kërkesës për investimet afatmesme dhe afatgjata. Studimet e fizibilitetit do të shërbejnë si bazë për vendimmarrjen lidhur me investimet për zhvillimin e Rrjetit të Integruar të Objekteve të Menaxhimit të Mbetjeve.

M3. Hartimi i planit për menaxhimin e mbetjeve nga ambalazhet dhe programit për parandalimin e mbetjeve në mbështetje të zbatimit të dokumentit të politikave strategjike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit.

Vëmendja duhet të përqendrohet në përcaktimin e mënyrave efikase që nxisin parandalimin e mbetjeve, riciklimin dhe rikuperimin e materialeve nga paketimet, ndarjen e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme nga depozitimi në lendfill. Këto dokumente do të kenë në fokusin e tyre përmbushjen e objektivave të

acquis së BE-së për mbetjet, përfshirë edhe paketën për ekonominë qarkulluese.

Këto programe ndihmëse dhe Masterplanet, që do të përgatiten në kuadër të kësaj mase, do të ofrojnë mundësinë për rishikimin e plotë të objektivave që lidhen me mbetjet e ngurta shtëpiake, përfshirë paketimin (metalet, plastikën, letrën/kartonin, xhamin) dhe zvogëlimit të mbetjeve të biodegradueshme që dërgohen në lendfill. Çështje të rëndësishme përfshijnë përcaktimin e referencave, masave, protokolleve e procedurave dhe të afateve realiste në përmbushjen e objektivave të BE-së.

M4. Hartimi i planeve vendore nga bashkitë dhe miratimi në këshillat bashkiakë për menaxhimin e integruar të mbetjeve (PVMIM), në përputhje me dokumentin e politikave strategjike Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe dokumentet mbështetëse.

Planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve do të hartohen nga bashkitë në harmoni me dokumentin e politikave strategjike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Ato do të harmonizohen me planin kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe përcaktimet e tij lidhur me Zonat për Menaxhimin e Mbetjeve. Planet do të hartohen mbi hierarkinë e mbetjeve dhe parimet e ligjit nr. 10463, datë 22 shtator 2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 10431, datë 9 qershor 2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar. Deri në përfundim të fazës së parë të dokumentit të politikave strategjike, të gjitha bashkitë do të kenë hartuar dhe miratuar planet vendore.

11.1.2 Objektivi specifik 2 (OS2): Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ka mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së.

- sistemi i integruar i menaxhimit të mbetjeve është ngritur bazuar në "hierarkinë e mbetjeve"; dhe
- rrjeti i integruar i objekteve të trajtimit të mbetjeve përmbush nevojat e vendit në aspektin e teknologjisë dhe të efikasitetit.

Masat e zbatimit

M5. Mbulimi i gjithë territorit administrativ të bashkive me shërbim që përmbushin standardet minimale të përcaktuara.

Gjithë territori i bashkive, duke përfshirë familjet, njësitë ekonomike, institucionet dhe njësitë e tjera do të mbulohen me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkitë do të zbatojnë dhe do të menaxhojnë sisteme efektive të grumbullimit të mbetjeve. Ato do të kalojnë gradualisht në grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Pasi të përmirësojnë sistemin e grumbullimit, bashkitë duhet të operojnë në përputhje me parimet udhëzuese të menaxhimit të mbetjeve, përfshirë parimin e përballueshmërisë.

Nivelet prioritare për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, janë si në vijim:

- niveli prioritar 1;
- shërbimi i grumbullimit ofrohet për 100% të popullsisë urbane;
- transporti i mbetjeve është i sigurt;
- mbetjet depozitohen në një vend të kontrolluar dhe të miratuar;
- niveli prioritar 2;
- shërbimi i grumbullimit ofrohet për 100% të popullsisë në zonat urbane dhe rurale;
- niveli prioritar 3;
- sistemet e grumbullimit të diferencuar dhe të riciklimit është i zbatuar.

M6. Ndërtimi i skemës së grumbullimit të diferencuar të mbetjeve nga të gjitha bashkitë e vendit bazuar në metodat më të mirë financiare dhe standardet sektoriale, sipas normave të direktivave përkatëse të transpozuara në ligjin shqiptar.

Bazuar në planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve, të gjitha bashkitë do të përcaktojnë skemën e grumbullimit të diferencuar, në zbatim të hierarkisë së mbetjeve, sipas zgjidhjes individuale të tyre, mënyrën e transferimit, trajtimit dhe procese të tjera të lidhura me menaxhimin. Normat e riciklimit do të rishikon në nivel teknik dhe ligjor, në mënyrë që përllogaritja e tyre të jetë më e saktë dhe treguesit të jenë të arritshëm. Hierarkia e mbetjeve është parimi kryesor që do të zbatohet i ndjekur nga të gjitha parimet e tjera të shprehura në ligj. Parandalimi i mbetjeve do të jetë prioriteti i parë e ndjekur nga koncepti i ekonomisë qarkulluese. Përmbushja e normave të kuadrit kombëtar do të bëhet sipas parimit të përballueshmërisë dhe standardit minimal të miratuar.

M7. Mbyllja dhe trajtimi i të gjitha venddepozitimeve bashkiake të trashëguara të mbetjeve, sipas udhëzimeve në fuqi.

Ministria përgjegjëse për mjedisin në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për aspekte të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve, hartojnë akte kalimtare, norma dhe rregulla për integrimin e rrjetit të depozitimit të mbetjeve me atë të zonave të mbetjeve dhe mundësojnë kushtet ligjore dhe teknike për futjen e konceptit të "venddepozitimeve të rregulluara", me qëllim uljen e ndotjes në mjedis dhe mbylljen përfundimtare të venddepozitmeve josanitare të mbetjeve. Bashkitë do të përcaktojnë në buxhetin vjetor për menaxhimin e mbetjeve një shumë të mjaftueshme për pastrimin e zonave historike dhe rehabilitimin e fushave të depozitimit të mbetjeve, sipas udhëzimeve në fuqi. Do të ndalohet në mënyrë kategorike hapja e fushave të reja, të cilat nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara. Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta do të përcaktojë rrjetin e integruar të transferimit dhe trajtimit të mbetjeve, pjesë e të cilit do të bëhen të gjitha bashkitë e vendit.

M8. Transporti i mbetjeve në impiantet që shndërrojnë mbetjet në energji.

Impiantet e mbetjeve për energji janë pjesë e menaxhimit të mbetjeve, si opsioni i parafundit i hierarkisë. Pas ndjekjes së gjithë proceseve paraprake të grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit, depozitimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me politikat në këtë dokument dhe skemat teknike të vendosura në Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, bashkitë dhe prodhuesit e tjerë të mbetjeve mund t'i dërgojnë mbetjet e tjera të djegshme në këto impiante.

M9. Zbatimi i skemave kombëtare të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet.

"Gjeneruesit", që janë edhe prodhues edhe importues të produkteve të paketuara, do të zbatojnë parimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP), për skemën/at individuale dhe/apo kolektive të menaxhimit për paketimet dhe menaxhimin e mbetjeve nga paketimet. Këto skema do të zbatohen në bashkëpunim me bashkitë dhe do të sigurojnë zvogëlimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin, veçanërisht të metaleve, xhamit, plastikës, letrës dhe kartonit.

11.1.3 Objektivi specifik 3 (OS3): Krijimi i një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve bashkiake, i cili bazohet në hierarkinë e mbetjeve.

Masat e zbatimit

M.10. Hartimi nga ministria përgjegjëse për mjedisin në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për mbetjet, i politikave kombëtare që janë të aplikueshme në nivelin e zonës së mbetjeve dhe bashkie për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të rrymave specifike, në zbatim të hierarkisë së mbetjeve, për mbetjet bashkiake, jobashkiake dhe mbetjet inerte nga ndërtimi dhe shkatërrimi.

M11. Importimi/prodhimi nga të gjitha bizneset për produkte të rrymave specifike, në zbatim të parimit "të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit", ngrenë skemat e veçanta dhe/ose të përbashkëta në bashkëpunim me bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike, si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës etj., për rikuperimin dhe trajtimin e tyre.

11.2 Qëllimi strategjik 2 (QS2): Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve

11.2 1 Objektivi specifik 4 (OS4):

Kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është përmirësuar dhe harmonizuar me direktivat evropiane dhe është ngritur një sistem institucional efikas në nivel kombëtar.

Masat e zbatimit

M12. Rishikimi dhe përafrimi i legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Rishikimi do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me bashkitë dhe institucionet kryesore që janë përgjegjëse për rrymat e ndryshme të mbetjeve dhe me shërbimet e Komisionit Evropian. Qëllimi i rishikimit të tyre është që të marrë në konsideratë vetëmjaftueshmërinë e buxhetit vendor dhe buxhetit të shtetit, pa cenuar arritjen e objektivave. Procesi i rishikimit do të realizohet nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

M13. Qartësimi i roleve dhe i përgjegjësive institucionale për njësitë e qeverisjes qendrore

dhe vendore, si dhe institucionet e tjera, përfshirë edhe ato rajonale, të cilat janë ngarkuar me funksione mbështetëse.

Roli i Këshillit të Qarkut do të rregullohet për të ushtruar kompetenca të qarta në bashkëpunim të përbashkët me bashkitë që lidhen me menaxhimin e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve. Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve të përcaktuara nga Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta do të konfirmohen nga studimet e fizibilitetit (planet rajonale sektoriale), të cilat do të jenë dokumente mbështetëse në zbatim të planeve vendore. Agjencitë e tjera rajonale do të luajnë rol mbështetës në ngritjen e fondeve dhe veprimtari lehtësuese dhe koordinuese. Rishikimi i rolit të Këshillit të Qarkut do të kërkojë ndërhyrje në ligjin kuadër të MIM 10463 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave që përcakton përgjegjësitë e Këshillit të Qarkut.

M14. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore, si dhe në bashkëpunim me bashkitë, përgatit udhëzime që lidhen me zbatimin, përfshirë kodet teknike, standardet minimale të detyruara, specifikimet teknike dhe paketën e dokumenteve të kontratës.

Udhëzimet do të përfshijnë standardet e përkohshme të depozitimit të mbetjeve që lejojnë përmirësimin e përkohshëm të venddepozitimeve të tyre.

M15. Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Rregulloret bashkiake do të përcaktojnë në hollësi të gjitha veprimtaritë që përfshin shërbimi i menaxhimit të mbetjeve, sipas kërkesave të përcaktuara me ligj. Bashkitë do të hartojnë rregulloret e tyre, me asistencë teknike nga brenda apo jashtë vendit.

11.3 Qëllimi strategjik 3 (QS3): Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve

Objektivi specifik 5 (OS5): Burimet financiare për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikohen në planifikimin buxhetor afatmesëm të miratuar me ligj.

Masat e zbatimit

M16. Bashkëpunimi i bashkive me pushtetin qendror përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimet e "vetëmjaftueshmërisë".

Buxheti i institucioneve për zbatimin e masave të planeve të menaxhimit të mbetjeve dhe në përputhje me modelet e kostos dhe të tarifave, shërbimin e integruar të menaxhimit të mbetjeve, duke filluar që nga viti 2020 parashikon një fond të përcaktuar për mbulimin e masave dhe shërbimeve përkatëse. Të gjitha bashkitë përmirësojnë analizën e kostove lidhur me shërbimet e nevojshme për të përmbushur objektivat e tjerë të dokumentit të politikave strategjike dhe nevojat që lindin nga detyrimet kombëtare dhe ato të anëtarësimit në BE.

M17. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve lehtëson marrëveshjet financiare në nivelin e zonave të mbetjeve për bashkitë dhe autoritetet menaxhuese të njësive për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve.

Në zonat ku janë ndërtuar impiante trajtimi, tarifat janë përcaktuar në bashkëpunim me AKUM-në, duke marrë në konsideratë kapacitetin e bashkive për të përballuar tarifën dhe shkallën e mbulimit. Pushteti qendror përcakton në marrëveshje me bashkitë, përqindjen e financimit, në përputhje me plotësimin e nevojave kryesore për Rrjetin e Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve, duke reflektuar në të njëjtën kohë nivelin e përballueshmërinë prej bashkive dhe prej qytetarëve.

M18. Agjencia Kombëtar e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve mbikëqyr dhe monitoron financat që lidhen me ndërtimin ose modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve.

Brenda buxhetit të shtetit do të krijohet një llogari financiare e veçantë/dedikuar (Fondi i Menaxhimit të Mbetjeve) për të financuar Rrjetin e Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve. Fondi për Menaxhimin e Mbetjeve (FMM) do t'i kushtohet në mënyrë specifike krijimit të Rrjetit Kombëtar të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve, përmes promovimit të reduktimit të mbetjeve, ripërdorimit, riciklimit dhe adresimit të ndotjes së bregdetit nga mbetjet.

Investimi do të bazohet në përparësitë që përcaktojnë masterplanet. Investimet e mbështetura nga buxheti i shtetit janë pjesë

integrale e planeve të veprimit të ministrive përgjegjëse për sektorin e mbetjeve.

Investimet kryesore që lidhen me infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve mund të miratohen vetëm pasi janë kryer studimet e fizibilitetit dhe konsultimet publike dhe pas specifikimit të qartë të kostove të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes, të cilat do të mbahen duke rritur tarifën e menaxhimit të mbetjeve që përfundon në impiantin përkatës. Analiza e kosto-përfitimit do të jetë një praktikë standarde për vendimmarrjet që përfshijnë financimin e projekteve të investimeve.

M19. Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurat nga taksat për kategori të ndryshme produktesh të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.

Objektivi specifik 6 (OS6): Menaxhimi i mbetjeve është prioritet kombëtar dhe pjesë e rëndësishme e planifikimi të fondeve të ndihmës së huaj, IFI dhe BE nëpërmjet fondeve IPA.

Masat e zbatimit

M20. Qeveria e Shqipërisë alokon jo më pak se 15% të fondeve të saj vjetore, të dhuruara për menaxhimin e mbetjeve nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë.

Dokumenti strategjik përcakton prioritetet e asistencës financiare të BE-së për periudhën 2014–2020 në mbështetje të procesit të anëtarësimit, përfshirë mjedisin. Sipas vlerësimit afatmesëm, prioriteti i menaxhimit të mbetjeve do të zërë një vend më të madh që do të shtimin e fondeve. Duke marrë në konsideratë kapacitetet e dobëta të vendit për të përballuar kostot e menaxhimit, shuma e zotuar për menaxhimin e infrastrukturës së mbetjeve do të rritet.

M21. Është kryer planifikimi i detyruar dhe janë zhvilluar procedurat për hartimin dhe miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve që kërkojnë financime publike dhe mbështetje nga donatorët.

Zhvillimi i Rrjetit Kombëtar të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve duhet kryer duke përdorur në mënyrë racionale dhe efikase fondet publike. Zhvillimi i Rrjetit kombëtar, në përputhje me standardet evropiane, do të kërkojë shpenzime të konsiderueshme. Duhet të tregohet kujdes që fondet e vëna në dispozicion të shpenzohen për projektet e duhura.

Do të përgatiten procedura për planifikimin e detyrueshëm dhe miratimin e projekteve, që të sigurohet qartësi për investitorët dhe të arrihet zbatimi i rregullt i projekteve.

Investimet do të drejtohen në projektet më prioritare. Përparësi do t'i jepet zbatimit të projekteve që kanë raportin më të mirë të kosto-përfitimit dhe të projekteve që kufizojnë sa më shumë rrezikun e ndotjes nga plastika në ujërat sipërfaqësore.

11.4 Objektivi strategjik 4 (QS 4): Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve

11.4.1 Objektivi specifik 7 (OS 7): Burimet njerëzore dhe pjesëmarrja

Masat e zbatimit

M22. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve të përfshijnë në strukturën e tyre njësitë e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve me personel të kualifikuar.

Menaxhimi i mbetjeve kërkon personel të kualifikuar në çdo institucion. Ministritë përgjegjëse për mbetjet duhet të kenë në strukturë njësinë e menaxhimit të mbetjeve.

Të gjitha bashkitë në vend duhet të kenë ngritur zyrën e menaxhimit të mbetjeve si pjesë të strukturës së tyre, e cila mund të jetë në nivelin e njësisë në bashkitë e vogla dhe të departamentit në bashkitë e mëdha. Personeli do të përfitojë nga kualifikimet e rregullta, të cilat duhet të planifikohen në buxhetet vjetore të menaxhimit, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e funksionimit të sistemit.

M23. Për kualifikimin e personelit duhet të përgatitet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej QKEV-ve dhe ASPA-s, së bashku me personelin teknik përkatës do të vlerësohen me kredite vjetore për aftësitë e fituara.

Që në 2016, ASPA e ka filluar trajnimin dhe certifikimin e personelit përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve në bashki. Deri më tani ka zhvilluar 4 module kualifikimi. Certifikimi i personelit teknik duhet të vijojë edhe me ngritjen e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

M24. Në universitete zhvillohet ekspertizë për *green procurement*

Në universitetet që diplomojnë inxhinierë mjedisi do të zhvillohet më tej kurrikula mësimore. Planifikuesit urbanë do të aftësohen me anë të kurseve ose materialeve teknike për kriteret e përcaktimit të zonave të trajtimit të mbetjeve. Agjencia për prokurimin publik do të përcaktojë standardet minimale për prokurimin e gjelbër.

11.4.2 Objektivi specifik 8 (OS 8): Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të bashkive dhe institucioneve qendrore të mandatuara me MIM-në

Masat e zbatimit

M25. Përfshirja dhe konsultimi me qytetarët për hartimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve.

Planet e menaxhimit të mbetjeve duhet të hartohen me pjesëmarrjen e komunitetit. Bashkitë duhet të organizojnë dëgjesa publike në njësitë administrative, për të siguruar një pjesëmarrje të balancuar të burrave dhe grave, grupeve të interesit dhe atyre të prekur. Plani duhet të ofrojë zgjidhje të ndryshme, qëllimi kryesor i të cilave duhet të jetë mbrojtja maksimale e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, me kosto të përballueshme dhe të pranueshme nga përfituesit e shërbimit.

Gjithashtu, bashkitë duhet të ngrenë qendra për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme që gjenerohen nga familjet, shërbimet e ndryshme apo industritë e vogla, të cilat duhet të transferohen pranë qendrave të pritjes. Dokumenti i transferimit të mbetjeve, i cili përmban origjinën, sasinë dhe destinacionin përfundimtar për çdo njësi prodhuese të këtyre mbetjeve do të konsolidojë bazën e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve të rrezikshme dhe kategoritë përkatëse, në shkallë kombëtare.

Sistemet e rikthimit dhe të grumbullimit të automjeteve në fund të jetës duhet të jenë të zbatueshme për mjetet e pasagjerëve dhe kamionët e vegjël, por jo për kamionët e mëdhenj, makinat antikuare të vjetra dhe automjetet për përdorime të veçanta. Kompanitë që prodhojnë apo importojnë mjete të caktuara motorike (kryesisht autovetura dhe furgonë më peshë më të vogël se 3.5 tonë, pa ngarkesë) do të kenë një sërë përgjegjësish. Mjetet me peshë më të madhe se 3.5 tonë mund të dërgohen për trajtim pranë një qendre të autorizuar, por nuk i nënshtrohen detyrimit të rikthimit apo tërheqjes pa pagesë.

M26. Bashkitë organizojnë fushata të përvitshme të ndërgjegjësimit *Let's do It* që nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve.

Ndërgjegjësimi i publikut duhet të përbëjë një pjesë të rëndësishme të planeve vendore të veprimit dhe që duhet të përmbajnë një shumëllojshmëri aktivitetesh, të tilla si: fushata reklamash, ngjarje publike dhe fushata digjitale komunikimi (përmes përdorimit të medieve sociale) etj. Këto aktivitete mund të jenë aktivitete të veçanta, të organizohen në varësi të nevojës për të mbështetur shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, si dhe të mbështesin dhe kontribuojnë për ndërmarrjen e fushatave të ndërgjegjësimit të komunitetit.

Bashkitë duhet të kontribuojnë për përfshirjen e publikut, që përfshin raportimin lidhur me gjendjen e menaxhimit të mbetjeve dhe përdorimin e mjeteve dhe të aplikacioneve digjitale të tilla *World Clean-up* dhe *Trash Out*.

Fushata *Let's do it* fokusohet në mobilizimin e komunitetit gjatë një fundjave në fund të shtatorit (ndonëse bashki të tjera e realizojnë këtë fushatë në periudha të ndryshme). Aktivitetet përmbajnë një varg aksionesh pastrimi në vendet historike, rrjedhat ujore, faqen e maleve, në zonat rurale dhe vendet e pushimit apo të argëtimit për njerëzit. Në to marrin pjesë personeli i njësive të pushtetit vendor, shkollat, njerëzit e thjeshtë dhe OJF-të.

M27. Kurse dhe materiale edukuese duhet të shpërndahen nëpër shkolla në të gjithë vendin duke organizuar orë mësimore dhe aktivitete edukuese për nxënësit.

Kurset dhe materialet edukuese për ruajtjen e burimeve dhe përdorimin e burimeve natyrore duhet të përmbajnë njohuritë më të mira të testuara në nivel botëror. Shkolla duhet të promovojë ekonominë qarkulluese. Në aktivitetet ndërlëndore dhe ndërkurrikulare, duhen organizuar orë të veçanta, vizita në terren dhe në qendrat e riciklimit, përpunimit dhe trajtimit të mbetjeve.

Në shkollat e formimit profesional, mund të organizohen orë të veçanta për përdorimin dhe ripërdorimin e mbetjeve, me fokusin kryesor te kuptimi i *upcycling* (riprodhimit të produkteve të reja me materiale të ricikluara). Shkollat duhet të

shërbejnë si modele për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjithë vendin. Sistemi me tre kosha (1. Mbetje organike; 2. Mbetje të thata të përziera që përfshijnë letrën, kartonin, plastikën dhe kanoçet e aluminit; dhe 3. Qelqit) duhet të përdoren në të gjitha shkollat 9 vjeçare, të mesme dhe profesionale të vendit. Kurset e trajnimit gjatë gjithë vitit duhet të organizohen për mësuesit për çështjet ndërkurrikulare që ndihmojnë në formimin e koncepteve të drejta lidhur me menaxhimin e mbetjeve. Shkollat profesionale duhet të nxisin nismat e biznesit në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

M28. Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme).

Për të planifikuar çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është e rëndësishme të kemi të dhëna të sakta mbi sasinë dhe karakteristikat e tyre. Si hap i parë për të realizuar forcimin e sistemit të statistikave për mbetjet e rrezikshme është bërja funksionale e sistemit elektronik të regjistrit të shkarkimeve dhe të transferimit të ndotjes (RRSHTN), ku çdo biznes duhet të raportojë mbi importin–transferimin–gjenerimin–trajtimin dhe eksportin e mbetjeve të rrezikshme. Hartimi i udhëzuesve të standardizuar për monitorimin e shkarkimeve, si dhe trajnimet apo edhe asistenca në punë do të krijojnë ambientin e nevojshëm që bizneset të realizojnë dhe përmbushin detyrimin për të raportuar. Kuadri do të plotësohet me intensifikimin e sistemit të kontrollit dhe të monitorimit nga AKM-ja mbi bizneset dhe kompanitë që prodhojnë ose trajtojnë mbetje të rrezikshme, në mënyrë që të tria palët e përfshira në këtë proces ajo dorëzuese, transportuese dhe marrëse nënshkruajnë dokumentin e transferimit të mbetjeve, duke marrë përgjegjësinë e plotë të origjinës, sasisë dhe destinacionit final të mbetjeve të rrezikshme për çdo subjekt që i gjeneron ato.

M29. Hartimi i masterplanit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme.

Planet pritet të krijojnë sisteme të ndara të menaxhimit të mbetjeve, për mbetjet specifike. Këto përfshijnë mbetjet, që janë objekt i parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe i rrymave të tjera të veçanta të mbetjeve të rrezikshme.

M30. Janë hartuar dhe zbatohen udhëzimet, protokollet, standardet dhe programet e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Do të përgatiten udhëzime për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Këto do të përfshijnë udhëzime për kategorizimin dhe emërtimin, ndarjen e mbetjeve të rrezikshme nga jo të rrezikshme që në fazën e prodhimit të tyre, ngritjen e qendrave të grumbullimit për mbetjet e rrezikshme që gjenerojnë familjet, shërbimet dhe industritë e vogla dhe standardet e sigurisë së ruajtjes së tyre. Do të organizohen kurse trajnimi periodike për inspektoratet përgjegjëse për inspektimin, institucionet publike dhe private që gjenerojnë mbetje të rrezikshme. Kjo do të përfshijë reagimin e shpejtë dhe protokollet e sigurisë në raste aksidentesh.

M31. Prodhuesit e mbetjeve të rrezikshme sigurojnë se menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet në fuqi dhe zbatojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme nga ato të parrezikshme.

Për sa i përket menaxhimit të mbetjeve industriale të rrezikshme, mbetjeve minerale, mbetjeve të kujdesit shëndetësor dhe mbetjeve nga kafshët, është prioritet ndarja e mbetjeve të rrezikshme nga jo të rrezikshme që në burim, përmirësimi i kushteve të ruajtjes, përgatitja e dokumenteve teknike dhe zhvillimorë dhe rehabilitimi i zonave të nxehta.

Sistemet e menaxhimit për rryma të tjera të veçanta si mjetet në fund të jetës, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbetjet nga vajrat, bateritë dhe akumulatorët do të zbatohen në frymën e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Qendrat e pritjes dhe e magazinimit të mbetjeve (rrjeti i integruar i mbetjeve të rrezikshme) duhet të ngrihen pranë prodhuesve të mëdhenj të mbetjeve të rrezikshme. Gjithashtu, duhet të identifikohen të gjitha mbetjet e rrezikshme që depozitohen në kushtet e mungesës së sigurisë (si, p.sh., mbetjet farmaceutike, industriale etj.). Ato duhet të kategorizohen, ripaketohen, klasifikohen dhe transportohen në qendrat e pritjes.

Gjithashtu, bashkitë duhet të ngrenë qendra për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme që gjenerohen nga familjet, shërbimet e ndryshme apo industritë e vogla, të cilat duhet të transferohen pranë qendrave të pritjes. Dokumenti i transferimit të mbetjeve, i cili përmban origjinën, sasinë dhe destinacionin përfundimtar për çdo njësi prodhuese të këtyre mbetjeve do të konsolidojë bazën e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve të rrezikshme dhe kategoritë përkatëse, në shkallë kombëtare.

PJESA 3
PLANI I VEPRIMIT

12. TREGUESIT PËR RRYMAT E VEÇANTA Ë MBETJEVE

Rrymat e mbetjeve	Viti	Objektivi	
		Rikuperim	Riciklim
Mbetje nga paketimet	2025	Jo më pak se 10% nga përsha totale e mbetjeve duhet të rikuperohet	Jo më pak se 10% nga pesha e totale e letrës dhe e kartonit
			Jo më pak se 10% nga pesha totale e metaleve
			Jo më pak se 6% nga pesha totale e plastikës
			Jo më pak se 10% nga pesha totale e qelqit
			Jo më pak se 5% nga pesha totale e mbetjeve nga druri
	2030	Jo më pak se 30% nga pesha totale e mbetjeve duhet të rikuperohet	Jo më pak se 30% nga pesha totale e letrës dhe e kartonit
			Jo më pak se 30% nga pesha totale e metaleve
			Jo më pak se 12% nga pesha totale e plastikës
			Jo më pak se 30% nga pesha totale e qelqit
			Jo më pak se 10% nga pesha totale e mbetjeve nga druri
	2035	Jo më pak se 60% nga pesha totale e mbetjeve duhet të rikuperohet	Jo më pak se 60% nga pesha totale e letrës dhe kartonit
			Jo më pak se 50% nga pesha totale e metal
			Jo më pak se 22.5% nga pesha totale e plastikës
			Jo më pak se 60% nga pesha totale e qelqit
			Jo më pak se 15% nga pesha totale e mbetjeve nga druri
Mbetje të biodegradueshme	2025	Reduktim deri në 75% të nivelit në vitin 2016	
	2030	Reduktim deri në 55% të nivelit në vitin 2016	
	2035	Reduktim deri në 35% të nivelit në vitin 2016	
Mbetje nga prishjet dhe ndërtimet	2025	30% riciklimi/reduktim i mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet	
	2030	50% riciklimi/reduktim i mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet	
	2035	70% riciklimi/reduktim i mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet	

Rrymat e mbetjeve	Viti	Objektivi	
		Rikuperim	Riciklim
Mbetjet e makinave në fund të jetës	2030	Jo më pak se 85% e peshës	Jo më pak se 80% e peshës
	2035	Jo më pak se 95% e peshës	Jo më pak se 85% e peshës
Bateri	2035		Midis 50% dhe 75% për materiale të ndryshme
MPEE	2035	Midis 70% dhe 80% për materiale të ndryshme	Midis 50% dhe 75% për materiale të ndryshme;
	2035	Grumbullimi i diferencuar > 4 kg e MPEE-së nga shtëpitë private ose individët çdo vit.	
Vajra	2035	Jo më pak se 40% e peshës	
Goma	2035	65% e peshës së grumbulluar gjatë vitit	50% e peshës së grumbulluar gjatë vitit

13. TREGUESIT E MATJES PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT DHE RAPORTIMI

Strategjia aktuale kombëtarë për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta nuk ka pasur tregues të matshëm për monitorimin e zbatimit të planit të masave. Rishikimi i strategjisë aktuale nëpërmjet kësaj strategjie të re vjen me një set treguesish, të cilët synojnë të monitorojnë zbatimin e planit të veprimit dhe, për rrjedhojë, mundësinë për të raportuar mbi bazën e këtyre treguesve.

Synohet që menjëherë mbas miratimit të kësaj strategjie të organizohet një takim mbarëkombëtar dhe të shfrytëzohet si platformë Forumi i Dialogut në Sektorin e Mbetjeve, ku bëjnë pjesë përfaqësuesit e bashkive si ofruesit e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, shoqatat e riciklimit; ministritë e linjës që kanë funksione në lidhje me rregullimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve; Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe inspektoratet përkatëse të mjedisit; donatorë dhe agjenci zhvillimi që zbatojnë projekte në fushën e mjedisit dhe të menaxhimit të mbetjeve, ky synohet të prezantohet strategjia dhe sfidat për zbatimin e saj, duke nënvijëzuar monitorimin e zbatimit të strategjisë nga të gjithë aktorët, sipas përgjegjësive mbi bazën e treguesve të monitorimit.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (drejtoria përkatëses e politikave në fushën e mbetjeve) si institucioni kryesor në këtë fushë do të hartojë çdo vit një raport monitorimit të strategjisë, raport i cili do të dalë me konkluzione dhe sugjerime konkrete, në lidhje me përmirësimin e zbatimit të strategjisë, si edhe do të ndihmojë grupet teknike të qeverisë shqiptare në negocimin e kapitullit 27, "Mjedisi" me BE-në për fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Gjithashtu, konkluzionet e raportit vjetor të monitorimit do të konsultohen Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave në Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta; Këshillin Konsultativ Pushtet Qendror dhe atë Vendor; Forumin e Dialogut në Fushën e Mbetjeve, si edhe grupe të tjera sipas tematikave.

Për më tepër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) në raportin e saj vjetor të monitorimit të gjendjes së mjedisit do të reflektojë ato tregues të kësaj strategjie që janë pjesë e kapitullit të monitorimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Përpos kësaj, AKM-ja synon të përmirësojë dhe të validojë të dhënat në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, duke kontribuar kështu edhe në monitorimin më të mirë të zbatimit të kësaj strategjie.

Gjithashtu, shprehim angazhimin tonë që rrjedh si detyrim nga VKM-ja nr. 290, datë 11.3.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS", për të përmbyllur gjatë fazës tranzitore që parashikohet, rishikimin e dokumentit strategjik, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë VKM.

Më poshtë jepen në mënyrë të detajuar treguesit, që synojnë të matin masat e propozuara në këtë strategji, si edhe vlerat bazë (në vitin e miratimit të strategjisë) dhe vlerat e synuara në vite, si edhe institucionet përgjegjëse. Këta tregues edhe përse kanë synime afatmesme, ata do të mblidhen dhe do të raportohen çdo vit si pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të strategjisë nën koordinimin e plotë të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit.

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
(**QS1): Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit.**								
OS1: Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve, duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën	M1. Ngritja e sistemit të dokumentimit, informimit dhe performancës së statistikave të gjenerimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe vendor	1.Numri i Bashkive dhe i gjeneruesve të mbetjeve që raportojnë të dhënat sipas sistemit/numrit total të gjeneruesve	2019	25	61	61	61	Bashkitë MTM / AKM MIE/AKUM
	M2. Studimet e fizibilitetit janë përgatitur për të gjitha Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve, duke siguruar një program të optimizuar për financimin dhe zbatimin e Rrjetit të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve	2.Studimet e fizibilitietit janë hartuar për të gjitha Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve, janë në përputhje me studimin e zonave të mbetjeve në statusin e miratuar nga Këshilli i Ministrave	2019	0	8	10	10	MIE/AKUM MTM
		3.% e projekteve të masterplanit të financuara	2019	0	20%	50%	100%	MIE/AKUM
	M3. Bashkitë kanë zhvilluar dhe kanë miratuar në këshillat bashkiakë planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve (PVMIM), në përputhje me dokumentin e politikave strategjike Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të	4.Numri i bashkive që kanë një PVMIM të miratuar	2019	15	30	61	61	Bashkitë MTM

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
	ngurta							
OS2. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ka mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së	M4. Bashkitë mbulojnë gjithë territorin e tyre administrativ me shërbime që përmbushin standardet minimale të përcaktuara	5.% e mbulimit me shërbim e shprehur si numër eqv. banorësh që marrin shërbim/nr. eqv. të banorëve rezidentë	2019	70%	80%	90%	95%	Bashkitë MTM
		6.% sasisë së mbetjeve të grumbulluara/sasia e mbetjeve të gjeneruara (sipas planifikimit)	2019	60%	70%	90%	95%	Bashkitë MTM/AKM MIE/AKUM
	M5. Të gjitha bashkitë e vendit kanë ndërtuar skemën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin më të mirë financiare dhe standardet minimale sektoriale, sipas normave të direktivave përkatëse të transpozuara në ligjin shqiptar	7.% e popullatës, mbulohen me shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve	2019	15%	30%	60%	80%	Bashkitë
		8.% e popullatës në qytete me më shumë se 100,000 banorë, (zonat urbane) mbulohen me shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve	2019	10%	35%	70%	100%	Bashkitë
		9.% e sasisë së mbetjeve (për secilën rrymë) që shkon për riciklim/sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në ton/vit	2019	17%	20%	30%	40%	Bashkitë MTM/AKM
		10.% e mbetjeve të tjera të rikuperuara nga mbetjet mikse bashkiake kundrejt totalit të mbetjeve nga paketimi të rikuperueshme	2019	5%	10%	15%	30%	Bashkitë MTM/AKM
		11.% e sasisë së	2019	10%	Jo më	Jo më	Jo më pak	Bashkitë

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
		mbetjeve të paketimit që rikuperohen në nivel bashkie kundrejt totalit të gjeneruar			pak se 10%	pak se 40%	se 70%	MTM/AKM
		12.% e sasisë së mbetjeve që depozitohet në lendfill ose venddepozitime/sasia totale e mbetjeve të grumbulluara ton/vit	2019	80%	50%	30%	10%	Bashkitë MTM/AKM MIE
		13.Nr. i qendrave pritëse ose formate të tjera të ngritura nga bashkitë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet	2019	2	10	30	61	Bashkitë MTM MIE
		14.Numri i sistemeve të depozitimit dhe të trajtimit të mbetjeve të ngritura në zbatim të hierarkisë së mbetjeve	2019	5 (lendfill Bajkaj/Sarandë, Maliq/Korçë, Bushat/Shkodër, Sharrë/Tiranë, WtE Elbasan	8 (lendfill Vlorë, Berat, WtE Fier	10 (WtE Tiranë, lendfill Kukës	Të gjitha sipas MP-së	Bashkitë MIE/AKUM MTM/AKM
	M6. Në të gjithë territorin janë trajtuar dhe mbyllur, sipas udhëzimeve në fuqi të gjitha venddepozitimet bashkiake historike të mbetjeve	15.Numri i venddepozitimeve historike të trajtuara dhe/ose mbyllura kundrejt numrit total të venddepozitimeve historike, në nivel bashkie	2019	0	30	100	Të gjitha	Bashkitë MIE MTM
	M7. Bashkitë në zonat e impianteve të mbetjeve për energji dërgojnë mbetjet e tyre të paricklueshme dhe mbetjet e përziera në këto impianteve	16.Nr. i bashkive që dërgojnë mbetjet e paricklueshme dhe të përziera në impiantet me WtE	2019	6	12	Të gjitha brenda zonës së shërbimit të impiantit	Të gjitha brenda zonës së shërbimit të impiantit	Bashkitë MIE/AKUM
		17.Sasia e mbetjeve që shkon për rikuperim energjie/sasia totale e mbetjeve në vit	2019	40,000	210,000	400,000	E gjithë sasia e mbetur nga mbetjet mikse	Bashkitë MIE/AKUM
	M8. Skema kombëtare e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit zbatohet për paketimet dhe mbetjet nga paketimi	18.% e mbetjeve nga paketimet të grumbulluar nga skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit	2019	Nuk ka	25%	50%	70%	Bashkitë MTM MFE Bizneset

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
(OS3): Krijimi i një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve jobashkiake, i cili bazohet në hierarkinë e mbetjeve	M9. Qeveria qendrore në zbatim të parimit "përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit" dhe/ose në partneritet me biznesin hartojnë planet e fizibilitetit të zonave të mbetjeve, me qëllim ngritjen e sistemet e përbashkëta dhe të veçanta të grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës etj.	19.Numri i planeve të fizibilitetit/kundrejt numrit të zonave	2019	Nuk ka	Jo më pak se 5	Jo më pak se 10	Në të gjitha Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve	Bashkitë, MTM, MFE, bizneset
		20.% e baterive dhe akumulatorëve dërgohen në qendrat e pritjes dhe tërhiqen nga bizneset e licencuara	2019	40%	65%	75%	80%	Bashkitë MTM/AKM
		21.% e llumrave në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur trajtohen pranë impianteve	2019	5%	30 %	50%	80%	Bashkitë MTM/AKM MIE; MBZHR
		22.% e mbetjeve inerte që grumbullohen kalojnë në impiantet e trajtimit dhe ripërdoren	2019	Nuk ka	30%	50%	80%	Bashkitë MTM/AKM MIE
	M10 Ministria përgjegjëse për mjedisin në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për mbetjet, harton politika kombëtare që janë të aplikueshme në nivelin e zonës së mbetjeve dhe bashkie për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të rrymave specifike, në	23.Kuadri ligjor rregullator dhe standardet e shërbimit dhe të menaxhimit të mbetjeve specifike janë hartuar	2019	Nuk ka	Janë miratuar	Zbatohet	Zbatohet	MTM MIE MBZHR MSHMS

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
	zbatim të hierarkisë së mbetjeve, për mbetjet bashkiake, jobashkiake dhe mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishjet							
	M11 Të gjitha bizneset që importojnë apo prodhojnë mbetje të rrymave specifike, në zbatim të parimit "të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit", ngrenë skemat e veçanta dhe/ose të përbashkëta në bashkëpunim me bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës etj., për rikuperimin dhe trajtimin e tyre	24.Numri i skemave funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike	2019	-	Jo më pak se 5	Jo më pak se 10	Të gjitha skemat për rryma të ndryshme mbetjesh që zbatojnë PZP	Bashkitë MTM/AKM
(QS2): Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve								
(OS4): Kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është përmirësuar dhe harmonizuar me direktivat evropiane dhe është ngritur një sistem institucional efikas në nivel kombëtar	M12 Autoritetet qendrore në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor kanë rishikuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve	25.% e legjislacionit të rishikuar në zbatim të reformimit të parashikuar nga dokumenti i politikave strategjike	2019	5%	100%	100%	100%	MTM
	M13 Ligji ka parashikuar role dhe përgjegjësi institucionale të qarta për njësitë e qeverisjes qendrore dhe të qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera, përfshirë edhe ato	26.% e legjislacionit të rishikuar për të ndarë qartësisht përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve	2019	50%	100%	100%	100%	MTM

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
	rajonale, të cilat janë ngarkuar me funksione mbështetëse për menaxhimin e mbetjeve							
	M14 Nevoja e rivlerësimit për të siguruar një sistem të menaxhimi të integruar të mbetjeve	27.Kryerja e vlerësimit për riorganizimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve	2019	Rishikuar sipas MP	Në zbatim	Në zbatim	Në zbatim	MIE MTM Bashkitë
	M15 Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar, në përputhje me udhëzimet e nxjerra	28.Nr. i bashkive që kanë një rregullore për MIM /numri total i bashkive	2019	5	61	61	61	Bashkitë
(QS3): Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve								
(OS5): Burimet financiare për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikohen në planifikimin buxhetor afatmesëm të miratuar me ligj.	Strukturat përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përgatisin udhëzuesin për llogaritjen e kostove dhe të tarifave për shërbimet bashkiake të mbetjeve të ngurta	29.% totale e financimit të dokumentit të politikave strategjike nga buxheti i brendshëm (PBA)/kundrejt nevojës për financim në nivelin e ZMM për fazë (transferim dhe trajtim	2019	0	30%	60%	100%	MTM/AKM MIE/AKUM
	M16 Bashkitë në bashkëpunim me pushtetin qendror përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin të plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimet e "vetë-mjaftueshmërisë"	30.% e buxhetit të alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financim	2019	50%	80%	90%	95%	Bashkitë MFE
		31.% e shumës së të ardhurave nga tarifa	2019	40%	80%	90%	100%	Bashkitë MTM

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
		kundrejt kostos totale të shërbimit						MFE
		32.% e tarifës së mbledhur kundrejt planifikimit	2019	60%	80%	90%	100%	Bashkitë MTM MFE
	M17 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve lehtëson marrëveshjet e financiare në nivelin e ZMM për bashkitë dhe autoritetet menaxhuese të njësive për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve	33.Bashkitë mbulojnë koston për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit dhe të depozitimit final	2019	50%	Jo më pak se 50% të tarifës	Jo më pak se 70% të tarifës	Jo më pak se 90% të tarifës	Bashkitë MIE MFE
		34.Bashkitë mbulojnë koston për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në WtE	2019	0	0	Jo më pak se 30% të tarifës	Jo më pak se 50% të tarifës	Bashkitë MIE MFE
	M18 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Mbetjeve mbikëqyr dhe monitoron financat që lidhen me ndërtimin ose modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve	35.Buxheti i shtetit ka planifikuar dhe financon investimet për infrastrukturën e transportit dhe trajtimit të mbetjeve	2019	0 %	Sipas MP	Sipas MP	Sipas MP	MIE MTM MFE
	M19. Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurave nga taksat për kategori të ndryshme produktesh të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre	36.MTM-ja koordinon Fondin për Menaxhimin e Mbetjeve, nëpërmjet hartimit të kuadrit ligjor për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe vënien në zbatim të tij	2019	10%	60%	75%	100%	MTM
OS 6. Menaxhimi i	M20 qeveria e Shqipërisë	37.% e ndihmës së përfituar/kundrejt	2019	10%	35%	60%	90%	MTM MIE

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
mbetjeve është prioritet kombëtar dhe pjesë e rëndësishme e planifikimi të fondeve të ndihmës së huaj, IFI dhe BE nëpërmjet fondeve IPA.	alokon jo më pak se 10% të fondeve të saj vjetore, të dhuruara për menaxhimin e mbetjeve nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë	totalit të ndihmës së huaj						MFE
	M21 Është kryer planifikimi i detyruar dhe janë zhvilluar procedurat për hartimin dhe miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve që kërkojnë financime publike dhe mbështetje nga donatorët	38.% e investimeve në sektor/kundrejt parashikimit vjetor sipas dokumentit të politikave strategjike dhe masterplanit	2019	0%	50%	80%	100%	MTM MIE MFE
(QS 4): Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve								
(OS 7): Burimet njerëzore dhe pjesëmarrja	M22 Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve kanë përfshirë në strukturën e tyre njësitë e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve me personel të kualifikuar	39.Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin	2019	~80	200	200	200	MTM MIE Bashkite
	M23. Krijohet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej QKEV-së dhe ASPA, së bashku me personelin teknik përkatës do të vlerësohen me kredite vjetore për aftësitë e fituara	40.% e personelit të specializuar që trajnohet në vit	2019	~50%	100%	100%	100%	Bashkitë MTM ASPA
		41.Nr. i trajnimeve në vit për institucionet publike apo private që gjenerojnë mbetje të rrezikshme	2019	0	4	4	8	ASPA MTM AZHR AKM

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
		42.Nr. i trajnimeve periodike për kompanitë që trajtojnë mbetjet të rrezikshme	2019	0	4	4	8	ASPA MTM AZHR AKM
	M24 Në universitete zhvillohet ekspertize për "*green procurement*"	% (numri i të trajnuarve në planifikim urban/numrit të diplomuarve në inxhinieri)	2019	-	20%	50%	80%	MAS MTM Universiteti
(OS 8): Qytetarët përdorin dhe respektojnë infrastrukturën e mbetjeve dhe bëhen pjesë e masave për përmbushjen e objektivave të planeve vendore	M25 Qytetarët janë të përfshirë dhe konsultohen për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve	43.% (numri) i planeve të hartuara me pjesëmarrje komunitare/totalit të planeve të miratuara	2019	70%	100%	100%	100%	Bashkitë
		44.% (numri i banorëve që ndajnë mbetjet në burim/kundrejt popullsisë së mbuluar me shërbim të diferencuar)	2019	0%	30%	50%	80%	Bashkitë
	M26 Bashkitë organizojnë fushata të përvitshme të ndërgjegjësimit *Let's do It* që nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve	45.Nr. i bashkive që organizojnë veprimtari ndërgjegjësimi dhe pastrimi/kundrejt totalit të bashkive	2019	40%	100%	100%	100%	Bashkitë MTM
	M27 Kurse dhe materiale edukuese duhet të shpërndahen nëpër shkolla në të gjithë vendin, duke organizuar orë mësimore dhe aktivitete edukuese për nxënësit	46.% (numri i shkollave që e kanë/aplikojnë në kurrikul edukimin për mbetjet	2019	80%	100%	100%	100%	Bashkitë MAS MTM
		47.% (numri i shkollave që e kanë/aplikojnë ndarjen e mbetjeve në burim	2019	5%	50%	70%	95%	Bashkitë MAS MTM
(QS5): Janë ngritur instrumentet ligjore, institucionale dhe financiare për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme								

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
(OS9): Janë identifikuar të gjitha rrymat e mbetjeve të rrezikshme që janë prodhuar apo prodhohen në territorin e vendit nga sektori publik dhe ai privat	M28. Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme)	48.% e institucioneve/ bizneseve që gjenerojnë mbetje të rrezikshme që informojnë, sipas kategorive dhe formatit të mbetjeve, të identifikuara	2019	30%	100%	100%	100%	MTM/AKM
	M29. Hartimi i Master Planit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme	49.Plani kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme është hartuar	2019	-	-	1	Zbatohet	MTM MIE
	M30. Janë hartuar dhe zbatohen udhëzimet, protokollet, standardet dhe programet e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme	50.% e mbetjeve minerare të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	-	20%	60%	100%	MIE/AKBN
		51.% e mbetjeve kimikate të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	Nuk ka	30%	65%	100%	MTM/AKM
		52.% e mbetjeve bujqësore dhe drurit të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	Nuk ka	40%	80%	100%	MBZHR MTM/AKM
		53.% e mbetjeve nga gomat të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	Nuk ka	25%	40%	65%	MTM/AKM
		54.% e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	5%	35%	65%	70-80%	Bashkitë MTM/AKM
		55.% e mbetjeve nga llumi i impianteve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj	2019	Nuk ka	30%	65%	100%	MTM/AKM MIE

Objektivi specifik	Masat	Treguesit e matjes	Viti bazë	Vlera në vitin bazë	Synimi 2025	Synimi 2030	Synimi 2035	Institucioni përgjegjës
		kategorie të gjeneruar						
		56.% e mbetjeve nga produktet e kafshëve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	Nuk ka	10%	50%	100%	MBZHR MTM/AKM
		57.% e mbetjeve vajra të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	10%	30%	80%	100%	MTM / AKM
		58.% e mbetjeve nga bateritë dhe nga akumulatorët të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	40%	65%	75%	80%	MTM / AKM
		59.% e mbetjeve spitalore të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	2019	50%	65%	85%	95%	MSHMS MTM / AKM
	M31. Prodhuesit e mbetjeve të rrezikshme sigurojnë se menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet në fuqi dhe zbatojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme nga ato të parrezikshme	60.Nr. i kompanive që gjenerojnë dhe trajtojnë mbetje të rrezikshme që raportojnë rregullisht në RRSHTN kundrejt totalit të tyre në vend	2019	20%	100%	100%	100%	AKM
		61.% e mbetjeve të rrezikshme që ndahen nga mbetjet e parrezikshme	2019	0.04%	1%	3%	5%	MIE MTM MSHMS MBRZH

URDHËR
Nr. 216, datë 29.5.2020

PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN FUNDOR TË QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18) [REKOMANDIMI GFCM/43/2019/5]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të germave "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 3, të "Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun", të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003; të neneve 13, 14, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar; të pikave 4 dhe 5, të kreut II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 8.5.2013 "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det"; të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014, "Për peshkimin",

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimit GFCM/43/2019/5, "Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në Detin Adriatik (nënzona gjeografike 17 dhe 18) që i bashkëngjitet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e pikave 1–15, 28–33, 36, 53, 56–59 të rekomandimit.

3. Ngarkohet Inspektorati i peshkimit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe kapitenët e anijeve të peshkimit për zbatimin e pikave 17–23, 43–52, 54–55 të rekomandimit.

4. Të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koce) që peshkojnë peshq fundorë nuk duhet të kalojnë 23 124 ditë peshkimi në vitin 2020 dhe 22 748 ditë peshkimi në vitin 2021, sipas shtojcës 4 të rekomandimit.

5. Ditët e peshkimit ndahen sipas porteve të peshkimit, si më poshtë:

Porti i peshkimit	**Viti 2020**	**Viti 2021**
Durrës (56%)	13.000 ditë	12.900 ditë
Vlorë (11%)	2.500 ditë	2.400 ditë
Shëngjin (22%)	5.124 ditë	5.048 ditë
Sarandë (11%)	2.500 ditë	2.400 ditë

6. Ndalohet peshkimi deri në gjashtë milje detare nga bregu ose katër milje detare për anijet që nuk lejohen të peshkojnë më shumë se gjashtë milje detare, për të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koce) që peshkojnë peshq fundorë, për periudhën 1 korrik deri 15 shtator.

7. Ngarkohet Sektori i Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në Drejtorinë e Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Inspektoratin i Peshkimit të monitorojnë konsumin e kuotës së sforcos ose kufirin e sforcos, në përputhje me pikën 5 më sipër, të shprehur në ditët e peshkimit deri në vitin 2021 (shtojca 4) dhe në ditët e peshkimit për çdo segment flote (shtojca 3) pas 2021-shit.

8. Pas tremujorit të tretë të çdo viti, Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, bën verifikimin dhe rishpërndarjen e ditëve të peshkimit ndërmjet anijeve të të njëjtit port ose edhe nga njëri port në tjetrin.

9. Nga data kur kuota e sforcos është përmbushur ose është arritur kufiri i sforcos, Inspektorati Peshkimit do t'ia komunikojë atë Sektorit të Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës. Sektori do të njoftojë ndalimin e peshkimit, në rastin kur kuota ose kufiri i sforcos është arritur nga të gjitha ose një pjesë e anijeve të peshkimit të portit përkatës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

REKOMANDIMI GFCM 43/2019/5
PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN FUNDOR TË QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

duke marrë parasysh se objektivi i Marrëveshjes për themelimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja e GFCM)

është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, në zonën e aplikimit të GFCM-së;

duke sjellë në vëmendje që në arritjen e qëllimit të Marrëveshjes GFCM, GFCM, do të miratojë rekomandime për masat e ruajtjes dhe menaxhimit që synojnë të sigurojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe, që në miratimin e rekomandimeve të tilla, GFCM-ja do t'u kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhurinat, si dhe ndikimet e mundshme në peshkimin artizanal dhe komunitetet lokale;

duke marrë parasysh që GFCM-ja do të miratojë masa menaxhuese bazuar në një qasje ekosistemi në peshkim për të garantuar ruajtjen e rezervave peshkore mbi nivelet të cilat mund të prodhojnë rendimentin maksimal të qëndrueshëm (MSY);

duke kujtuar që Deklarata Ministrore e Maltës e vitit 2017 kërkon që, në kontekstin e krijimit të një kuadri të menaxhimit të peshkimit të bazuar në ekosistem, të gjitha format e peshkimit kryesor duhet të menaxhohen me plane menaxhimi;

duke pasur parasysh që GFCM-ja do të zbatojë qasjen paraprake, në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin e dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit të 10 dhjetorit 1982, në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e rezervave të peshqve të shpërndarë dhe peshqve migratore të 4 gushtit 1995 dhe Kodit të Sjelljes për Peshkimi të Përgjegjshëm të Organizatës së Bujqësisë dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara (FAO);

duke marrë parasysh se Kodi i Sjelljes i FAO-së për peshkimin përgjegjës parashikon që shtetet "duhet të zbatojnë gjerësisht qasjen paraprake në ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve ujore të gjalla, për t'i mbrojtur ato dhe për të ruajtur mjedisin ujor, duke marrë parasysh shembujt më të mirë shkencore të mundshëm. Mungesa e informacionit të përshtatshëm shkencor nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen ose mosplotësimin e masave për ruajtjen e specieve të synuara, specieve të lidhura ose të varura dhe specieve jo të synuara dhe mjedisin e tyre";

duke pasur parasysh që të gjitha masat e formuluara nga GFCM-ja do të bazohen në këshillat më të mira shkencore të mundshme, duke marrë parasysh faktorët e përshtatshëm mjedisorë, ekonomikë dhe socialë;

duke kujtuar rekomandimin GFCM/41/2017/7 për një plan rajonal veprimi për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar në zonën e aplikimit të GFCM-së;

duke marrë parasysh që mortaliteti në peshkim duhet të mbahet nën kufijtë e sigurt për të garantuar rendimente të larta afatgjata, duke kufizuar rrezikun e kolapsit të rezervave peshkore dhe duke garantuar peshkim të qëndrueshëm;

duke marrë parasysh rëndësinë socio-ekonomike të peshkimit dhe nevoja për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre;

duke kujtuar që Komiteti Këshillëdhënës Shkencor për Peshkimin (SAC) ka konsideruar në mënyrë të përsëritur, se rezervat e merlucit, skampit, barbunit, gjuhëzës, cikales, karkalecit të thellësisë janë në mbishfrytëzim në nënzonat gjeografikë (GSA) 17 dhe 18;

duke vënë në dukje që SAC, në sesionin 21, këshilloi që masat e menaxhimit duhet të zbatohen dhe nënvizoi rëndësinë e identifikimit dhe të zbatimit të zonës shtesë të kufizuara të peshkimit *(FRA - Fisheries Restricted Area)*, duke siguruar që kapaciteti i peshkimit të mos rritet, ndërsa përpjekja e peshkimit të menaxhohet në një mënyre të qëndrueshme dhe madhësitë minimale të peshkut të zbarkuar janë zbatuar;

miraton, në përputhje me nenet 5/"b", 8/"b" dhe 13 të Marrëveshjes së GFCM-së, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM, SHTRIRJA GJEOGRAFIKE DHE PËRKUFIZIMET OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

1. Ky rekomandim përcakton një plan menaxhimi shumëvjeçar për aktivitete të qëndrueshme të peshkimit fundor (demersal) në Detin Adriatik (GSAs 17 dhe 18) që shfrytëzojnë rezervat fundore, me anë të tratave fundore (trata koce ose OTB), duke përfshirë stoqet kryesore të listuara në shtojcën 1. Në bazë të këshillave të SAC-së, qëllimi i këtij rekomandimi mund të shtrihet për forma dhe rezerva (lloje) të tjera peshkimi.

2. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të jetë, në përputhje me qasjen paraprake. Ai do të hartohet për të siguruar rendimente të larta afatgjata, në përputhje me rendimentin maksimal të qëndrueshëm MSY *(Maximum Sustainable Yield)* dhe për të garantuar një rrezik të ulët të pakësimit të stoqeve, duke ruajtur peshkimin e qëndrueshëm dhe relativisht të qëndrueshëm. Plani do të marrë parasysh natyrën e përzier të peshkimit fundor dhe dinamikën midis rezervave të llojeve që e përbejnë atë.

3. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC), anijet e të cilave peshkojnë në mënyrë aktive në GSAs 17 dhe 18 bien dakord të zbatojnë një plan të tillë shumëvjeçar të menaxhimit për peshkimin në fjalë dhe në përputhje me objektivat e përgjithshëm dhe specifikë, si dhe masat e përcaktuara nga ky rekomandim.

4. Do të ndërmerren një grup masash paraprake të përkohshme të menaxhimit për Detin Adriatik në mënyrë që të sigurohet që, duke minimizuar ndikimet socio-ekonomike dhe duke realizuar këshillat shkencore të SAC-së, rezervat dhe peshkimi përparojnë drejt niveleve biologjikisht të qëndrueshme.

5. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të vazhdojë të ndjekë, gjithashtu, zvogëlimin e aktiviteteve të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (IUU) në GSA 17 dhe 18.

Shtrirja gjeografike

6. Plani shumëvjeçar i menaxhimit i parashikuar nga ky rekomandim do të zbatohet në GSA 17 dhe 18.

Përkufizimet

7. Për qëllimin e këtij rekomandimi do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "Fmsy" nënkupton vlerën e mortalitetit të llogaritur të peshkimit, që, me një model të caktuar peshkimi dhe në kushte mesatare aktuale mjedisore, jep rendimentin maksimal afatgjatë;

b) "Blim" nënkupton pikën limit të referencës, e shprehur si biomasa e rezervës riprodhuese nën të cilën mund të ketë një kapacitet të zvogëluar riprodhues;

c) "Bpa" nënkupton pikën e referencës paraprake, e shprehur si biomasa e rezervës riprodhuese, e cila siguron që biomasa e rezervës riprodhuese të ketë më pak se 5% probabilitet të jetë nën Blim;

d) "Deti Adriatik" nënkupton GSA-të 17 dhe 18, siç përcaktohet në Rezolutën GFCM/33/2009/2 për krijimin e nënzonave gjeografike në zonën e aplikimit GFCM, që ndryshon Rezolutën GFCM/31/2007/2;

e) "Anije aktive peshkimi" nënkupton çdo anije të peshkimit fundor që peshkon speciet kryesore të listuara në shtojcën I dhe me leje peshkimi nga shteti, flamurin e të cilit mban, për të kryer operacione specifike të peshkimit, gjatë një periudhë të caktuar, në një zonë të caktuar ose për një peshkim të caktuar nën kushte specifike;

f) "Rezervat kryesore" janë organizmat detarë që u përkasin specieve, siç përcaktohet në shtojcën I të rekomandimit aktual;

g) "Segmenti i flotës" nënkupton grupin e anijeve që veprojnë me kombinime të llojeve të rrjetave dhe klasat e gjatësisë së anijeve, siç përcaktohet në shtojcën 3 dhe që synojnë rezervat kryesore, siç përcaktohet në shtojcën 1;

h) "Peshkimi i paligjshëm, i paraportuar dhe i parregulluar" ose "peshkimi IUU" nënkupton veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 3 të Planit Ndërkombëtar të Veprimit të FAO 2001 për Parandalimin, Shkurajimin dhe Eliminimin e Peshkimit të Paligjshëm, të Paraportuar dhe të Parregulluar (IOPA-IUU), si dhe dispozitat e rekomandimit GFCM / 41/2017/7;

i) "Pikë e përcaktuar për zbarkim" nënkupton porte ose vende afër bregut të përcaktuara nga CPC-ja, sipas rekomandimit GFCM/40/2016/1 për një skemë rajonale për masat e shtetit portual për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar në zonën e GFCM-së të aplikimit, përfshirë terminalet në det të hapur dhe instalimet e tjera për zbarkim, transferim, paketim, përpunim, furnizimin me karburant ose rifurnizimin e anijeve të peshkimit, ku zbarkimi, transferimi, paketimi dhe/ose veprimtaritë e përpunimit të produkteve të peshkut janë të lejuara.

PJESA II
OBJEKTIVAT SPECIFIKË

8. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të synojë të kontribuojë në objektivat e përmendur në nenin 2 dhe parimet e listuara në nenin 5 të marrëveshjes së GFCM-së.

9. Plani shumëvjeçar i menaxhimit, në veçanti, do të:

a) të zbatojë qasjen paraprake në menaxhimin e peshkimit;

b) të sigurojë që nivelet e shfrytëzimit të rezervave kryesore janë në MSY deri në vitin 2026;

c) të parandalojë rritjen e kapacitetit të peshkimit në lidhje me vitin 2015 ose mesataren e 2015–2017 dhe përpjekjen (sforcon) e peshkimit në lidhje me 2015 ose mesataren e tre viteve 2015–2018;

d) të mbrojë zonat e riprodhimit dhe të të vegjëlve, si dhe habitatet thelbësore të peshkut EFH *(Essential Fish Habitat)*, që janë të rëndësishme për rezervat më kryesore të peshqve fundorë me rendësi tregtare;

e) të kontribuojë në eliminimin e hedhurinave *(discards)*, duke shmangur dhe duke zvogëluar zëniet e padëshiruara dhe duke siguruar që i gjithë peshku i zënë të zbarkohet;

f) të sigurojë masa për të rregulluar kapacitetin dhe përpjekjen e peshkimit të flotës në nivelet e mortalitetit të peshkimit, në përputhje me MSY, me qëllim që të kemi një flote ekonomikisht të vlefshme dhe pambishfrytëzimin e burimeve biologjike detare.

10. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të bazohet në një qasje me dy hapa, ku: i) në dy vitet e para do të zbatohet një regjim i përkohshëm i përpjekjeve të peshkimit; dhe ii) në vitin 2021, në bazë të të dhënave të reja shkencore, SAC-ja do të vlerësojë gjendjen e stoqeve dhe do të propozojë kuota vjetore të përpjekjeve të peshkimit, në përputhje me dispozitat e përfshira në pjesët II, IV dhe V të këtij rekomandimi, duke kontribuar kështu për të arritur Fmsy dhe duke qëndruar brenda kufijve të sigurt biologjikë.

11. Në vitet 2020 dhe 2021 do të vendoset një regjim paraprak i përkohshëm i përpjekjeve në peshkim. CPC-ja duhet të sigurojnë së bashku, që deri në vitin 2021, përpjekja e përgjithshme e peshkimit (numri i ditëve të peshkimit) të vendosur nga flotat që peshkojnë në mënyrë aktive për stoqet kryesore të peshqve fundore (demersale) me trata fundore (koce) dhe që veprojnë në GSAs 17 dhe 18, do të zvogëlohen të paktën 12 për qind për OTB-në dhe 16 për qind për TBB-në përkatësisht me përpjekjen vjetore të bërë në 2015 ose me mesataren trevjeçare, brenda periudhës 2015–2018. Çdo CPC siguron që zvogëlimi i përpjekjeve të jetë proporcional në kontributin e tij për përpjekjen totale në vitin referues në zonë, sipas formave të peshkimit në shtojcën 4, siç raportohet përmes kuadrit së referencës për grumbullimin e të dhënave GFCM (DCRF), detyra V-2 në 2017. Ky kontribut do të llogaritet sipas formulës dhe formave të peshkimit në shtojcën 4. Reduktimi i përgjithshëm i përpjekjeve të peshkimit do të ndahet në mënyrë të barabartë në periudhën tranzitore, duke rezultuar në kuotat e përpjekjeve të listuara në shtojcën 4 që do të zbatohen në vitet 2020 dhe 2021.

12. Për vitet 2022–2026 do të vendoset një regjim pesëvjeçar i përpjekjeve të peshkimit. CPC-ja do t'i komunikojnë të dhënat e tyre vjetore të përpjekjeve të peshkimit Sekretariatit të GFCM-ja, në përputhje me dispozitat e paragrafit 36. Çdo vit, në bazë të këshillave të SAC-së, GFCM-së, do të përcaktojë kuota vjetore të përpjekjeve në peshkim. Këto kuota do të shprehen në ditë peshkimi për çdo CPC dhe për segmentet e flotës dhe format e peshkimit sipas aneksit 3 dhe do të lejojnë arritjen e objektivave të përcaktuar në paragrafin 9. GFCM-ja do të sigurojë që, për secilin CPC, rritja ose ulja e përpjekjeve të alokuara është në përputhje me formulën në shtojcën 4 dhe me përpjekjet totale të peshkimit në vitin referues në atë zonë, sipas formave të peshkimit për çdo segment të flotës të listuar në shtojcën 3, siç raportohet duke filluar nga viti 2021.

13. Dispozitat në paragrafët 11 dhe 12 nuk do të zbatohen për flotat kombëtare që operojnë me trata fundore (koce) dhe peshkojnë më pak se 1 000 ditë gjatë periudhës referuese të përmendur në paragrafin 9/"c"; flota të tilla kombëtare nuk duhet të tejkalojnë kufirin e përpjekjeve prej 3 000 ditësh peshkimi në vit.

Synimet

14. Objektivi operacional i planit shumëvjeçar të menaxhimit do të jetë mbajtja e mortalitetit (vdekshmërisë) të peshkimit për stoqet kryesore të listuara në shtojcën 1, brenda vlerave të parashikuara të referencës paraprake për Fmsy, me qëllim arritjen ose ruajtjen e nivelit të Fmsy, në përputhje me objektivat e këtij rekomandimi.

Masat mbrojtëse

15. Bazuar në këshillat shkencore të SAC-së, kur biomasa e riprodhuesve të ndonjë prej stoqeve kryesore është nën Bpa, GFCM do të marrë masa përmirësuese për të siguruar kthimin e shpejtë të

stoqeve në fjalë mbi ato nivele, të afta për të prodhuar MSY. Në veçanti, përpjekja për peshkim do të vendoset në nivele, në përputhje me prodhimin e një vdekshmërie peshkimi më të ulët se Fmsy, duke marrë parasysh uljen e biomasës.

16. Bazuar në këshillat shkencore të SAC-së, kur biomasa e riprodhuesve të ndonjë prej stoqeve kryesore është nën Blim, GFCM do të marrë masa të mëtejshme përmirësuese për të siguruar kthimin e shpejtë të stoqeve në fjalë mbi ato nivele të afta për të prodhuar MSY. Në veçanti, masa të tilla përmirësuese mund të përfshijnë pezullimin e peshkimit që synon stoqet përkatëse dhe një zvogëlim adekuat të përpjekjeve të peshkimit ose kufirit të zënies.

PJESA III
MASAT TEKNIKE

Madhësia minimale e referencës për ruajtje

17. Do të zbatohet rekomandimi GFCM/40/2016/5, që përcakton një madhësi minimale të referencës së ruajtjes për merlucin në Detin Mesdhe.

18. Madhësia minimale e referencës së ruajtjes përcaktohet si më poshtë:

a) për karkalecat e thellësisë, me gjatësi karapace 20 mm (CL);

b) për skampin, me 20 mm CL ose gjatësi totale 70 mm (TL);

c) për gjuhëzën, në 20 cm TL; dhe

d) për barbunin, në 11 cm TL.

19. Individët e stoqeve kryesore më të vogla se madhësia minimale e referencës së ruajtjes, siç përcaktohet në paragrafët 17 dhe 18, nuk do të mbahen në bord, transferohen, zbarkohen, magazinohen, shiten ose ofrohen për shitje.

20. Palët kontraktuese të komunikojnë çdo vit te Sekretariati i GFCM metodat specifike që ato zbatojnë në bazë të parashikimeve të përcaktuara në paragrafët 17 deri 19, përfshirë detyrimet e zbarkimit, që synojnë të shmangin hedhurinat, që janë në fuqi në disa Palë Kontraktuese, si dhe metodat e inspektimit të zbarkimit ,kur një skemë fleksibël parashikohet në nivelin kombëtar.

Zonat e kufizuara të peshkimit

21. Do të zbatohet rekomandimi GFCM/41/2017/3 për krijimin e një zone të kufizuar të peshkimit *(Fisheries Restricted Area)* në Gropën e Jabukës/Pomo në Detin Adriatik.

22. FRA-ja do të krijohen për ruajtjen dhe administrimin e rezervave peshkore në Detin Adriatik. SAC-ja do të shqyrtojë mundësinë e krijimit të FRA-ve të reja në Adriatikun Jugor dhe Verior. Palët Kontraktuese të interesuara, mundësisht duhet të paraqesin të dhënat e nevojshme për vlerësimin e FRA-ve jo më vonë se një muaj përpara takimit të vitit 2020 të Komitetit Nënrajonal për Detin Adriatik (SRC-AS) dhe të mbështesin punën për vlerësimin e FRA-ve, në përputhje me ecurinë e përshkruar në shtojcën 2.

23. Do të ndalohet çdo aktivitet i peshkimit me trata fundore (koce) në FRA, e krijuara sipas paragrafëve 21 dhe 22, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga një rekomandim specifik. për rregullat e menaxhimit për secilën nga këto FRA.

24. SAC-ja mund të identifikojë zonat e riprodhimit dhe të rritjes së të vegjëlve për cilindo prej rezervave demersale në Detin Adriatik dhe, në rastin kur stoku është jashtë kufijve të sigurt, SAC-ja mund të propozojë masa shtesë, të cilat mund të përfshijnë kufizimin e veprimtarisë së peshkimit jashtë ujërave territoriale.

Mbyllja e peshkimit në hapësirë dhe kohë

25. Për qëllime të ruajtjes së rezervave, palët kontraktuese duhet të mbyllin zonën bregdetare, pavarësisht nga thellësia, deri në gjashtë milje detare nga bregu ose katër milje detare për anijet që nuk lejohen të peshkojnë më shumë se gjashtë milje detare, për të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koce) që peshkojnë peshq fundorë, për një periudhë të vazhdueshme për të paktën tetë javë.

26. Në alternativë të paragrafit 25, palët kontraktuese duhet të mbyllin për të paktën 30 ditëve të vazhdueshme dhe të mbulojnë të paktën 20 për qind të detit territorial për të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koce), pavarësisht nga gjatësia e tyre e përgjithshme, në zonat dhe periudhat e njohura si të rëndësishme për mbrojtjen e të vegjëlve të peshqve fundorë (demersale). Zonat e tilla, gjithashtu, duhet të llogaritin rrugët e migracionit dhe modelet hapësinore të shpërndarjes së të vegjëlve.

27. Për të përcaktuar kufizimet e duhura hapësinore-kohore, në funksion të administrimit të qëndrueshëm të rezervave të peshqve të përmendura në shtojcën 1, palët kontraktuese i komunikojnë Sekretariatit të GFCM, jo më vonë se 30 qershori 2020, dhe çdo vit pas kësaj, kufizimet

hapësinore, si përcaktohet në paragrafët 25 ose 26, në ujërat nën juridiksionin e tyre, të cilat ato zbatojnë, me qëllim mbrojtjen e zonave të riprodhimit dhe të të vegjëlve të peshqve fundorë (demersale) të listuar në shtojcën 1.

PJESA IV
MASAT E MENAXHIMIT TË FLOTËS

28. Palët kontraktuese duhet të sigurojnë që kapaciteti i përgjithshëm i flotës që peshkojnë në mënyrë aktive me trata fundore (koce) për rezervat kryesore të peshqve fundore (demersal), për sa i përket tonazhit bruto (GT) dhe/ose tonazhit të regjistruar bruto (GRT), fuqisë së motorike (kw) dhe numrit të anijeve, siç është regjistruar si në regjistrat kombëtarë ashtu edhe në GFCM, nuk tejkalon, gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij rekomandimi, kapacitetin e flotës për peshkimin demersal në 2015 ose mesataren e tij gjatë 2015–2017.

29. Dispozitat e paragrafëve 9/"c" dhe 28 nuk do të zbatohen për flotat kombëtare që operojnë me trata koce dhe peshkojnë për më pak se 1 000 ditë gjatë periudhës referuese të përmendur në paragrafin 9/"c". Kapaciteti i peshkimit të flotave të tilla aktive që veprojnë me trata koce nuk do të rritet më shumë se 50 për qind, në lidhje me periudhën e referimit.

30. Anijet e autorizuara, që përdorin trata koce në Detin Adriatik, për të peshkuar për rezervat kryesore të listuara në shtojcën 1, do të listohen nga palët kontraktuese, flamurin e së cilës mbajnë.

31. Palët kontraktuese do t'i komunikojë sekretariatit të GFCM, jo më vonë se 31 janari i çdo viti, listën e anijeve që mbajnë flamurin e tyre dhe peshkojnë në mënyrë aktive për rezervat kryesore të listuara në shtojcën 1 për vitin aktual ose vitet e ardhshme. Kjo listë do të përfshijë, për secilën anije, informacionin e përmendur në shtojcën 3 të rekomandimit GFCM/42/2018/5 mbi një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor, që shfrytëzon rezervat e demersaleve në ngushticën e Sicilisë (nënzonat gjeografike 12 deri në 16, që shfuqizon rekomandime GFCM/39/2015/2 dhe GFCM/40/2016/4).

32. Anijet që operojnë me trata fundore (koce) dhe që shfrytëzojnë rezervat e peshqve fundore (demersale) në Detin Adriatik do të lejohen të kryejnë veprimtari specifike të peshkimit, nëse këto përcaktohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi të lëshuar nga autoritetet kompetente. Anijet e autorizuara mbi gjatësi 12 metra duhet të pajisen me një sistem monitorimi të anijeve (VMS) nga 1 janari 2021 dhe me një regjistër elektronik (ERS) nga 1 janari 2022, ndërsa, për anijet e autorizuara nën 12 metra, Komiteti i Pajtueshmërisë (CoC) I GFCM vlerëson sistemet më të përshtatshme të gjeopozicionimit dhe raportimin e zënieve.

33. Palët Kontraktuese do të sigurojnë që janë krijuar mekanizma adekuatë për regjistrimin e secilës anije peshkimi në regjistrin kombëtar të flotës, për regjistrimin e zënieve të anijes dhe përpjekjet e peshkimit përmes *logbook*-ut si dhe për monitorimin e aktiviteteve të anijeve të peshkimit dhe zbarkimit përmes anketave për marrjen e mostrave të zënieve dhe të përpjekjeve, sipas rregullave të përcaktuara nga secila palë kontraktuese.

34. Për të eksploruar një monitorim sa më të mirë të përpjekjeve të peshkimit për të zbuluar orët aktuale të peshkimit, GFCM-ja do të nisë një projekt pilot që synon instalimin e sensorëve në vinçat e anijes, në mënyrë që të regjistrojë dhe të raportojë në kohë reale të hedhurat dhe tralimin e rrjetave fundore (demersale).

35. Dispozitat e mësipërme nuk cenojnë rekomandimin GFCM/33/2009/7, në lidhje me standardet minimale për krijimin e një sistemi të monitorimit të anijeve në zonën e aplikimit të GFCM.

36. Duke filluar nga 1 janari 2021, me qëllim të mbledhjes së të dhënave për përpjekjet e peshkimit për krijimin e një regjimi të ardhshëm të përpjekjeve të peshkimit, Palët Kontraktuese të raportojnë çdo vit pranë Sekretariatit të GFCM deri më 30 qershor të çdo viti të dhëna nga viti i kaluar për Kw x ditë të peshkimi për trata koce dhe gjatësi anije, pa shkrirje të klasave të gjatësisë së anijes.

PJESA V
MONITORIMI SHKENCOR, PËRSHTATJA DHE RISHIKIMI I PLANIT SHUMËVJEÇAR TË MENAXHIMIT

37. Komiteti Këshillëdhënës Shkencor *(SAC, Scientific Advisory Committee)* do të sigurojë, mbi baza vjetore, deri në vitin 2020, këshilla mbi statusin e rezervave kryesore në Detin Adriatik, duke

përfshirë edhe objektiva specifikë për të ruajtur mortalitetin (vdekshmërinë) e peshkimit brenda pikave të referimit të rëna paraprakisht dakord dhe për të ruajtur ose për të rivendosur rezervat kryesore në nivele që mund të prodhojnë MSY, në përputhje me objektivat e përcaktuar në paragrafin 1.

38. SAC-ja do të vlerësojë pasojat biologjike, ekonomike dhe sociale të zbatimit të disa skenarëve të menaxhimit, me qëllim rivendosjen dhe mirëmbajtjen e popullatës së rezervave peshkore mbi nivelet që mund të prodhojnë MSY.

39. Bazuar në këshillat e SAC-së, GFCM-ja mund të rishikojë përmbajtjen e planit shumëvjeçar të menaxhimit.

40. Kur këshillat e SAC-së tregojnë se objektivat e përgjithshëm ose specifikë të planit shumëvjeçar të menaxhimit nuk janë duke u përmbushur, GFCM-ja vendos për masa shtesë dhe/ose alternative të menaxhimit për të kontribuar në arritjen e këtyre objektivave.

41. Nëse, për ndonjë arsye (p.sh., mungesa e të dhënave të përshtatshme), SAC-ja nuk është në gjendje të sigurojë një këshillë të saktë për gjendjen e rezervave të specieve kryesore të listuara në aneksin 1 dhe për nivelet e tyre të shfrytëzimit, GFCM-ja do të vendosë për masat më të përshtatshme të menaxhimit për të siguruar qëndrueshmërinë e peshkimit. Masa të tilla do të bazohen në këshillat e SAC-së, do të jenë në përputhje me qasjen paraprake dhe të marrin parasysh elementet mjedisore dhe socio-ekonomikë, në një mënyrë që garantojnë qëndrueshmërinë e peshkimit.

42. Në vitin 2020, SAC-ja do të vlerësojë ndikimin e peshkimit me grepa fundorë *(bottom longlines),* që synon peshkimin e riprodhuesve të merlucit në stokun e Detit Adriatik. SAC-ja do të vlerësojë nevojën për të përfshirë anijet që ushtrojnë këtë formë` peshkimi në këtë plan menaxhimi shumëvjeçar dhe nevoja për të miratuar masa specifike hapësinore për të mbrojtur stokun riprodhues të merlucit në Detin Adriatik.

PJESA VI
MASAT SPECIFIKE PËR TË ADRESUAR AKTIVITETET E PESHKIMIT IUU (PPP)

43 Palët kontraktuese duhet të krijojë një mekanizëm për të siguruar që anijet që peshkojnë në mënyrë aktive në Detin Adriatik të deklarojnë të gjitha zëniet dhe zëniet shoqëruese të` specieve kryesore të listuara në shtojcën 1. Detyrimi për të deklaruar elektronikisht zëniet do të zbatohet nga 1 janari 2022, pavarësisht nga sasia e zëne, për anijet mbi 12 metra gjatësi, ndërsa për anijet nën 12 metra, CoC-ja do të vlerësojë sistemin më të përshtatshëm të raportimit të zënieve.

44. Çdo palët kontraktuese do të përcaktojë pikat e zbarkimit *(landing point)* ku do të bëhet zbarkimi nga anijet që peshkojnë, në mënyrë aktive për rezervat kryesore në Detin Adriatik.

45. Për secilin port të caktuar, palët kontraktuese duhet të specifikojnë kohën dhe vendet e lejuara të zbarkimit dhe të transferimit.

46. Palët kontraktuese të kryejnë inspektime në bazë të një analize të rrezikut.

47. Ndalohet zbarkimi ose transferimi nga anijet e peshkimit të çdo sasie të rezervave kryesore të peshkuara me trata fundore (koce) në Detin Adriatik, përveç porteve të përcaktuara nga palët kontraktuese, në përputhje me paragrafin 44 më lart.

48. Palët kontraktuese do t'i komunikojë Sekretariatit GFCM, jo më vonë se 30 nëntori i çdo viti, çdo ndryshim në listën e pikave të caktuara të zbarkimit, ku mund të ndodhin zbarkime të rezervave kryesore në Detin Adriatik.

49. Palët kontraktuese do të angazhohen për të bashkëpunuar në luftën kundër aktiviteteve të peshkimit IUU (PPP), veçanërisht përmes shkëmbimit dhe mbledhjes së informacionit për të luftuar kundër veprimtarive të paligjshme.

50. Pjesa VI e këtij rekomandimi nuk paragjykon zbatimin e rekomandimin GFCM/41/2017/7.

PJESA VII
PROGRAMI I MONITORIMIT, KONTROLLIT DHE MBIKËQYRJES

51. Duke filluar nga 1 janari 2021, anijet e autorizuara të peshkimit fundor (koce), mbi 12 metra gjatësi, që peshkojnë në mënyrë aktive për rezervat kryesore të specieve të listuara në shtojcën 1, do të pajisen me VMS; për anijet nën 12 metra, CoC-ja do të vlerësojë sistemin më të përshtatshëm të gjeopozicionimit, duke lejuar autoritetet e kontrollit të ndjekin aktivitetet e tyre.

52. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 1 të rekomandimit GFCM/35/2011/1, në lidhje me krijimin e një regjistri GFCM, duke ndryshuar rekomandimin GFCM/34/2010/1, të gjitha zëniet e rezervave të specieve kryesore, pavarësisht nga pesha e zënë, si dhe zëniet e llojeve jokryesore *(non-target)* mbi 50 kg, do të raportohen në *logbook*.

53. Palët kontraktuese të monitorojnë konsumin e kuotës së sforcos ose kufirin e sforcos në përputhje me paragrafin 13, të shprehur në ditët e peshkimit deri në vitin 2021 (shtojca 4) dhe në ditët e peshkimit për çdo segment flote (shtojca 3) pas 2021. Që nga data kur kuota e sforcos është përmbushur ose është arritur kufiri i sforcos, pala kontraktuese e interesuar do t'ia komunikojë atë Sekretariatit GFCM dhe do të ndalojë peshkimin, kur kuota ose kufiri i sforcos është arritur nga të gjitha ose një pjesë e anijeve të peshkimit që mbajnë flamurin e saj.

PJESA VIII
SKEMA E INSPEKTIMIT PILOT

54. Me kërkesë të palëve kontraktuese, me ndihmën e Sekretariatit të GFCM-së, GFCM-ja do të fillojë në vitin 2020 një projekt pilot, me qëllim krijimin e një programi vëzhgimi dhe inspektimi, në mënyrë që të sigurojë pajtueshmërinë me masat e ruajtjes dhe të menaxhimit të përfshira në këtë rekomandim.

55. Ky program i vëzhgimit dhe i inspektimit do të bazohet në rezultatet e projektit pilot dhe të miratuar para fundit të vitit 2020. Ai do të përfshijë, ndër të tjera, elementet e mëposhtme:

a) inspektim në det të hapur;

b) procedurat për një hetim efektiv mbi një shkelje të pretenduar të masave të ruajtjes dhe të menaxhimit të përfshira në këtë rekomandim dhe për raportimin në GFCM, për veprimet e ndërmarra, përfshirë procedurat për shkëmbimin e informacionit;

c) dispozitat për veprimet e duhura që duhen ndërmarrë, kur inspektimet zbulojnë shkelje të rënda, si dhe ndjekja e duhur dhe transparente e veprimeve të tilla, në mënyrë që shteti flamur të mbajë përgjegjësinë në kuadër të programit të synuar;

d) inspektime portuale;

e) monitorimin e zbarkimeve dhe të zënieve, përfshirë ndjekjen statistikore për qëllime menaxhimi;

f) programe specifike të monitorimit, përfshirë dhe inspektimin me anije; dhe

g) programet e vëzhguesve.

PJESA IX
PLANET E MENAXHIMIT KOMBËTAR

56. Për të siguruar ruajtjen e duhur të rezervave demersale, palët kontraktuese duhet të miratojnë masa të menaxhimit të peshkimit ose plane kombëtare të menaxhimit në Detin Adriatik.

57. Palët kontraktuese njoftojnë sekretariatin e GFCM-së, nga 31 janari 2020, për masat e menaxhimit ose për planet e menaxhimit të miratuara në nivelin kombëtar. Kur është e përshtatshme, nëse këto masa ndryshohen, palët kontraktuese do të komunikojnë këto ndryshime deri më 31 janar të vitit pasardhës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

58. Plani shumëvjeçar i menaxhimit i krijuar me këtë rekomandim mbetet në fuqi për shtatë vjet nga data e miratimit të tij.

59. Masat në këtë rekomandim nuk cenojnë masa më të rrepta të miratuara nga palët kontraktuese.

60. GFCM-ja mund të rishikojë këtë rekomandim, në bazë të këshillave shkencore të SAC-së.

SHTOJCA 1
LISTA E SPECIEVE KRYESORE TË ADRESUARA NGA KY REKOMANDIM

Emri	Emri shkencor	GSA 17	GSA 18
Merluc	*Merluccius merluccius*	X	X
Skampi	*Nephrops norvegicus*	X	X
Gjuhëza	*Solea solea*	X	X
Karkalec thellësie	*Parapenaeus longirostris*	X	X
Barbun	*Mullus barbatus*	X	X

SHTOJCA 2
KUSHTET E REFERENCËS PËR KRIJIMIN E FRA-ve NË DETIN ADRIATIK

Në vazhdën e zbatimit pozitiv të Jabuka/Pomo FRA, me frymë të ngjashme bashkëpunimi dhe duke njohur vlerën e miratimit të masave të ngjashme në pjesën tjetër të Detit Adriatik, puna duhet të përparojë drejt krijimit të FRA-ve në Adriatikun jugor dhe verior.

Hapat e mëposhtëm janë planifikuar:

1. Palët kontraktuese, veçmas vlerësojnë realizueshmërinë e FRA-ve, në konsultim me aktorët kombëtarë;

2. Komponentët kryesorë duhet të përfshijnë ekosistemet e ndjeshme detare (*Vulnerable Marine Ecosystems VME)*, habitatet thelbësore të peshkut *(Essential Fish Habitats EFH)*, dinamikën hapësinore të flotës së peshkimit dhe ndikimet socio-ekonomike, siç parashikohen nga administratat kombëtare;

3. Diskutimet bilaterale zhvillohen midis Palëve Kontraktuese, në lidhje me FRA-të e mundshme;

4. Organizimi i një *workshop*-i me palët kontraktuese, shkencëtarë dhe palë të interesuara, dhe me mbështetjen e projektit FAO AdriaMed, për të ekzaminuar të gjithë komponentët kryesorë për krijimin e FRA-ve të reja.

Grupi i punës të tentojë para Komitetit Subregonal të ardhshëm për Detin Adriatik të finalizojë dhe të bien dakord për të gjitha elementet që duhet të përmbahen në propozimin e FRA-ve, siç përshkruhet në "Formën standarde për paraqitjen e propozimeve për zonat e kufizuara të peshkimin në Mesdheu dhe Detin e Zi të GFCM-së".

SHTOJCA 3
SEGMENTET E FLOTËS (PËRSHTATUR PËR SHQIPËRINË)

Tipi i rrjetës	**Nënzona gjeografike (GSAs)**	**Speciet e përfshira**	**Segmentet e flotës sipas gjatësisë**	***Fishing Days*** [1]
Trata fundore (koce)	18	Barbun, merluc, karkalec thellësie, skampi	>12- <24m >24 m	

SHTOJCA 4
FORMULA E NDARJES SË SFORCOS SË PESHKIMIT (PËRPJEKJEVE)

Formula e ndarjes ku kuotat e sforcos janë proporcionale me kontributin e CPC-së në sforcon totale, në një vit të caktuar referimi dhe të gjitha klasgjatësitë e anijeve:

[Pakësimi i CPCa = Pakësimin e përgjithshëm x ($CPCa^2$/($CPCa^2$+$CPCb^2$+ $CPCc^2$+$CPCd^2$+$CPCe^2$))]

Gjatë viteve 2020–2021 do të vendoset një pakësim i përgjithshëm prej 12 përqindësh mbi numrin e ditëve të peshkimit për tratat fundore (koce), të raportuar në DCRF detyra V-2, për vitin 2015 ose mesataren e viteve 2015–2018.

Formula e mësipërme përdoret për të shpërndarë kuotën e ditëve të peshkimit për Palët Kontraktuese për anijet e peshkimit fundor dhe raportohet në tabelën më poshtë:

Forma e peshkimit	**Zona gjeografike**	**EU 2020**	**EU 2021**	**Shqipëri 2020**	**Shqipëri 2021**	**Mali i Zi 2020**	**Mali i Zi 2021**
Peshkim fundor: trata, koce	17–18	147 606	137 046	23 124	22 748	NA	NA[2]

[1] Këto të dhëna do të plotësohen duke filluar nga viti 2021.

[2] Mali I Zi nuk kalon limitin e 3000 ditëve në peshkim në vit në përputhje me paragrafin 13.

VENDIM
Nr. 87, datë 19.5.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "FAVINA 1" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 402, SERIA P18, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 6.4.2018, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "VOSKOPOJË", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1970 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", dhe pika 3, të "Rregullores së organizimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për modifikimin e licencës së shoqërisë "Favina 1" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Favina 1" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 650, datë 22.4.2020, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, "Për licencimin e shoqërisë 'Favina 1' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Voskopojë", me kapacitet të instaluar 1970 kw.

- Shoqëria parashtron se kërkesa për modifikimin e licencës së sipërcituar vjen si rezultat i prurjeve të mëdha të lumit të Voskopojës, i cili shkakton rritjen e kapacitetit, nga 1970 kw, në 2400 kw.

- Shoqëria "Favina 1" sh.p.k., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 24.10.2005, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në objekt të veprimtarisë së tij kjo shoqëri ka: Prodhimin e energjisë elektrike nga centralet elektrike ekzistues me kapacitet ekzistues të përgjithshëm jo më të madh se 5 mw.

- Nga analizimi i të dhënave teknike për HEC-in, të përcjellë nga shoqëria "Favina 1" sh.p.k., vërehet se, ndryshimi konsiston vetëm në rritjen e kapacitetit të instaluar nga 1970 kw, në 2400 kw.

- Aplikimi i shoqërisë "Favina 1" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a": Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: është plotësuar tërësisht.

- Neni 15, pika 4, germa "b": Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: është plotësuar tërësisht.

- Neni 15, pika 4, germa "c": Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës, kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera: është pa plotësuar. Nga shoqëria nuk janë depozituar në ERE lejet nga institucionet e tjera (leje mjedisore, leje e shfrytëzimit të ujit, pika e lidhjes me rrjetin, të përditësuara me kapacitetin e instaluar, të modifikuar sipas rritjes që ka parashtruar shoqëria në këtë kërkesë dhe miratimi nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha).

- Neni 15, pika 4, germa "d": Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi: është e pa plotësuar. Nga ana e shoqërisë nuk është dhënë informacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Neni 15, pika 4, germa "e": Të ketë shlyer pagesat e rregullimit në ERE: është plotësuar tërësisht.

- Për dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë ato në ERE, brenda afateve të përcaktuara në rregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Favina 1" sh.p.k., për

modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Voskopojë", si më poshtë:

- kapaciteti i instaluar nga 1970 kw, të bëhet 2400 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 88, datë 19.5.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT DHE PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS, PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE HEC "BANJË", TË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; neneve 7 dhe 8, të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike, të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, dhe nenit 19, germa "d", të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me fillimin e procedurës për kualifikimin e impiantit dhe pajisjen me "Certifikatë të garancisë së origjinës", për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC "Banjë", të shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684 prot., datë 7.5.2020, shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me "Certifikatën e garancisë së origjinës" për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC "Banjë".

- Në zbatim të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., rezulton si më poshtë:

- Aneksi 1. Formati i aplikimit, germat "a", "b", "c": është plotësuar pjesërisht. Mungon autorizimi ose prokura e përfaqësimit të shoqërisë në këtë aplikim.

- Neni 7, pika 7.4. Kërkesa për lëshimin e garancisë së origjinës, germat "a", "b", "c", "ç", "d", "e", "ë", "f", "g": Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7.5. Dokumentacioni teknik, pika 1, germat "a", "b", "c", "d"; pika 2, germat "a", "b", "c": Është plotësuar tërësisht.

- Neni 8. Procedura teknike e kualifikimit, pikat 8.1, 8.2, 8.3, germat "a", "b", "c" dhe "d", si dhe pika 8.4: Janë plotësuar tërësisht.

- Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me autorizimin ose prokurën e përfaqësimit të shoqërisë nga përfaqësuesi ligjor, në bazë të nenit 35, të "Kodit të Procedurës Administrative" (KPrA), do t'i kërkohet shoqërisë plotësimi brenda afateve të përcaktuara në "Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës, për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për kualifikimin e impiantit dhe për pajisjen me "Certifikatë të garancisë së origjinës" për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC "Banjë", të shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 504 lekë